



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Turizëm”

Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Çlirim Duro

Prof. Asoc. Sonila Papathimiu

Maj / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Turizëm"**

1	IAL aplikues:	Universiteti 'Luigj Gurakuqi' i Shkodrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Turizmit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në 'Turizëm'
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Miratim nga MASH me shkresën nr.1803/1 prot, datë 05.06.2001
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i QSHA, nr.232, datë 28.05.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë i studimit
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	19 PAE / 8 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 68 studente 2021-2022 52 studente 2022-2023 69 studente
19	Komente / të tjera:	-

PËRSHKRIMI I PROÇESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

ASCAL, bazuar në “Manualin për Proçedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Çlirim Duro dhe Prof.Asoc.Dr. Sonila Paphimiu. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxheri teknik i ASCAL, Z. Erion Xhako.

Proçesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Turizem”, i ofruar nga Departamenti i Turizimit të Fakultetit Ekonomik (FE) në UNISHK, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në UNISHK, u realizua në datën 12 dhe 13 Korrik 2023, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në UNISHK. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjës të Departamentit të Turizimit dhe zv-Dekananen e Fakultetit të Ekonomisë, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e Drejtorisë së Kurrikulave dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, Marketingut, Ndërkombëtarizmit dhe Projekteve; si dhe me Sekretarinë mësimore. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj.

Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit Bachelor në “Turizem”, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij proçesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër është njohur me DRVJ më datë, 16.04.2024, përmes sistemit AMS, formë zyrtare me shkresë Nr 20/13 Prot date 16.04.2024. IAL dërgon që nuk ka komente me shkresë me Nr 1330/2 Prot. datë 23.04.2024. Në këtë mënyrë DRVJ merr formën përfundimtare si RVJ.

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër (UNISHK) është një institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.150 dt.18.04.1957, fillimisht si Instituti Pedagogjik 2 vjeçar dhe më pas me VKM 124, dt.28.05.1991 si Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës. UNISHK ka kaluar akreditimin e parë institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 70, datë 21.09.2017, riakreditimin institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 3, datë 24.01.2020, me kohëzgjatje 4 vite akademike, afati vlefshmërisë deri më 23.01.2024. Universiteti “Luigj Gurakuqi” sipas strukturës aktuale ka në përbërjen e tij gjashtë fakultete emërtuar si vijon:

1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës;
3. Fakulteti i Shkencave të Edukimit;
4. Fakulteti i Drejtësisë;
5. **Fakulteti Ekonomik;**
6. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja;

Hapja në këtë universitet e studimeve të larta në fushen ekonomike (dega administrim-biznes) u bë në Shtator të vitit 1993, me VKM nr.349, datë 10.8.1992. Deri 1996 departamenti i administrim-biznesit operonte si njësi mësimore në përbërjen e Fakultetit të Shkencave Natyrore të këtij Universiteti. Ndërsa statusin si fakultet i pavarur brenda universitetit, Fakulteti Ekonomik e fitoi në Maj të vitit 1996 (me VKM Nr.332, datë 13.5.1996). Fakulteti Ekonomik i UNISHK ka në përbërje të tij, tre njësi bazë si më poshtë:

1. **Departamentin e Turizmit;**
2. Departamentin e Administrim Biznesit;
3. Departamentin e Financë – Kontabilitetit;

Departamenti i Turizmit është krijuar me miratim MASH me daten 27.04.2006, Nr.2741Prot. Departamenti i Turizmit në vitin akademik 2022-2023 ofron programe studimi në tre cikle studimi, si më poshtë:

1. **Bachelor në ‘Turizëm’**
2. Master Profesional në “Trashigimi kulturore dhe Menaxhim Turizmi”
3. Master Shkencor në “Menaxhin i Turizmit të qëndrueshëm”
4. Doktoratë në ‘Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm’

Departamenti i Turizmit, sipas strategjisë së zhvillimit të tij 2022-2026, aspiron të jetë një ‘Pol Katalizues i Zhvillimit Rajonal’ që përgatit asete njerëzore profesioniste në përputhje me sfidat e kohës të menaxhimit të turizmit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm në funksion të tregut të punës dhe që ofron ekspertizë në fushën e studimeve ekonomike me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe rajonal duke transferuar dijen përtej komunitetit akademik për tek institucionet publike, subjektet private dhe grupet e interesit.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Turizëm"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti "Luigj Gurakuqi" i Shkodrës, <i>(tani e tutje UNISHK)</i> zhvillon të gjithë veprimtarinë e tij, në përputhje me Ligjin nr. 80 të vitit 2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë". Bazuar në misionin e Universitetit, për të krijuar, transmetuar, zhvilluar dhe mbrojtur dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe një sërë aktivitesh, njësitë kryesore dhe njësitë bazë të UNISHK ofrojnë 59 programe studimi në 3 ciklet e studimit dhe 2 programe studimi me karakter profesional, të ofruara nga 6 fakultete të UNISHK. <i>(Evidenca I: Statuti i UNISHK, Evidenca VIII: Strategjia e zhvillimit UNISHK 2022-2026, RVB)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në "Turizëm" është hartuar dhe në funksion të përmbushjes së misionit dhe qëllimeve të Universitetit të Shkodrës dhe të fushës së veprimtarisë së tij. Programi i studimit Bachelor në 'Turizëm', është ndërtuar për të përgaditur studentët në fushën e menaxhimit të turizmit. Në të janë përcaktuar objektivat për formimin e studentëve në funksion të kërkesave të kohës dhe nevojave të industrisë turistike për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit. <i>(Evidenca I: Statuti i UNISHK, Evidenca VIII: Strategjia e zhvillimit 2022-2026, RVB, Evidenca IX: Strategjia e Zhvillimit 2017-2021, Evidenca IV: Strategjia e mësimdhënies 2022-2026, Evidenca 1.2 Strategjia e Fakultetit Ekonomik 2018-2022, Evidenca 1.3: Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Turizmit 2022-2026, Evidenca 1.4: Strategjia e zhvillimit të programit Bachelor në 'Turizëm' 2023-2026, Evidenca 1.7: Regullore e programit Bachelor në 'Turizëm')</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë	Programi Bachelor në "Turizëm" është i orientuar në kah të prioritetit strategjik të zhvillimit të vendit dhe është në përputhje me dokumentat e qeverisë shqiptare, si: Strategjia Kombëtare për Arsimin (2021- 2026); Strategjia Kombëtare për



<p>për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Zhvillim dhe Integrim (2015- 2020) dhe natyrisht në përputhje Strategjinë e Zhvillimit të UNISHK për periudhën 2017-2021, 2022-2026. Tërësia e programeve bachelor që FE-UNISHK ofron i shërbejnë formimit të profesionistëve për tregun e punës lokal, kombëtar e më gjerë në ditët e sotme. Studimet në fushen e turizmit janë zhvilluar në FE-UNISHK që në vitin akademik 2001-2002 me miratim nga MASH të hapjes së programin 4-vjeçar të studimeve në “Marketing-Turizëm”, në përfundim të të cilit lëshohej diploma “Specialist Marketingu dhe Turizmi”, i cili u mbyll me hapjen në vitin akademik 2004-2005 të programit të studimeve të mirëfillta Bachelor në ‘Turizëm’ në përputhje me ndryshimet ligjore për implementimin e Deklaratës së Bolonjës dhe për t’iu përgjigjur dinamikës së zhvillimit të shpejtë të turizmit në rajonin e Veriut të vendit dhe më tej. Duhet thënë që në vite ky program studimi ka mundur të ruajë avantazhet e tij, në këtë drejtim kontribuon dhe stabiliteti në rekrutimin e studentëve në vite.</p> <p><i>(Evidenca I: Statuti i UNISHK, Evidenca IX: Strategjia e Zhvillimit në USH 2017-2021, Evidenca VIII: Strategjia e Zhvillimit në USH 2017-2021, Evidenca XIII: Guida e universitetit, Evidenca VIII: Strategjia e zhvillimit të UNISHK 2022-2026, RVB, Evidenca 2.11: Studim i tregut të punës 2018, Evidenca 1.8.1: Vendimi i MASH për hapjen e programit 4-vjeçar ‘Marketing-Turizëm’, Evidenca 1.8.1: Vendim i MASH për hapjen e programit Bachelor në ‘Turizëm’, Tabela përmbledhëse 21 e cilësisë së hyrje-daljeve të studentëve)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në ‘Turizëm’, mbështetet në një përvojë 30 vjeçare të Fakultetit Ekonomik (tani e tutje në FE), e cila është vlerë e shtuar në drejtim të konsolidimit dhe besueshmërisë të tij, por nga ana tjetër zhvillimet shumë agresive që vijnë nga tregu dhe impakti teknologjisë e digjitalizimit shtojnë nevojën e vlersimit të vazhdueshëm të punës për përmirësime, përshtatje dhe ndryshime në disa lëndë, zhvillim programesh të reja etj. Fakulteti Ekonomik në vitin akademik 2022-2023 ka 61 pedagogë, nga të cilët 31 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 30 pedagogë me kontratë (PAK) dhe 6 pedagogë ndihmës akademikë.</p> <p><i>(Aneks/Tabela 1.3: Të dhëna për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të FE, Evidenca 3.3: Curriculum vitae e personelit akademik të programit Bachelor në ‘Turizëm’ 2020-2023)</i></p>

<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Turizmit si pjesë e FE të UNISHK. Ky fakultet është i organizuar në tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Turizmit; 2. Departamenti i Administrim Biznesit; 3. Departamenti i Financë-Kontabilitetit; <p>Përputhshmëria e programit të studimit Bachelor në ‘Turizem’ me fushën akademike e kërkimore të FE është bërë e mundur nga procesi i inicuar nga MAS, për kodifikimin e programeve të studimit dhe lëndëve. E reflektuar edhe në dokumentat strategjikë të Departamentit të Turizmit (tani e tutje DT), FE dhe UNISHK, programi ka për qëllim që studentët të marrin njohuri teorike dhe praktike për të qënë sa më të aftë dhe konkurrues në fushën e ekonomisë dhe biznesit si dhe tregut lokal apo ndërkombëtar të punës. Ky program studimi është hartuar dhe organizuar sipas klasifikimit kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>(Evidenca II: Rregullore e studimit në UNISHK, Evidenca 1.5 Rregullore e FE, Evidenca 1.6: Rregullore e departamentit të turizmit, Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në ‘Turizëm’, Evidenca 2.6: Kodifikimi i programeve të studimit në USH)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, duke marrë parasysh të dhënat nga vizita në Institucion dhe Evidencat e dorëzuara vlerëson se përputhshmëria e programit të studimit Bachelor në ‘Turizem’ me fushën akademike e kërkimore të FE është bërë e mundur nga procesi i inicuar nga MAS, për kodifikimin e programeve të studimit dhe lëndëve. Institucioni ka reflektuar edhe në dokumentat strategjikë të Departamentit të Turizmit dhe programi ka për qëllim që studentët të marrin njohuri teorike dhe praktike për të qënë sa më të aftë dhe konkurrues në fushën e ekonomisë dhe biznesit si dhe tregut lokal apo ndërkombëtar të punës. Ky program studimi është hartuar dhe organizuar sipas klasifikimit kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi I.2

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UNISHK drejton të gjithë veprimtarinë e vet akademike dhe administrative në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, VKM-të e ndryshme dhe udhëzimet e MAS, mbi këtë bazë është hartuar Statuti dhe rregullorja e Universitetit “Luigj Gurakuqi”. Nga pikëpamja procedurale dhe e rregulloreve, njësitë kryesore dhe bazë kanë hartuar rregulloret e tyre, të cilat drejtojnë veprimtarinë e përditshme të tyre. Gjithashtu, për çdo vit akademik miratohet struktura akademike e universitetit dhe organika e tij. Një dokument që përcakton organizimin dhe funksionimin e mekanizmave të cilësisë, të mekanizmave dhe procedurave të sigurimit të cilësisë në nivel institucional është edhe Manuali i Cilësisë i UNISHK.</p> <p><i>(Evidenca I: Statuti i UNISHK, Evidenca II: Rregulloria e studimeve në UNISHK, Evidenca 1.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Evidenca 1.6: Rregulloria e Departamentit të Turizmit, Evidenca Strategjia e zhvillimit të UNISHK 2022-2026, Evidenca XXXVIII: Struktura akademike e USH, Evidenca XXXVII: Organigrama e USH, Evidenca X: Manuali i cilësisë i UNISHK, RVB)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e tjera brenda dhe jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj. Bashkëpunimet në fushën akademike dhe kërkimore në kuadër të marrëveshjeve të UNISHK me institucionet e tjera, janë vendimtare për arritjen e objektivave të procesit mësimor të programeve të studimit të ofruara nga FE. Po kështu, FE ka marrëveshje bashkëpunimi me biznese dhe shoqata që kujdesen për industrinë e udhëtimit. Marrëveshjet me institucionet, organizatat dhe firmat tregtare janë pasqyruar në dokumentacionin e RVB.</p> <p><i>(Evidenca XXXVI: Mbi marreveshjet e UNISHK me Universitetet te huaja dhe ente publike gjatë 2019-2023, Evidenca XXI: Marrëveshja e bashkëpunimit mes Clean Score dhe USH, Evidenca 1.10.3: Marrëveshjet e bashkëpunimit të USH dhe FE-së me institucione dhe ente publike të tjera, Evidenca 1.10.2: Marrëveshje bashkëpunimi</i></p>




	<p><i>të USH me biznese turistike të rajonit verior të vendit për zhvillim turizmi të qëndrueshëm)</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Për arritjen e qëllimeve të procesit të mësimdhënies dhe trajnimit të studentëve, UNISHK-u ka marrëveshje bashkëpunimi kornizë institucionale si me ndërmarjet publike ashtu edhe me ato tregtare. Këto marrëveshje kanë ndihmuar edhe në avancimin e praktikës profesionale. Janë arritur 20 marrëveshje bashkëpunimi institucional për vitin akademik 2022–2023 me qëllim avancimin e praktikave me agjencitë qeveritare dhe bizneset e lidhura me turizmin. Senati Akademik ka miratuar rregulloret përkatëse për rregullimin e marrëdhënieve të palëve dhe organizimin e praktikës. <i>(Evidenca LI: Vendim i Senatit Akademik për miratimin e paketës së praktikës Bachelor dhe Master, Evidenca 1.10.1: Marrëveshje bashkëpunimi të USH me subjektet pritëse të praktikës për zhvillimin e praktikës profesionale)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë, pedagogët dhe GVB, diskutuam për mënyrën si merret dhe analizohet feedback-u i bashkëpunimit. Në diskutimin tonë me GVB-në, pedagogët dhe drejtuesit e njësisë kryesore u shpjegua mënyra se si merret dhe vlerësohet kontributi i bashkëpunimit me partnerët. Raporti vjetor i veprimtarive kërkimore-arsimore dhe shkencore përgatitet nga Departamenti i Turizmit. Përfitimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të zbatimit të programeve të studimit të këtij departamenti përfshihen edhe në këto raporte periodike vjetore të analizës së punës mësimore-shkencore. Këto përfitime përfshijnë përfitimet reciproke për zhvillimin e leksioneve të hapura nga ekspertë të lëndës, krijimin e seminareve dhe konferencave shkencore, trajnimit dhe shkëmbimin e përvojave të pedagogëve, lëvizshmërinë e studentëve dhe konkretizimin e koncepteve teorike në bizneset fitimprurëse të turizmit.</p> <p><i>(Evidenca 1.9.1, 1.9.2, 1.9.3: Analiza vjetore e departamentit të turizmit për punën akademike dhe shkencore të tre viteve të fundit, Evidencë 3.4: Relacion vjetor për zhvillimin e praktikës profesionale dhe ekspeditës në terren të programit Bachelor në ‘Turizëm’ 2021-2022, Evidenca 3.13.3: Relacion të aktivitetit të studentave të Turizmit për markim shtigjes dhe digjitalizim në hartë- Kalaja Danjes, Evidenca 3.13.4: Relacion mbi aktivitet studenteve të turizmit me studentet belg të turizmit ‘Projekti WOW Albania2023’ për zhvillim koncept produktesh turistike inovative për Rajonin e Shkodrës, Evidenca 3.5.2: Raportim mbi leksionet dhe seminarët e</i></p>




	<i>hapura për studentët e Turizmit, Evidenca 3.17: Relacion mbi pjesmarrjen në projektin Erasmus+ në Universitetin e Wdzemes, Latvia, 2022)</i>			
Konkluzione	Nga takimet në Institucion dhe dokumentacioni i dorëzuar GVJ konkludon se Institucioni siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit dhe vlerëson që Departamenti i Turizmit përmbush plotësisht këtë standard. Raporti vjetor i veprimtarive kërkimore-arsimore dhe shkencore përgatitet nga Departamenti i Turizmit në të cilin paraqiten dhe përfitimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të zbatimit të programeve të studimit të këtij departamenti përfshihen edhe në këto raporte periodike vjetore të analizës së punës mësimore-shkencore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit	Programi i Studimit Bachelor në 'Turizëm' i ofruar nga Departamenti i Turizmit është i strukturuar në 3 vite studime, 6 semestra të rregullt me 180 ECTS përgjatë tre viteve, 60 kredite në vit, 30 kredite në çdo semestër. Ky program studimi u përshtat nga programi fillestar 4 vjeçar, në përputhje me Sistemin e Bolonjës dhe u fokusua si program Bachelor në fushën e menaxhimit të turizmit. Programi dhe Plani mësimor i programit të studimit ka të gjithë elementët në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UNISHK dhe udhëzimet e MAS në këtë drejtim. Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët

<p>dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>janë me 4 deri 10 ECTS, duke patur ndryshime në numrin e orëve mësimore. Programi i studimit është i ndërtuar sipas Rregullores së Programit. Programi është i detajuar sipas planit mësimor i cili zbërthen çdo lëndë dhe modul në orë dhe kredite. Orët e punëve të pavarura të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1 500 orëve mësimore vjetore. Përqindja totale e krediteve të lëndëve të kategorive A ‘Lëndët bazë’ dhe të kategorisë B ‘Lëndët karakterizuese’ është më shumë se 70% (72.7%). Mbështetur në Tabelat Përmbledhëse të RVB, planin mësimor, programi është organizuar si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 3 vite akademike/6 semestra; • kredite për semester 30/ për vit akademik 60; • numri i lëndëve/moduleve 25, përfshirë praktikën dhe diplomën; • ngarkesa mësimore javore 20-22 orë, mesatarisht 21.5 orë në javë • forma e mësimdhënies: Leksione/ seminare/ ushtrime/ projekt / detyra kursi • Dy veprimtarri formuese, me 2—6 alternativa zgjedhjeje, ofrohen me zgjedhje nga vetë studentët, të gjitha lëndër e tjera janë të detyrueshme • Të gjitha lëndët janë lëndë ‘Provim’, përveç lëndës ‘Gjuhë e huaj’ e vitit të parë që është lëndë ‘Firmë’. • ngarkesa mësimore totale 4500 orë: 1655 orë në auditor; 2620 orë jashtë tij, 225 orë praktikë. <p><i>(Evidenca I: Statuti i UNISHK, Evidenca II: Rregullore e studimit në UNISHK, Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit, Evidenca 2.1: Plani Mësimor Bachelor 'Turizëm' 2020 - 2023, Evidenca 2.2: Syllabuset sipas viteve dhe lëndëve, Tabelat përmbledhëse të RVB nr. 9, 10, 13 për planin mësimor Bachelor në 'Turizëm' 2020-2023)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri,</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Turizëm ka si qëllim të ofrojë njohuri bazë për formim të gjithanshëm profesional e shkencor dhe aftësim praktik për specialistë të lartë në shërbim të zhvillimit të turizmit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendi. Në funksion të këtij qëllimi janë vendosur objektivat përkatëse në strategjinë e zhvillimit të programit Bachelor në ‘Turizëm’:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurim për studentët i njohurive teorike dhe aftësive praktike themelore për të hartuar, menaxhuar, dhe shpërndarë shërbime turistike për një shumëllojshmëri vizitorësh në

<p>aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>strukturat dhe vendet e ndryshme turistike</p> <ul style="list-style-type: none"> •Sigurim i një mundësi për të mësuar, zhvilluar dhe praktikuar aftësitë kerkimore, të zgjidhjes së problemeve, aftësitë sipërmarrëse dhe të menduarit kritik. •Sigurim i përgatitjes së duhur për Programin Master •Sigurim i një mundësi edhe për ata që tashmë janë në industrinë turistike për të fituar njohuri dhe aftësi të avancuara të rëndësishme për pozicionet me të përgjegjeshme menaxheriale. •Përmirësim i nivelit të profesionalizmit në industrinë e turizmit nga sigurimi i profesionistëve të arsimuar universitar në fushat e turizmit •Sigurim i përshtatjes së programit të studimit me nivelin e kërkesave të kohës dhe nevojat e industrisë turistike dhe të ofrojë njohuritë bazë të nevojshme për vazhdimin e ciklit të dytë të studimeve. <p>Në strukturën e programit studimi ka lëndë gjithashtu që mundësojnë dhënien e njohurive dhe aftësimin e studentëve në një spektër të gjerë fushash dhe disiplinash të lidhura me botën e biznesit dhe funksionet që zhvillohen brenda tij. Programi është ndërtuar në përputhje me VKM 41/2018 përsa i përket përmbajtjes sipas kategorive: Lëndë bazë, Lëndë karakterizuese, Lëndë plotësuese, Lëndë ndërdisiplinore dhe Detyrime përmbyllesë</p> <p><i>(Evidenca 2.1: Plani mësimor Bachelor 'Turizëm' 2020 - 2023, Evidenca 1.7: Rregullorja e programit Bachelor në Turizëm, Evidenca 1.3: Strategjia e zhvillimit të programit Bachelor në Turizëm 2022-2026)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi është ndërtuar në përputhje me VKM 41/2018 përsa i përket përmbajtjes sipas kategorive: Lëndë bazë, Lëndë karakterizuese, Lëndë plotësuese, Lëndë ndërdisiplinore dhe Detyrime përmbyllesë, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> A. Lëndë bazë: 4 lëndë, 37 kredite, (20.5%), B. Lëndë karakterizuese: 11 lëndë, 94 kredite (52.2%), C. Lëndë ndërdisiplinore: 4 lëndë, 24 kredite, (13.3 %), D. Lëndë plotësuese: 3 lëndë, 19 kredite, (10.6%), E. Detyrime përmbyllesë: Provim formimi/Punim diplome, 6 kredite, (3.3%), <p>Përqindja totale e krediteve të lëndëve të kategorive A 'Lëndët bazë' dhe të kategorisë B 'Lëndët karakterizuese' është mbi 70% (pikërisht 72.7%) të totalit të krediteve të programin</p>




	<p>“Bachelor” në ‘Turizëm’.</p> <p><i>(Evidenca 2.1: Plani mësimor Bachelor ‘Turizëm’ 2020 - 2023, Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit ‘Bachelor në ‘Turizëm’, Evidenca2.1: Plani Mësimor Bachelor ‘Turizëm’ 2020 - 2023, Tabelat përmbledhëse të RVB nr.9 për veprimtaritë formuese të planit mësimor Bachelor në Turizëm 2020-2023)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Turizëm" ka të përcaktuar një ngarkesë prej 10 kreditesh për praktiken profesionale dhe 6 kredite për detyrimet përmblylëse. Gjatë vizitës në institucion, u diskutua për mënyrën si organizohet praktika. Departamenti caktoi një grup pedagogësh për organizimin dhe ndjekjen e saj, si rregull zhvillimi i praktikës shtrihet në dy semestra të vitit të tretë, përkatësisht 5 javë mësimore në semestrin e parë dhe 4 javë në semestrin e dytë. Praktika zhvillohet sipas rregullores së organizimit të praktikës në USH.</p> <p>Praktika zhvillohet pranë organizatave me të cilat USH dhe FE ka marrëveshje institucionale. Në këto subjekte pritëse të praktikës publike apo private, praktika e studentëve mbikëqyret gjithashtu nga mbikëqyrsi i subjektit pritës të praktikës me të cilin lidhet marrëveshje në dakortësi të pedagogut titullar të lëndës së praktikës dhe studentit që zhvillon praktiken në atë subjekt pritës të praktikës.</p> <p>Në fund të saj, studentët përgatisin dosjen dhe detyren e kursit, të cilën e mbrojnë përpara një komisionit të pedagogve të praktikës dhe vlerësohen me notë, ku 40% të vlersimit e zë vlersimi nga punonjësi mbikëqyrsi i praktikës i subjektit pritës të praktikës dhe 60 % e zë vlersimi i komisionit për dosjen e praktikës dhe mbrojtjen e detyrës së kursit për praktiken sipas planit të lëndës së praktikës.</p> <p><i>(Evidenca 1.10.1: Marrëveshje e USH me institucionet dhe bizneset turistike për praktikën, Evidenca LI: Paketa e praktikës në programet e studimit Bachelor dhe Master në USH, Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në ‘Turizëm’, Evidenca 2.1: Plani mësimor i programit Bachelor në ‘Turizëm’ sipas viteve, Evidenca 2.2: Syllabusi ‘Praktika profesionale’)</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet</p>	<p>N/A</p>




<p>e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi studimit i ofruar nga Departamenti i Turizimit në FE të UNISHK, ka ngjashmëri me programet e turizimit të ofruara nga universitetet shqiptare.</p> <p>Fillimisht hartimi i programit të studimit Bachelor në 'Turizëm' është bërë nga ekspertë të Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Eberswaldit Gjermani, të mbështetur nga Konferenca e Rektorëve Gjermanë. Nuk kemi informacion për % e ngjashmërisë me planet mësimore për programet e tjera në sistemin shqiptar të fushës së turizmit.</p> <p><i>(Evidenca 2.9: Raporti Final 2002 i Universiteti i Eberswalde të shkencave të aplikuara dhe HRK, Gjermani - analizë e mundësisë së hapjes Bachelor në Turizëm në USH)</i></p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Bazuar në VKM Nr. 310, dt 11.05.2022 për specifikimet dhe kodifikimet e programieve të studimit të ofruara nga IAL-të, si dhe në udhëzimet e MAS, kodifikimi i fundit për këtë program studimi është bërë në Mars të vitit 2023, nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë në USH.</p> <p><i>(Evidenca 2.6: Shkresa drejtuar MAS - Kodifikimi i programit Bachelor 'Turizëm', nr. 196/1 datë 23.03.2023)</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>N/A</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në Institucion GVJ vlerëson se programi studimit i ofruar nga Departamenti i Turizimit në FE të UNISHK, ka ngjashmëri me programet e turizimit të ofruara nga universitetet shqiptare. Fillimisht hartimi i programit të studimit Bachelor në</i></p>




	<i>'Turizëm' është bëtë nga ekspertë të Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Eberswaldit Gjermani, të mbështetur nga Konferenca e Rektorëve Gjermanë. GVJ konstaton mangwsi infomacioni për pwrqindjen e ngjashmërisë me planet mësimore për programet e tjera në sistemin shqiptar të fushës së turizmit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore (FE) përmbush detyrimet ligjore në lidhje me numrin e njësive bazë (gjithsej 3 Departamente), dhe numrin e pedagogëve dhe gradat/titujt në përputhje me nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"). Fakulteti Ekonomik i UNISHK ka në përbërje të tij, tre njësi bazë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamentin e Turizmit; 2. Departamentin e Administrim Biznesit; 3. Departamentin e Financë – Kontabilitetit; <p>Njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në 'Turizëm' përmbush detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. Departamenti i Turizmit përmbush gjitha kriteret ligjore të përshkruara në ligjin e arsimit të lartë 80/2015, mbi funksionimin e njësisë bazë. Ai ka në përbërjen e tij 9 anëtar, ku 1 anëtar me titullin akademik 'Profesor', 2 anëtar me titullin akademik 'Profesor i asociuar', 4 anëtarë me me gradën shkencore 'Doktor' dhe 2 anëtar asistent lektor në proces doktorature. Në bazë të nevojave te departamentit në fillim të çdo viti akademik miratohet angazhimi i pedagogëve të jashtëm. Për vitin 2022-2023 numri PAK është 8, me gradën shkencore Msc.</p> <p><i>(Evidenca I: Statuti i USH, Evidenca II: Rregullorja e përgjithshme USH, Evidenca 1.5: Rregullorja e FE, Evidenca 1.11: Struktura organizative e FE, Tabela përmbledhëse 1.3: Të dhëna 2022-2023 për personelin</i></p>

	<i>akademik dhe ndihmës akademik në tre njësitë bazë të FE, Tabela përmbledhëse 2.3: Të dhëna 2022-2023 për personelin akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në DT)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	<p>Njësia kryesore (FE) dhe ajo bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në 'Turizëm', i përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik dhe atë /administrativ për realizimin e praktikave mësimore.</p> <p><i>(Evidenca 1.5: Rregullorja e FE, Evidenca 1.6: Rregullorja e departamentit të turizmit, Evidenca 1.7: Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Turizëm, Tabela përmbledhëse 1: Të dhëna për personelin akademik dhe ndihmës akademik në tre njësitë bazë të FE, Tabela përmbledhëse 2: Të dhëna për personelin akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në DT)</i></p>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Emërtimi i koordinatorit të programit të studimit përcaktohet në rregulloren e programit të studimit Bachelor "Turizëm". Rregullorja e Departamentit të Turizmit specifikon saktësisht se çfarë pritet të bëjë koordinatori i programit të studimit.</p> <p>GVJ konstaton se ndër të tjera, koordinatori i programit është i ngarkuar për organizimin e ndërveprimeve të departamentit me studentët, mbikëqyrjen e realizimit të praktikës, koordinimin me drejtuesin e kursit të praktikës profesionale për organizimin e praktikës dhe kërkimin e informacionit prej tij në lidhje me zbatimin e programit. Në përputhje me protokollat e personelit administrativ, personi përgjegjës i departamentit të turizmit organizon ekskursione në terren në përputhje me standardet profesionale të praktikave, mban lidhje të mira me institucione dhe biznese që lidhen me turizmin për mundësi zhvillimit të praktikave profesionale.</p> <p><i>(Evidenca 1.6: Rregullore e Departamentit të Turizmit, Evidenca 1.7: Rregullorja e programit Bachelor në 'Turizëm', Evidenca 1.12: Vendim DT për caktimin e kordinatorit të programit Bachelor në Turizëm, Evidenca 3.4: Relacione mbi zhvillimin e praktikës dhe ekspeditën në terren për bachelor Turizem viti 2021-2022)</i></p>
Konkluzione	<i>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në Institucion vlerëson se Njësia kryesore dhe Njësia bazë, përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, angazhimin edhe të personelit ndihmës akademik /administrativ etj. GVJ konstaton se koordinatori i programit është i ngarkuar për organizimin e</i>




	<i>ndërveprimeve të departamentit me studentët, mbikëqyrjen e realizimit të praktikës, koordinimin me drejtuesin e kursit të praktikës profesionale për organizimin e praktikës dhe kërkimin e informacionit prej tij në lidhje me zbatimin e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti përgjegjës për programin e studimit Bachelor në turizëm, disponon të dhënat e kërkuara për strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit, përfshirë kurrikulën, shpërndarjen e lëndëve dhe rregulloret.</p> <p>Në vitin 2018 u prezantua softueri SMAK, i cili dixhitalizoi punën e njësive bazë dhe kryesore. Planet e mësimi, ngarkesat e mësuesve, kontratat, informacioni personal, raportet e ngarkesës mësimore dhe raportet financiare për përfundimin e mësimave pasqyrohen të gjitha në mënyrë dixhitale. Bazuar në dosjen e plotë të programit të studimit, në përmbajtjen e syllabuseve, në mënyrën e konceptimit të orës së mësimi, kontrollit të njohurive, të ftuarit në leksion, evidentohet që pedagogët përpiqen pikërisht të bashkojnë nevojat lokale me ato globale, por mbetet ende për t'u bërë në drejtim të teksteve të mësimdhënies dhe mbi të gjitha formalizimit në syllabuseve të tyre, etj. Në faqen zyrtare në internet të UNISHK, studentët e FE njihen mbi dokumentat kryesore, planet dhe programet mësimore dhe shumë informacione të tjera në funksion të regjistrimeve dhe kalendarit akademik:</p> <p>https://unishk.edu.al/universiteti/fakultetet/fakulteti-ekonomik</p> <p><i>(Evidenca I: Statuti i USH, Evidenca II: Rregullore e studimeve në USH, Evidenca XXIV: Sistemi SMAK, Evidenca XXXIX: Miratimi I paketës së provës finale në USH, Evidenca LI: Miratimi i paketës së praktikës së praktikës në USH, Evidenca 1.5 Rregullore e FE, Evidenca 1.6: Rregullore e Departamentit të Turizmit, Evidenca 1.7: Rregullore e programit të Studimit Bachelor në Turizëm, Evidenca 2.1: Plani mësimor Bachelor 'Turizëm' 2020 -</i></p>

	<p>2023, Evidenca 2.2: Paketa e syllabuseve për programin Bachelor në Turizëm 2020-2023)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Mbështetur në VKM 41/2018 dhe në Rregulloren e Programit të studimit, në programi e studimit Bachelor në ‘Turizëm’ janë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara nga A-E dhe me ngarkesën përkatëse mësimore në orë (në auditor dhe jashtë auditorit) dhe peshen në kredite ECTS për çdo lëndë/modul. Përqindja totale e krediteve të lëndëve të kategorive A ‘Lëndët bazë’ dhe të kategorisë B ‘Lëndet karakterizuese’ është mbi 70% (pikërisht 72.7%) të totalit të krediteve të programin “Bachelor” në ‘Turizëm’. Orët e punëve të pavarura të studentit në çdo vit të programit të studimit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve mësimore vjetore.</p> <p>Mbështetur në RVB dhe në Planin e Programin mësimor sipas viteve, programi studimit është organizuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 3 vite akademike/6 semestra; • kredite për semester 30/ për vit akademik 60; • ngarkesa mësimore totale 4500 orë: 1655 orë në auditor; 2620 orë jashtë auditorit, 225 orë praktikë; • ngarkesa mësimore në javë 20-22 orë, mesatarisht 21.5 orë në javë <p>Për çdo lëndë të përfshirë në programin e studimit janë të përcaktuara kreditet, ngarkesa mësimore në orë mësimore, orët javore në auditor dhe orët jashtë auditorit, forma e shlyerjes së tij. Syllabuset e lëndëve, përcaktojnë mënyrën e vlerësimit ku përgjithësisht është zgjedhur një sistem vlerësimi që i jep provimit përfundimtar shumë peshë (70%-80%), gjë që e kufizon vlerësimin e vazhduar gjatë gjithë semestrit, megjithëse është brenda hapsirës së lejuar (20-40%) që rregullorja e studimit në USH përcakton për vlerësimin e vazhduar gjatë semestrit (neni 30/4).</p> <p><i>(Evidenca II: Rregullorja e studimeve në USH, Evidenca 1.5: Rregullorja e studimeve në FE, Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në ‘Turizëm’, Evidenca 2.1: Plani mësimor i programit Bachelor në Turizëm 2020-2023, Evidenca 2.2: Paketa e syllabuseve për programin Bachelor në Turizëm 2020-2023)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha</p>	<p>Kriteret e pranimit të studentëve në Programin e studimit Bachelor në ‘Turizëm’ janë kriteret ligjore të përcaktuara nga</p>




<p>informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>MAS dhe udhëzimet që dalin për rregjistrimet në universitete çdo vit akademik. Në Rregulloren e UNISHK dhe të programit të studimit, qartësohen kushtet dhe procedurat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit. Përgjithësisht për programin e studimit Bachelor në 'Turizëm' nuk përcaktohen kritere shtesë përpos kritereve ligjore. Në dosjen e plotë të dokumentave në platformën e ASCAL gjenden dhe shembuj të ekuivalentimit të studimeve.</p> <p><i>(EVIDENCA I: Statuti i UNISHK, Evidenca II: Rregullore e studimit në UNISHK, Evidenca 1.5: Rregullore e FE, Evidenca 1.6: Rregullore e DT, Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në 'Turizëm', Evidenca 2.8: Procedurë ekuivalentimi për studentën Bachelor në Turizëm me Erasmus+)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset për çdo lëndë përfshijnw elementwt e VKM 41 tw ndryshuar. Nw to janw paraqitur njohuritë e nevojshme për praktikat, seminarët dhe të gjithë elementët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit, ofrohet me programin e studimit Bachelor në "Turizëm". Pas miratimit të syllabuseve të lëndëve përkatëse, ato firmosen nga Përgjegjësi i Departamentit dhe dërgohen në formë elektronike në degën e kurrikulave nga Dekani e fakultetit. <i>GVJ konstaton se syllabuset aktuale përnbajnë një pjesë të rëndësishme të informacionit të strukturës ligjore, por mungon shpjegim i detajuar i temave sipas javëve, shoqëruar me literature për çdo temë dhe faqet e literaturës.</i></p> <p><i>(Evidenca II: Rregullorja e studimit në USH, Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor ne Turizëm, Evidenca 2.2: Paketa syllabuseve të planit mësimor Bachelor në 'Turizëm' 2020-2023)</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Për të plotësuar kërkesat e industrisë turistike në rritje, përmirësimi i programit Bachelor në 'Turizëm' përditësohet dhe përmirësohet vazhdimisht. Çdo rregullim përfundimtar autorizohet në fillim të vitit akademik dhe kërkesa i paraqitet Senatit Akademik për miratim duke e depozituar në drejtorinë e kurrikulës.</p> <p>Modifikimet më aktuale në programin Bachelor në "Turizëm", të cilat nuk e kalojnë modifikimin e lejuar prej 20%, u zbatuan në vitin 2021. Këto modifikime kishin të bënin me rëndësinë relative të lëndëve bazë si dhe me shtimin e dy lëndëve zgjedhore që shërbejnë si ekstrakulikulare jashtëshkollore për zhvillimin profesional të tw studentwew.</p>

	<i>(Evidenca 2.7: Vendim Departamentit të Turizmit për miratim të planit mësimor 2021-2022 Bachelor në 'Turizëm' me ndryshime dhe miratimi i tyre në SA)</i>			
Konkluzione	Nga shqyrtimi i Evidencave dhe dokumentacionit të dorëzuar, si dhe nga vizita dhe takimi me drejtuesit e Institucionit, GVJ konstatoi se formati i syllabuseve në një pjesë të madhe nuk ishin sipas VKM 41/2018, e ndryshuar. GVJ konstaton se syllabuset aktuale përmbajnë një pjesë të rëndësishme të informacionit të strukturës ligjore, por mungon shpjegim i detajuar i temave sipas javëve, shoqëruar me literature për çdo temë dhe faqet e literaturës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Nga vizita në institucion dhe konsultimi me planet mësimore dhe rregulloret përkatëse, të programit Bachelor në "Turizëm" dhe syllabuset e tij plotësojnë njëra-tjetrën, duke i lejuar studentët të zgjerojnë arsimin e tyre dhe të zhvillojnë aftësi që do të jenë të dobishme si për punë ashtu edhe për studime në të ardhmen.</p> <p>GVJ konstaton se ka një shpërndarje të duhur të orëve të mësimin ndërmjet leksioneve dhe seminareve, ngarkesa mësimore e lëndës në kredite ECTS, dhe integrimi i njohurive teorike me studimet e rasteve, detyrat e lëndëve dhe përvojën praktike i lejojnë studentët të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në përgatitje për punësim si student ose për studime të mëtejshme në ciklin e dytë. Programi përditësohet dhe përmirësohet vazhdimisht. Çdo rregullim përfundimtar autorizohet në fillim të vitit akademik dhe kërkesa i paraqitet Senatit Akademik për miratim duke e depozituar në drejtorinë e kurrikulës.</p> <p><i>(Evidenca 2.1: Plani mësimor Bachelor në 'Turizëm' 2020-2023)</i></p>




<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Kurrikula Programit Bachelor i Turizmit është e ndarë në gjashtë semestra që përfshijnë tre vite akademike, me dy semestra për vit akademik. Studentët mund të zgjedhin nga gjithsej 22 lëndë të ofruara gjatë tre viteve të studimit: shtatë lëndë në vitin e parë, njëra prej të cilave është e dizajnuar me dy module; shtatë lëndë në vitin e dytë, një tjetër prej të cilave është projektuar me dy module; dhe tetë lëndë në vitin e tretë, të cilat përfshijnë dy lëndë zgjedhore me opsione të shumta, praktikë profesionale për nëntë javë dhe një provim ose mbrojtje të tezës së diplomës. Ngarkesa nw punë të pavarur të studentit gjatë një viti wshtw gjysma e ngarkesws totale. Bazuar nw dokumentacionin e vwnw nw dsipozicion, ndarja e vperimtarive formuese dhe ngarkesws repsektive tw saj wshtw si vijon: lëndëve të kategorive A ‘Lëndët bazë’ dhe të kategorisë B ‘Lëndet karakterizuese’ është mbi 70% (pikërisht 72.7%). Ndwrkohw sipas planit mwsimor A-37 kredite, B- 94 kredite, C - 24 kredite, D- 19 kredite, dhe E detyrime përmbyllëse, provim formimi ose punim diplome, 6 kredite.</p> <p>GVJ gjykon se kwto veprimtari formuese garatojnë arritjen e objektivave formuese të programit të studimit Bachelor në Turizem, si dhe rezultat e pritshme.</p> <p><i>(Evidenca 1.7: Rregullorja e program të studimit Bachelor në ‘Turizëm’, Evidenca 1.4: Strategjia e zhvillimit të programit Bachelor në Turizëm 2023-2026, Evidenca 2.1: Plani mësimor Bachelor në Turizëm 2020-2023, Tabela përmbledhëse nr.9 mbi veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në Turizëm 2020-2023)</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe titujt e tyre, si dhe ngarkesa e krediteve janë të gjitha në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Kredive (ECTS), i cili është përshtatur me sistemin e Bolonjës, si dhe me akte dhe rregulla të tjera nënligjore që rregullojnë arsimin e lartë dhe aktet e brendshme tw institucionit.</p> <p>Shpërndarja e teorisë dhe praktikës së programit është tërësisht në përputhje me qëllimet akademike dhe kërkimore të FE, si dhe me përvojat më të mëdha brenda dhe jashtë shtetit.</p> <p>Nga diskutimi me personelin akademik, ne u informuam se disa institucione si Sandnills Community College (SCC), në Shtetet e Bashkuara, ka ofruar përmirësime në programin Bachelor në Turizëm, i cili fillimisht u krijua nga profesionistë të turizmit nga Universiteti i Eberwald në Gjermani. Studentët që kanë ndjekur këtë kurrikulë Bachelor të Turizmit kanë marrë pjesë</p>

	<p>në praktika tremujore në Itali, praktika njëvjeçare në Amerikë dhe programe të lëvizshmërisë Erasmus+. GVJ e konsideron kwtw eksperiencw si praktikw tw mirw dhe duhet tw ndiqet mw tej nga ana e ishtitucionit</p> <p><i>(Evidence 'RVB', Evidenca VI: Strategjia e ndërkombëtarizimit e USH 2022-2026, 2017-2021, Evidenca 2.9: Raporti Final 2002 Universiteti Ebersälde dhe HRK në Gjermani -analize e mundësisë së hapjes Bachelor në Turizëm në USH, Evidenca 1.15: Mobilitete të stafit dhe studentëve të FE 2020-2023, Evidenca 2.12.1 :Relacion mbi intershipin jashtë vendi të studenteve të Turizmit 2021, 2022, Evidenca 2.12.2: Relacion mbi disa trajnime të studentëve të Turizmit gjatë 2021 2022, Evidenca 2.12.3: Informacion mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte)</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga takimi me studentwt, GVJ konstaton se studentët mund të përforcojnë njohuritë e tyre teorike dhe t'i zbatojnë ato në praktikë falë raportit leksion/seminar/praktikë. Planprogramet e lëndëve janë të dizajnuara për të përfshirë studimet e rastit, lëndët dhe kuptimin praktik të operimit në industrinë e turizmit si organizata publike. Në suplementin e diplomës ka mjaft informacione për të lejuar transferimin e krediteve dhe njohjen botërore të kredencialeve.</p> <p><i>(RVB, Evidenca 2.5: Suplement diplomës Bachelor në Turizëm, Evidenca 2.2: Paketa e syllabuseve të programit studimit Bachelor në Turizëm, Evidenca 2.12.1: Relacion mbi intershipin jashtë vendi të studenteve të Turizmit 2021, 2022, Evidenca 2.8: Proçedurë ekuivalentimi për mobilitet studentit me Erasmus+, Tabela përmbledhëse nr.23: Të dhëna mbi diplomuarit Bachelor në Turizëm ndër vite dhe punësimin e tyre)</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Në takimin në institucion me personelin akademik të Departamentit të Turizimit, na u theksua që: Programet e lëndëve të programit të studimit Bachelor në Turizëm, përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në koherencë me nevojat e tregut të punës duke i zhvilluar temat e leksioneve me literaturë dhe botime bashkëohore. Personeli na informoi se kjo ishte bërë e mundur edhe falë plotësimit të kërkesave të tyre, me libra nga Sandhills Community College, SHBA. Gjithashtu ka ndihmuar në përditsimin e leksioneve dhe seminareve edhe lëvizja e pedagogve me mobilitete në universitete të ndryshe europiane dhe amerikane.</p> <p><i>(Evidenca 4.9:Lista e librave dhuruar nga Prof.Ted Oelfke të SCC në SHBA, Evidenca 1.15: Mobilitete të stafit dhe</i></p>




	<p><i>studentëve të FE 2020-2023, Evidenca 1.16: Mobilitete të PAE së DT 2015-2020, Evidenca 3.17: Relacion mbi pjesmarrjen me projektin ERASMUS + ne Universitetin Widzemes, Latvia, 2022, Evidenca 2.2: Paketa e Syllabuseve të programit Bachelor në Turizëm 2020-2023)</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Qëllimi dhe objektivat e këtij programi studimi janë në përputhje të plotë me qëllimin që Ligji i Arsimit të Lartë i atribuon programeve bachelor. Struktura dhe përmbajtja e programit, përmbajtja e syllabuseve, raporti teori-praktikë synon të garantojë formimin të mirë të studentëve nga pikëpamja e njohurive dhe aftësimit praktik, për t’ju përgjigjur dinamikave të tregut lokal dhe global.</p> <p>Element i rëndësishëm është fokusimi i studentëve në raporte ndërveprimi me tregun e punës përmes orëve të hapura, Panairit të Punës, vizitave në biznese dhe konkurseve të mbështetura nga biznesi. Mënyra si konceptohet dhe zhvillohet praktika mësimore, krijon hapësira për aftësimin, por dhe oportunitet për t’u punësuar.</p> <p>FE kishë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me bizneset duke krijuar ‘Forumit e përbashkët Fakultet Ekonomik-Palë interesi’ me synim realizim të aktiviteteve me interes të përbashkët; shkëmbim informacioni, ide dhe eksperiencë për fusha me interes të përbashkët në përgjithsi dhe në veçanti për tregun e punës dhe punësimin e studentëve dhe diplomuarve të FE. UNISHK dhe departamenti i Turizimit duhet të jenë vazhdimisht proaktive në raportet me bizneset për projekte të përbashkëta dhe përfshirjen e studentëve në to.</p> <p><i>(Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm, Evidenca 2.2: Paketa e Syllabusve të programit Bachelor në Turizëm sipas viteve -Syllabusi i Praktikës, Evidenca 3.4: Relacioni i realizimit të praktikës dhe ekspeditës në terren në vitin akademik 2021-2022, Evidenca 1.14: Raport i Panairit të Punës së FE ndër vite, Tabelat përmbledhëse nr.9, 10 të RVB, Evidenca 1.10.4: Marrëveshje bashkëpunimi i FE dhe palëve të interesit)</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në ‘Turizëm’, i pajis studentët me njohuritë e nevojshme teorike dhe shkencore që janë bazë për vazhdimin e mëtejshëm të studimeve për thëhim të njohurive teorike dhe shkencore dhe aftësive praktike në fushën e menaxhimit të turizmit dhe në fusha të tjera të ekonomisë dhe më gjërë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.</p>




me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Turizëm i pajis studentët me njohuritë dhe aftësitë e duhura për karrierë hyrëse menaxheriale apo specialisti në biznese turistike ose organizata dhe institucione që lidhen me turizmin.</p> <p>Nga takimi me pedagogët dhe studentët u vu në dukje se DT bazuar në lidhjet që ka me bizneset turistike dhe nga nevojat që kanë këto biznese për punonjës në operacionet bazë, studentët e turizmit inkurajohen për të filluar punën që pas vitit të parë në mënyrë që studentët të krijojnë eksperiencën e duhur praktike të këtyre operacioneve për ta patur më të lehtë fillimin e punës në menaxhim pas diplomimit të tyre.</p> <p>Mënyra si konceptohet dhe zhvillohet praktika mësimore, krijon hapësira për aftësimin, por dhe oportunitet për t'u punësuar</p> <p><i>(Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm, Evidenca 2.1: Plani mësimor Bachelor në Turizëm 2020-2023 , Evidenca 2.2: Paketa e syllabuseve të programit të studimit Bachelor në Turizëm 2020-2023, Evidenca 1.14: Raport i Panairit të Punës së FE ndër vite, Evidenca 1.10.4: Marrëveshja midis FE dhe palëve të interesit, Evidenca 2.11: Studimi i Tregut të Punës, Tabela përmbledhëse nr.23: Të diplomuarit dhe të punësuarit ndër vite)</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ, pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe Evidencat e dorëzuara, si dhe nga ato të shqyrtuara gjatë vizitës dhe takimeve në Institucion shprehet se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit, rezultatet e të nxënit si dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës. GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.5	
<p>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve




Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.

Tregu i punës është në disa dinamika lokale dhe globale, të cilat kanë kapërcyer të gjitha projeksionet e ekspertëve të hartimit të programeve. Ekzistojnë praktika të mira të bashkëpunimit FE- industri, por ato kanë nevojë të bëhen më të qëndrueshme, madje dhe në nivel departamenti.

FE vijon të ketë studentë, ndonëse shumë programe studimi në universitet e më gjerë, kanë filluar tkurrjen dhe ky avantazh do të duhet të shoqërohet me shumë dinamikë. Pozitive janë raportet e pedagogëve me organizatat që lidhen me turizmin/bizneset turistike, bashkëpunimi me të cilët në shumicën e rasteve është i formalizuar.

FE kishtë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me organizata/biznese duke krijuar 'Forumit e përbashkët Fakultet Ekonomik-Palë interesi' me synim realizim të aktiviteteve me interes të përbashkët; shkëmbim informacioni, ide dhe eksperiencë për fusha me interes të përbashkët në përgjithsi dhe në veçanti për tregun e punës dhe punësimin e studentëve dhe diplomuarve të FE.

Ndërkohë universiteti duhet të decentralizojë buxhetin dhe ta drejtojë për intensifikimin e këtyre bashkëpunimeve.

Panairi i Punës, Konferencat dhe disa konkurse studentore, vizitat në biznes, praktikat mësimore, leksionet me të ftuar nga biznesi/institucionet përbëjnë një mundësi për ndërveprim, feedback dhe propozime konkrete. Pozitiv është fakti që një pjesë e pedagogëve të jashtëm vinin nga eksperiencë biznesi, drejtimi institucionesh dhe organizatash me peshë në qark, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në ndërveprimin universitet – biznes ose departament- biznes. Po kështu, takimi Post - Panair me pjesëmarrësit përfaqësues të bizneseve në Panairin e Punës së FE ka kontribut direkt në drejtimet për përshtatjen sa më të mirë të programit të studimit dhe të programit mësimor të lëndëve me kërkesat e tregut të punës.

Informacioni i strukturuar që arrihet të merret nga anketimi i të diplomuarve të punësuar dhe i bizneseve turistike me pyetsorin e miratuar për të marrë opinione mbi kërkesat e tregut të punës kontribon në përshtatjen e programit të studimit Bachelor në Turizëm me njohuritë dhe aftësitë që ky trg kërkon

(Evidenca 1.10.4: Marrëveshja midis FE dhe palëve të interesit, Evidenca 1.14: Raport i Panairit të Punës i FE ndër vite, Evidencë 3.5.1: Relacion mbi leksionet e seiminaret e hapura të zhvilluara nga FE, Evvidenca 3.5.2 Leksione dhe seminare të organizuara nga DT, Evidenca 2.10: Vendim i DT për miratimin e pyetësorëve të studimit të kërkesave të

	<p><i>tregut të punës drejtuar studentëve të turizmit të diplomuar dhe të punësuar dhe bizneseve turistike)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirëimit të programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në diskutimet e përmirësimit të programit bëhet përmes rrugëve formale dhe joformale. Drejtuesja e departamentit, pedagogët u shprehën gjatë takimeve në institucion që në mënyrë periodike takohet dhe diskuton me studentët, këshillin studentor të DT për elementët e programit të studimit, përmbajtjen e lëndëve, zhvillimin e procesit mësimor etj.</p> <p>Pedagogët u shprehën në fund të orës së mësimit të lëndës pyesin studentët se çfarë mendojnë se mund të bëhet më mirë në të ardhmen në programin e lëndës për të marrë studenti njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në fushën e lëndës.</p> <p>Gjithashtu, në nivel institucional dhe njësie kryesore, bazuar në Manualin e Sigurimit të Cilësisë bëhen pyetësorë për vlerësimin e programit dhe të mësimdhënies, rezultatet e të cilëve diskutohen në departament për të marrë vendime të mëtejshme. Studentëve ju merrej opinion nëpërmjet pyetësorëve në oren e fundit të mësimit lidhur me performacën e pedagogëve të lëndës.</p> <p><i>(Evidenca X: Manuali i Cilësisë në USH, Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm, Evidenca 6.2 Raport i NJSBC-se së FE për Vlerësimi i programeve Bachelor të FE dhe Rregullorja e NJSBC së FE, Evidenca 6.7: Zyra e sigurimit cilësisë dhe standarteve të USH për analizen e pyetesoreve të realizuar tek studentët e programin Bachelor në Turizëm 2021-2022, Evidenca 6.6: Raporti i vlerësimit të cilësisë së praktikës profesionale të programeve të turizmit, Evidenca 6.4 Relacion DT i mbledhjes 20.4.2022 lidhur me raport performance e stafit akademik dhe pedagogëve të jashtëm të DT për semestrin e parë 2021-202; 2Evidenca 5.6: Këshilli studentor i njësisë bazë DT)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale</p>	<p>Njësia përgjegjëse modifikon dhe riorganizon programet e studimit në kuadër të marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit që UNISHK-u ka me universitete, institucione dhe aktorë të sektorit publik dhe privat.</p> <p>Institucioni fiton përvoja pozitive nga universitetet e huaja nëpërmjet mobilitetit të pedagogëve dhe studentëve përmes projekteve Erasmus + dhe Ceepus.</p> <p>Meqenëse turizmi është një nga sektorët kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit dhe burimet njerëzore janë vendimtare për</p>




(veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<p>suksesin e këtij sektori, ky program përputhet me kërkesat dhe nevojat specifike lokale dhe zhvillimore, siç janë nevoja e tregut në rritje për profesionistë të kualifikuar dhe tendencat e tij për profesionistë në fushën e turizmit.</p> <p><i>(Evidence I: Statuti i USH, Evidenca 1.10.4: Marrëveshja midis FE dhe palëve të interesit, Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm, Evidenca 1.15 Mobilitete të stafit akademik dhe studentëve të FE, Evidenca 1.16: Mobilitete të stafit të DT)</i></p>			
Konkluzione	<p>Në takimet e ndryshme në Institucion dhe nga dokumentacioni i dorëzuar dhe i shqyrtuar gjatë vizitës, GVJ arriti në përfundimin se USH ka në vëmendje dhe ndërmerr aktivitete për të realizuar dhe nxitur përfshirjen e studentëve, partnerëve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit për ta realizuar me sukses dhe në përputhje me objektivat e vendosura. GVJ mendon se universiteti duhet të decentralizojë buxhetin dhe ta drejtojë për intensifikimin e këtyre bashkëpunimeve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet,	<p>Si pjesë e Departamentit të turizmit, programi përpiqet të harmonizojë metodat bashkëkohore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive.</p> <p>Kështu leksionet gërshetohen me diskutim aktiv, punë në projekte si individuale ashtu edhe në grupe por edhe zhvillimin</p>

<p>seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>dhe nxitjen e mendimit kritik për të nxjerrë në pah përmbushjen e objektivave mësimore nga ana e studentëve. Kjo vihet re edhe në theksin që i vihet me dokumentat përkatës të UNISHK, si Strategjia e mësimdhënies 2017-2021, Strategjia e mësimdhënies 2022-2026, si dhe Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Shkodrës 2022-2026.</p> <p>Format e mësimdhënies, mësimxënie dhe transmetimit të dijeve janë të miratuara në Rregulloren e studimeve në USH, të DT dhe të programit të studimit Bachelor në Turizëm.</p> <p><i>(Evidenca VIII: Strategjia e zhvillimit të USH 2022-2026, Evidenca IX: Strategjia e zhvillimit të USH 1017-2021, Evidenca IV: Strategjia e mësimdhënies në USH 2022-2026, 2017-2021, Evidenca II: Rregullorja e studimeve në USH, RVB, Evidenca 1.2: Strategjia e Fakultetit Ekonomik 2018-2022, Evidenca 1.3: Strategjia e zhvillimit të Departamentit të Turizmit 2022-2026, Evidenca 1.4: Strategjia e zhvillimit të programit Bachelor në "Turizëm" 2023-2026 , Evidenca 1.6: Regullorja e DT, Evidenca 1.7: Rregullorja e programit Bachelor në Turizëm)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimxënies.</p>	<p>Pjesa më e madhe e personelit akademik vjen nga një eksperiencë e gjatë punësimi apo shkollimi, duke i lejuar programit të vërë në zbatim eksperiencën e fituar në format bashkëkohore të mësimdhënies.</p> <p>Po kështu, angazhimi i stafit në aktivitete të ndryshme si mobilitete në universitete të huaja, konferenca, seminare, ëorkshope, trajnime e ëorkshope mbi metodat e mësimdhënies etj, ka shërbyer si një bazë mjaft e mirë për përmirësimin e mësimdhënies dhe literaturës së përdorur, duke synuar përshtatjen me trendet e brendëshme dhe globale sipas prioriteteve të përcaktuara në Strategjinë e FE-së dhe Strategjinë e DT.</p> <p><i>(Evidencë: RVB, Evidencë 1.2: Strategjia e FE 2018-2022, Evidenca 1.3: Strategjia e DT 2022-2026, Evidenca 3.2: Relacion mbi trajnime dhe ëorkshope mbi metoda dhe praktika mësimdhënëse bashkëkohore, Evidenca 1.15: Mobilitete të stafit të FE 2020-2023, Evidenca 1.16: Mobilitete të stafit të DT 2015-2020, Evidencë 3.17: Relacion mbi pjesmarrjen me projektin ERASMUS + ne Universitetin Widzemes i Shkencave tw Aplikuara, Latvia 2022, Takimi në institucion me stafin dhe studentët)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin e informacionit të ASCAL, rezulton se FE dhe departamenti përkatës i</p>




<p>akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënëit.</p>	<p>programit Bachelor në Turizëm mbështesin përhapjen e metodave të suksesshme mësimore ndërmjet stafit akademik, duke synuar rritjen e vazhdueshme profesionale të pedagogëve dhe ofrimin e stimuljeve për përmirësimin profesional. Për këtë qëllim organizohen: a) aktivitete shkencore si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, ku pedagogët nxiten që të paraqesin punimet e tyre shkencore; b) botimi i monografive apo artikujve shkencore; c) programet e bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike duke krijuar mundësinë e pajisjes me infrastrukturë e duhur në mjedis modern të godinës së FE (laboratore, kompjutera dhe pajisje të tjera të IT) dhe literaturë bashkëkohore (përfshirë dhe librarine online). Qendra e Ekselencës e institucionit dhe organizata të tjera kanë ofruar trajnime për metodat e reja të mësimdhënies.</p> <p><i>(Evidencë: RVB, Evidenca 1.9.3: Analiza vjetore e veprimtarisë akademike-shkencore të DT 2021-2022, Evidenca 3.2: Relacion mbi trajnime dhe ëorkshope mbi metoda dhe praktika mësimdhënëse bashkëkohore)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Eksperiencia ndërkombëtare e pedagogëve të departamentit ku bën pjesë programi i studimit Bachelor në Turizëm, natyrisht që ndihmon jo vetëm cilësinë profesionale të tyre, por edhe lejon programin që të përfitojë nga metodat bashkëkohore të mësimdhënies që ata sjellin Network-u që këta pedagogë sjellin nga këto eksperiencia ndërkombëtare favorizon edhe bashkëpunimin e mëtejshëm si në kuadër të programeve specifike si psh, Projekti Interreg Balkan Mediterranean HELIX I i cili synon nxitjen dhe mbështetjen e bizneseve start-up dhe atyre ekzistuese në sektorin e mikëpritjes.</p> <p>Një mënyrë tjetër e lidhjes së mësimdhënies me kërkimin shkencor është edhe organizimi në rang njësie kryesore, i Workshop-it të përvitshëm "Sfidat e Zhvillimit Rajonal", organizuar nga Fakulteti Ekonomik, si dhe pjesëmarrja në Buletinin Shkencor i USH-së, Seria e Shkencave Ekonomike. Si pjesë e programit mësimor të lëndëve të caktuara, zhvillimi i aktiviteteve të tilla të drejtuar nga pedagogët përlkatës si: Workshopi i studentëve të vitit tretë të turizmit 'Ruatja dhe përmirësimi i atraktivitetit turistik në rajonin verior të vendit', Panairi 'Do great things' i studentave të vitit të parë, aktiviteti 'EOË Albania' 2022, 2023 i studentave të turizmit me studentët e turizmit të dy universiteteve belge të drejtuar nga pedagogët respektiv për krijim koncept produktesh inovative turistike për Rajonin e Shkodrës', aktiviteti: 'Markim shtigjesh</p>




	<p>dhe digjitalizimi në hartë' i shërbejnë gjithashtu nxitjes tek studentët të mendimit krijues, atë kritik si dhe lidërshiptit, autonomisë e përgjegjshmërisë, frymen e grupit dhe ndërtimin e marrdhënieve të respektit të ndërsjellë.</p> <p><i>(Evidence-RVB, Evidenca 1.9.3: Analiza e veprimtarisë akademike-shkencore të DT 2021-2022, Evidenca 1.22.1 Raportim mbi Workshopin 'Sfidat e zhvillimit rajonal' 2021, Evidenca 1.22.2: Konferenca studentore 'Sfidat e zhvillimit rajonal' 2022, Evidenca 3.8: Raport mbi buletinin shkencor te FE Seria e shkencave ekonomike Evidenca 3.13.4: Relacion mbi aktivitetin e studentëve të turizmit me studentet belg për projektin WOW Albania 2023, Evidenca 3.13.2: Relacion mbi aktivitetin 'Do great things', Evidenca 3.13.3: Relacion mbi aktivitetin e studentëve 'Markim shtigjesh dhe digjitalizimi në hartë-Kalaja e Danjës', Evidenca 3.13.5: Informacion mbi aktivitetet e DT gjatë viteve 2022- 2023).</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Nga ana e Departamentit të Turizmit në mënyrë të vazhdueshme vlerësohen dhe përmirësohen format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike.</p> <p>Kjo konkretizohet edhe nga aktiviteti i përvitshëm që organizohet nga Fakulteti Ekonomik - Workshopi "Përmirsimi i Metodave të Kërkimit", i cili ka në fokus trajnimin e personelit akademik, me njohuri në fushën e kërkimit, përdorimit të metodave sasiore dhe cilësore, por jo vetëm edhe nga workshopet e trajnimit mbi metodat dhe praktikën mësimdhënëse bashkëkohore me qendër studentin që ka në fokus të mbështesë suksesin e pedagogëve në mësimdhënie, dhe të inkurajojë leksione dhe seminare interaktive, etj.</p> <p>Përveç aplikimit të metodave inovative në mësimdhënie, personeli akademik dhe ndihmës raportojnë edhe tek përgjegjësit e tyre për rezultatet e punës së tyre nëpërmjet raportimit individual vjetor për punën akademike dhe shkencore. Gjithashtu, për të vlersuar format dhe metodat e mësimdhënies të përdorur nga pedagogët shërbejnë edhe pyetësorët që plotësohen nga studentët për lëndën dhe pedagogun përkatës të saj.</p> <p><i>(Evidencë: RVB, Evidencë 1.9.1, 1.9.2, 1.9.3 Raporti për punën akademike-shkencore të DT në 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, Evidenca 3.2: Relacion mbi trajnime dhe workshope mbi metoda dhe praktika mesimdhënëse bashkëkohore, Evidenca 6.4: Raporti DT për anketimin e studentëve mbi performancën e stafit akademik të DT për</i></p>




	<p><i>semestrin e parë 2021-2022, Evidenca 3.4: Raport i anketimit të studentëve për vlerësimin e cilësisë së praktikës profesionale të programit të turizmit 2021-2022)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Universiteti i Shkodres ka dy struktura bazë për kontrollin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies: Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe Njësinë e Sigurimit të Cilësisë. Zyra e Sigurimit të Cilësisë është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e këtij niveli duke përdorur një sërë mekanizmash si: -harton politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat miratohen në Senatin Akademik; --vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore; -organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në fund të semestrit, para sezonit të provimeve; - realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë; --harton dhe i propozon Senatit standardet për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë; --prezanton raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së USH-së në Senatin Akademik, i cili miraton raportin vjetor përfundimtar të vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Fakulteti ka ngritur NJSBC i cili promovon përmirësimin e proceseve dhe bashkërenditjen e punës me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Vlerësimet periodike të studentëve për pedagogun, kryhen nëpërmjet plotësimit të një formulari të pyetësorit në formë anonime. Duke ofruar sugjerime, studentët ndihmojnë jo vetëm në vlerësimin e cilësisë së punës së pedagogut, por edhe përfshihen në përmirësimin e programit të studimit. Vlerësimet e lartpërmendura të pedagogëve i dërgohen drejtuesit të departamentit, i cili ia dërgon Dekanit dhe me pas Rektoratit.</p> <p>Nga takimet me pedagogët rezultojnë se anëtarët e NJSBC së FE inkurajojnë stafin akademik për të marrë pjesë në trajnimet e bëra në FE mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe diskutimet bashkëpunuese që synojnë suksesin e pedagogëve në mësimdhënie, dhe të inkurajimin e leksioneve dhe seminareve interaktive, etj.</p>
	<p><i>GVJ vlerëson që pavarësisht ekzistencës së kornizës institucionale të NJSBC-së dhe punës së bërë, më shumë përpjekje duhen bërë nga kjo njësi për të operacionalizuar</i></p>




	<p>objektivat që i ka vendosur vetes, të paraqitura në Statut, por edhe në rregulloren e NJSBC-së.</p> <p><i>(Evidencë I: Statuti i USH, Evidenca X: Manuali i cilësisë në USH, Evidenca 6.1: Miratimi i rregullores së NJSBC-FE, Evidenca 6.2: Raport përmbledhës i punës së NJSBC – FE, 2023, Evidencë 3.2: Trajnime dhe workshope mbi metoda dhe praktika mësimdhënëse bashkëkohore)</i></p>			
Konkluzione	<p>Duke u bazuar në Evidencat e dorëzuara dhe dokumentet e shqyrtuara gjatë vizitës, GVJ konstaton se Institucioni në të gjitha nivelet dhe programet garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. GVJ vlerëson që pavarësisht ekzistencës së kornizës institucionale të NJSBC-së dhe punës së bërë, më shumë përpjekje duhen bërë nga kjo njësi për të operacionalizuar objektivat që i ka vendosur vetes, të paraqitura në Statut, por edhe në rregulloren e NJSBC-së.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyrate e vlerësimit të njohurive janë përcaktuar qartë në rregulloren e studimeve të UNISHK, të miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 182, datë 28.05.2019, si dhe në rregulloren “Paketa e praktikës në programet Bachelor dhe Master, të miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.212 datë 21.06.2019. Këto rregullime, si dhe ndryshimet që i janë bërë atyre me vendim Senati Akademik janë reflektuar në rregulloren e FE, si dhe në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Turizëm,</p> <p>Mënyra e vlerësimit të studentëve pasqyrohet dhe në syllabuset e çdo lënde, ku në një seksion të veçantë paraqiten kriteret e vlerësimit për lëndën. Institucioni ka një formë të miratuar për karakteristikat kryesore të vlerësimit për programet bachelor/master por pedagogu i lëndës ka të drejtën e përshtatjes së tyre për një vlerësim sa më efikas të lëndës brenda limiteve të përcaktuara në Rregulloren e studimeve në</p>




	<p>USH. Në përgjithësi lëndët vlerësohen sipas shpërndarjes së mëposhtme:</p> <p>a) provim përfundimtar 70%;</p> <p>b) detyrë kursi ose prezantim 20%;</p> <p>c) pjesëmarrje aktive gjatë periudhës së zhvillimit të lëndës 10%.</p> <p>Kriteri i fundit i shërben pedagogut për të kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme progresin e studentit, si nëpërmjet diskutimeve ashtu edhe detyrave të kursit në klasë. Statuti, Rregulloret në rang universiteti janë publike në website të USH. Në takimin me stafin dhe studentët konstatuam se Rregullorja e USH, Udhëzimet në rang FE Rregullorja e FE dhe udhëzimet në rang FE, rregullorja e programit të studimit i bëhet i njohur studentëve që në ditën e parë, si dhe gjatë javës së parë të studimeve në vit të parë. Gjithashtu rregullorja e programit të studimit, Udhëzimet në rang FE i dërgohej studentëve në Teams.</p> <p><i>(Evidenca 1: Statuti, Evidenca 2: Rregullore e studimeve në USH, Evidenca LI: Paketa e praktikës në programet Bachelor dhe Master, Evidenca 1.5: Rregullore e FE, Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit, Evidenca 3.10: Reflektim në rregulloren e DT dhe programit të studimit të ndryshimit të rregullores së USH për temën e diplomës, Evidenca 2.2: Paketa e syllabuseve të programit Bachelor në Turizëm -shembuj syllabusi, Takimi i GVJ me personelin akademik dhe studentët)</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët e programit njihen me syllabusin dhe të gjithë elementët e tjerë të kursit, gjatë orës së parë të zhvillimit të lëndës apo modulit. Këtu përfshihen edhe informacionet lidhur me mënyrën e testimit si edhe kriteret e transparencës për një vlerësim sa me objektiv. Gjithashtu syllabusi i lëndës i dërgohej studentëve në grupin mësimor të hapur në platformen Microsoft Teams.</p> <p><i>(Evidenca: Takimi i GVJ me personelin akademik dhe studentët, Evidenca 2.2: Paketa e syllabuseve të programit Bachelor në Turizëm -shembuj syllabusi, RVB)</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke</p>	<p>Në përgatitjen e formave të testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentit harmonizohen karakteristikat e lëndës dhe zgjedhja që pedagogu konsideron si më të përshtatshmen për këtë qëllim. Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit dhe vlerësimi në provim.</p>

<p>i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët/modulet e cilësuar provim në planin mësimor përfaqëson 20-40% të vlerësimit përfundimtar. Përcaktimi i raporteve në mes të vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga çdo personel akademik titullar i lëndës/modulit dhe paraqitet për miratim pranë departamentit për sistemin Bachelor në fillim të vitit akademik.</p> <p>Testet e hartuara nga titullari i lëndës miratohen nga përgjegjësi i departamentit të turizmit pasi ka verifikuar përputhshmërinë e peshës së pikëve të testit me ato të përcaktuara në syllabusin e miratuar të lëndës për vlersimin e studentit me test përfundimtar, si dhe duke verifikuar strkturen e testit për përdorimin e formave të ndryshme të testimit të njohurive dhe duke vlerësuar mundësinë e zhvillimit të tij nga studenti me kohën e miratuar në rregulloren e studimit të USH për zhvillimin e testimit përfundimtar.</p> <p><i>(Evidenca II: Rregullore e përgjithshme e USH, Evidenca LI: Paketa e praktikës në programet Bachelor dhe Master, Evidenca 1.5: Rregullore e FE, Evidenca 1.6: Rregullore e Departamenti të Turizmit, Evidenca 1.7: Rregullore e programit Bachelor në Turizëm, Takim i GVJ me pedagogët)</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike duke përdorur edhe eksperiencat nga mobilitetet e ndryshme të zhvilluara dhe pjesëmarrja në projekte po kështu nëpërmjet pyetësorit të realizuar në fund të semestrit merret feedback në lidhje me mësimdhënien dhe metodat. Teknikat moderne të mësimdhënies përfshijnë përfshirjen dhe angazhimin e studentëve gjatë mësimëve, nxitjen e një marrëdhënieje ndërvepruese mësues-nxënës, vlerësimin dhe analizimin e përvojave të suksesshme të biznesit të turizmit dhe ftimin e ekspertëve të suksesshëm të industrisë për të folur për rrethanat aktuale që rrethojnë një lëndë të caktuar.</p> <p>Çdo student është i lirë të reflektojë mbi idetë dhe propozimet përkatëse, bazuar në njohuritë dhe përvojën e tij.</p> <p><i>(Evidenca II: Rregullore e studimeve në USH, Evidenca 1.6: Rregullore e Departamenti të Turizmit, Evidenca 1.7: Rregullore e programit Bachelor në Turizëm, Evidenca 6.4: Raport i DT mbi performancën e stafit akademik të DT për semestrin e parë 2021-2022, Evidenca 6.6: Raport i DT anketimit të studentëve për vlerësimin e cilësisë së praktikës)</i></p>




<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p><i>profesionale të programit të turizmit, Evidenca 1.9.3: Raporti i punës akademike dhe shkencore të DT për 2021-2022)</i></p> <p>Realizimi i lëndëve dhe programeve të studimit në Departamentin e Turizmit kryhet duke u bazuar në dy kompetenca kryesore: në atë teorike dhe praktike. Në aspektin teorik studentët përfitojnë nga leksionet si dhe materialet shtesë sic është prezantimet leksioneve në ppt, literatura e rekomanduar.</p> <p>Ndërsa në aspektin praktik realizohen në koordinimin e pedagogut të lëndës diskutime në grupe ku studentët paraqesin pikpamjet e tyre lidhur me temën që trajtohet dhe interpretimin e tyre mbi njohuritë e marra por edhe zhvillimin e ekskursioneve praktike pranë bizneseve, apo duke ftuar ekspert/ menaxher të sukseshëm të turizmit për të prezantuar eksperiencën suksesi, si dhe zhvillimin dhe prezantimin e detyrave të kursit në grup.</p> <p>Në aspektin praktik të konkretizimit të koncepteve të mësuara studentëve i kanë shërbyer edhe aktivitetet e poshtë cituara të udhëhequr nga pedagogët e lëndës, angazhimi në të cilat studentëve i konvertohet në pikë detyrë kursi, si: Workshopi me punimet e studentëve të vitit të tretë të turizmit 'Ruatja dhe përmirsimi i atraktivitetit turistik në rajonin verior të vendit, Panairi i përvitshëm 'Do great things' me studentët e vitit të parë të turizmit, aktiviteti 'WOW Albania' 2022, 2023 i studentave të turizmit me studentët e turizmit të dy universiteteve belge për krijim koncept produktesh inovative turistike për Rajonin e Shkodrës', aktiviteti për markim shtigjesh për në Kalanë e Danjës dhe digjitalizim në hartë, etj. Metodot interaktive të përdorura gjatë orëve të mësimin, sidomos gjatë orëve të seminareve, konkretizimin e njohurive teorike me aktivitete praktike gjatë lëndës nxisin autonominë dhe lirshmërinë nga ana e studentit për të qenë pjesëmarrës me shembuj, ese, detyra që punohen dhe prezantohen nga ata, individualisht apo në grup. Kjo sjell edhe ndërtimin e një marrëdhënie besimi dhe respekti ndërsjellë pedagog-student.</p> <p><i>(Evidenca I: Rregullore e studimeve në USH, Evidenca 1.6: Rregullore e Departamenti të Turizmit, Evidenca 1.7: Rregullore e programit Bachelor në Turizëm, Evidenca 3.13.4: Relacion mbi aktivitetin e studentëve të turizmit me studentet belg në projektin 'WOW Albania', Evidenca 3.13.2: Relacion mbi aktivitetin 'Do great things' IV, Evidenca 3.13.5: Informacion mbi aktivitetet e DT gjatë viteve 2022-2023, Evidenca 3.13.3: Relacion mbi aktivitetin</i></p>
---	--




	<i>'Markim shtigjesh për në Kalanë e Danjës dhe digjitalizim në hartë, Evidencë 1.9.2, 1.9.3: Raport i punës akademike dhe shkencore të DT në vitet 2020-2021, 2021-2022)</i>			
Konkluzione	Në vizitën në USH dhe në takimet me stafin akademik, jo akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se Institucioni ka hartuar dhe përdor rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, studentët njihen me procedurën e vlerësimit nëpërmjet syllabusit dhe nga pedagogu në fillim të çdo lënde. Gjithashtu, Institucioni mundëson aftësimin teorik dhe praktik të studentëve si dhe përdorimin e metodave të ndryshme mësimdhënëse dhe vlerësuese. GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>UNISHK ka një formë të miratuar me karakteristikat kryesore të vlerësimit për programet bachelor/master, por pedagogu i lëndës ka të drejtën e përshtatjes së tyre për një vlerësim sa më efikas të lëndës. Mënyra e vlerësimit të studentëve paraqitet në <i>nenin 22 të Rregullores së studimeve në USH</i>, gjithashtu pasqyrohet në syllabuset e çdo lënde. Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit dhe vlerësimi në provim. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për lëndët / modulet e cilësuar në programin e studimit nën vlerësim përfaqëson 20-40% të vlerësimit përfundimtar.</p> <p>Ndërsa provimi përfundimtar përbën 60-80% të vlerësimit total. Përcaktimi i raporteve në mes të vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga çdo pedagog dhe paraqitet për miratim pranë departamentit. Në shumicën e syllabuseve, pikët e provimit përfundimtar zënë një peshë të konsiderueshme në raport me vlerësimin gjatë vitit.</p> <p><i>(Evidenca II: Rregullore e studimeve në UNISHK, rEvidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm,</i></p>

	Evidenca 2.2: Paketa e Syllabuseve të programit Bachelor në Turizëm 2020-2023)
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>UNISHK ka adoptuar që nga viti akademik 2013 sistemin e menaxhimit të studentëve "ESSE3" dhe më pas sistemin Pitagora, i cili kryen funksionin e informimit të studentit në formë elektronike, krahas asaj të shkruar.</p> <p>Këto platforma për menaxhimin e studentëve garantojnë një menaxhim efikas të të dhënave të studentit gjatë gjithë qëndrimit të tij në universitet si dhe pas përfundimit të studimeve. Përmirësimi i informatizimit në drejtim të informimit dhe rritjes së transparencës është e reflektuar në nivel institucional edhe nëpërmjet Strategjisë së Zhvillimit të USH 2022-2026, e shprehur konkretisht në objektivin specifik 4 mbi 'Integritetin dhe Transparencën', si dhe objektivi 7 'Shërbimet Digjitale'. USH ka nënshkruar me Fondin e Zhvillimit Shqitaro-Amerikan një marrëveshje për vlerësimin elektronik të studentëve nëpërmjet sistemit "Clean Score".</p> <p><i>(Evidenca VIII.: Strategjia e Zhvillimit të USH 2022-2026, Evidenca XXII: Platforma ESS3, Evidenca XXIII: Platforma Pitagora, Evidenca XXI: Projekti Cleanscore-Marreveshje bashkepunimi AADF-UNISHK per zbatimin e projektit Clean score, Evidenca 3.1: Raport CleanScore për korigjim elektronik te provimeve)</i></p>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Vlerësimi përfundimtar bëhet duke zbatuar rregulloret dhe kërkesat e syllabuseve përkatës për çdo lëndë dhe duke marrë parasysh përqindjet në vlerësimin përfundimtar të secilit element të testimit të lëndës, siç u përmend më sipër. Për një transparencë sa më të plotë, përqindjet e vlerësimit për çdo element vendosen në një rubrikë të veçantë të syllabusit, si edhe u shpjegohet studentëve në fillim të çdo lënde. Komisionet e provimeve janë me jo më pak se dy pedagog dhe propozohen nga kordinatori i programit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>(Evidence II: Rregullore e pergjithshme e USH, Evidenca 1.6: Rregullore e departamenti të turizmit, Evidenca 1.7: Rregullore e programit Bachelor në Turizëm)</i></p>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe	<p>Vlerësimin të studentit i bashkëngjitet feedback i pedagogut i përcjellë përmes email apo komunikimit direkt të secilit student me pedagogun për të sqaruar arsyet e vlerësimit, ndërsa studentët inkurajohen që të shprehin ankesat e tyre për vlerësimin. Pedagogët e angazhuar për zhvillimin e këtij programi studimi i bëjnë të ditur studentëve numrin e kapitujve</p>




<p>lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>të përfshirë në kontrollin me testim gjatë semestrit dhe ato të përfshira në testimin në fund të semestrit dhe inkurajohen studentët për sugjerime.</p> <p><i>(Evidenca II: Rregullore e përgjithshme e USH, Evidenca 1.6: Rregullore e departamenti të turizmit, Evidenca 1.7: Rregullore e programit Bachelor në Turizëm, Takimi me studentët)</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Nga takimi me personelin akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor në ‘Turizëm’, u konstatua nga GVJ, se sistemi kundër plagjiaturës sigurohet nga network-u i vet pedagogëve. Në nivel institucional, vihet re që IAL po planifikon të pajiset me sistemin e antiplagjiaturës duke e konsideruar si pjesë me rëndësi në Strategjinë e Zhvillimit të USH 2022-2026, konkretisht me Objektivin II. ‘<i>Monitorimi i performancës dhe promovimi i integritetit akademik.</i></p> <p>Përveç kësaj, në UNISHK ekziston Kodi i Etikës, të cilit duhet ti përmbahet çdo student duke u përpjekur që të mos bëjë asnjë veprim që bie ndesh me etiken akademike siç janë plagjatura apo kopjet në provime. Në rregulloren e studimit në USH, si dhe në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në ‘Turizëm’ janë përcaktuar masat ndaj studentit në rast kopjimi.</p> <p><i>(Evidenca VIII: Strategjia e Zhvillimit të USH 2022-2026, Evidenca XII: Kodi i Etikës në USH, Evidenca II: Rregullorja e studimit në USH, Evidenca 1.7: Rregullorja e programit të studimit Bachelor në ‘Turizëm’)</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rregullorja e studimeve në USH përcakton afatet e dorëzimit të notave në sekretarinë mësimore, gjithashtu sekretaria mësimore informon pedagogët lidhur me këto data, para fillimit të sezonit të provimeve. Informacioni mbi sezonin e provimeve pasqyrohet në kalendarin e vitit akademik të miratuar nga Rektorati, gjithashtu edhe informacioni mbi skedulimin e detajuar të organizimit të çdo sezoni provimesh publikohet në faqen e IAL.</p> <p>Në Rregulloren e Studimeve në USH paraqitet se: Në përfundim të korrigjimit të provimeve bëhet çsekretimi. Rezultatet u bëhen të njohura studentëve 7 ditë pas zhvillimit të provimit me njoftim në posten elektronike të tij ose një datë të përcaktuar nga pedagogu i lëndës e cila i bëhet i njohur edhe drejtorit të departamentit.</p> <p>Pas këtij ballafaqimi pedagogu plotëson notat në sistem, gjeneron procesverbalin. Në rastin kur studentet nuk janë</p>

	<p>dakort me vlerësimin e bërë, në ditën e marrjes se rezultatit mund të bëjnë kërkesë me shkrim pranë Dekanit të fakultetit përkatës për rivlerësim, kërkesë e cila i dërgohet departamentit përkatës. Departamenti krijon një komision ad-hoc për rivlerësimin e studentit dhe vë në dijeni pedagogun e lëndës.</p> <p>Pas këtij afati procesi i vlerësimit të provimit quhet i përfunduar dhe generohet procesverballi, dhe askush nuk ka të drejtë të ndërhyjë më në sistem për ndryshim rezultatesh.</p> <p>(Evidenca II: Rregullore e studimeve në UNISHK, Evidenca 1.6: Rregullore Departamentit të Turizmit, Evidenca 1.8: Rregullore e programit të studimit Bachelor në 'Turizëm')</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në RVB dhe në takimin në Institucion na u sqarua se përmes sistemit Pitagora studentëve u behen të njohura rezultatet e provimeve. Në rastet kur studentët nuk janë dakord me rezultatet e komunikuara nga pedagogu, ai ka të drejtë të bëjë një kërkesë me shkrim ditën e marrjes së rezultatit që i drejtohet Dekanit të FE. Pas marrjes se ankimit nga ana e Dekanit, përgjegjësi i departamentit ngre komisionin ad-hoc për rivlerësimin e testit të studentit.</p> <p>Pas rivlerësimit dhe gjenerimit të procesverbalit askush nuk ka të drejtë të ndërhyjë në ndryshimin e rezultatit, siç parashikon neni 30, pika 4 e Rregullores së studimeve në USH. Në rastet kur nga ana e pedagogut bëhet gabim njerëzor në plotësimin e procesverbalit, me vendim të dekanit bëhet korrigjimi në sistem dhe gjenerohet procesverballi sërish.</p> <p>(Evidenca II: Rregullore e studimeve në UNISHK, Evidenca 1.6: Rregulloria e Departamenti të Turizmit, Evidenca 1.7: Rregullore e programit Bachelor në 'Turizëm')</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, nga shqyrtimi i Evidencave dhe takimet me studentët dhe stafin në Institucion, arriti në përfundimin se Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe rishikimin e tij në bazë të rregullores. GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Lëndët që e përbëjnë programin e studimit Bachelor në 'Turizëm' mundësojnë dhënien e njohurive dhe aftësimin e studentëve në një spektër të gjerë fushash dhe disiplinash të lidhura me botën e turizmit dhe funksionet që zhvillohen brenda tij dhe krijojnë mundësinë e thellimit në nivele të tjera të studimeve të cikleve pasardhëse.</p> <p>Siç u përmend me lart, pedagogët e Departamentit të Turizmit janë diplomuar dhe doktoruar në universitete cilësore, e veç kësaj janë gjithnjë të përditësuar me të rejat e shkencës në fushat e tyre respektive. Prandaj dhe programet e lëndëve, që ato përgatisin dhe japin, janë të një cilësie të lartë akademike dhe që përmbajnë literaturën më përfaqësuese dhe bashkëkohore në atë lëndë. Kjo si pasojë ndikon pozitivisht në formimin e studentëve me njohuritë dhe dijet më të qënësishme, solide dhe bashkëkohore, me literaturën, autorët apo studiuesit me top të asaj fushe.</p> <p><i>(Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit, Bachelor në Turizëm, Evidenca 2.1: Plani Mësimor i programit Bachelor në Turizëm, Evidenca 2.2: Paketa e Syllabuseve të programit Bachelor në Turizëm 2020-2023, Evidenca 3.3: CV e pedagogëve të angazhuar në programin e studimit 2020-2023)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit të një lënde nuk kufizohet vetëm në dhënien e njohurive në atë lëndë. Kjo sigurisht përben objektivin prioritar. Por pedagogët e Departamentit të Turizmit kujdesen që krahas kësaj studentët të fitojnë aftësi edhe në kerkimin shkencor, pra si të bëjnë një kërkim, si të shkruajnë një punim kërkimor apo si ta prezantojnë atë, të cilat duhet t'i kenë parasysh studentët në përgaditjen e prezantimit dhe detyrave të kursit, në përgaditjen dhe mbrotjen e temës së diplomës, në pjesmarrjen në ëorkshopen e studentëve.</p> <p>Kjo e fundit veçanërisht kërkon dhe njohuri të larta dhe bashkëkohore të teknologjisë së informacionit, e cila duhet thënë që është një nga pikat më të forta të kësaj gjenerate studentësh. Detyrat e kursit të çdo lënde bëhen në grup që i rrit studentëve aftësinë e bashkëpunimit dhe të komunikimit,</p>

	<p>aftësinë e punës në grup, të lidhësipit, të mendimit kritik të vlersimit të situatës.</p> <p>Aftësitë e komunikimit dhe ndërveprimit të studentëve i kultivohen studentëve edhe nga përfshirja në programin e studimit të modulit 'Komunikim biznesi' dhe lëndët e gjuhët e huaja të BE në vitin e parë, si dhe në vitin e tretë e lëndës gjuhë të huaja me opsione zgjedhjeje të gjuhëve të huaja të tjera, të përfshira në program nga vlersimi i opinionëve të bizneseve turistike mbi tregun turistik dhe destinacionet turistike ndërkombëtare me të cilët ata operojnë. Gjithashtu në programin e studimit Bachelor në 'Turizëm' 2021-2024, është përfshirë në grup lëndët me zgjedhje edhe lënda 'Menaxhim negociatash'.</p> <p><i>(Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm, Evidenca 2.1: Plani mësimor Bachelor në 'Turizëm' 2020-2023, Evidenca 2.7 Vendim DT mbi miratim te ndryshimeve në planin mësimor Bachelor në Turizëm 2021-2022 dhe miratim ne SA)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Nga takimi me personelin akademik dhe studentët e programit të studimit në turizem u evidentua komunikimi i syllabuseve në fillim të zhvillimit të lëndës dhe aftësitë që fiton studenti. Në fund të semestrit pedagogu titullar i lëndës/modulit i inkurajonte studentët që të jepnin opinione të tyre nëse lënda e zhvilluar ka arritur objektivat e saj dhe pritshmëritë e tyre nga ndjekja e kësaj lënde. Gjithashtu zhvilloheshin edhe anketime në javën e fundit të semestrit për lënden dhe performance e pedagogut. Nga vlerësimi i syllabuseve u evidentua vënia në pah e çështjeve më të rëndësishme për të orientuar studentët. Por nga ana formale vlerësojmë që duhet më shumë përpjekje për të strukturuar syllabuset.</p> <p><i>GVJ sugjeron që në seksionin e syllabusit që lidhet me përmbledhje dhe rezultate e të nxënës, të paraqiten ndër objektivat e lëndës jo vetëm njohuritë dhe aftësitë por edhe kompetencat që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës.</i></p> <p><i>(Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit, Evidenca 2.2: Paketa e Syllabuseve të programit Bachelor në Turizëm 2020-2023, Evidenca 6.4: Relacion DT mbi rezultatet e anketimit të studentëve për lënden dhe performancën e pedagogut të lëndës 2021-2022)</i></p>




<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Realizimi i programit të çdo lënde apo moduli në Departamentin e Turizmit bazohet në dy komponente kryesore: atë teorik dhe praktik.</p> <p><u>Komponenti teorik</u> peëfaqësohet nga leksionet e dhëna nga pedagogu, studimi i librave dhe literaturës së rekomanduar, si dhe informacioni që studentet marrin përmes, e-librari, internetit.</p> <p><u>Komponenti praktik</u> realizohet përmes orës së diskutimit (apo seminarit) ku studentët diskutojnë argumentojnë, analizojnë dhe debatojnë mbi çështje dhe pyetje të dhëna nga pedagogu lidhur me çështje kyçe të temës së ditës. Pedagogu inkurajon dhe drejton diskutimin në mënyrë që ai të jetë sa me interaktiv, analitik dhe shkencor. Pedagogu sigurohet që diskutimi të jetë gjithëpërfshirës, pra që të gjithë studentët të përfshihen aktivisht në të. Detyrat e kursit e lëndës inkurajohej të jetë të lidhur me realitetin e zhvillimit të vendit dhe të jepeshin ide të mundësisë së adaptimit të eksperiencave inovative të sukseshme në botë. Konkretizimi i temës së seminarit me vizitë në terren në biznese turistike të sukseshme, apo me eksperiencë praktikash inovative të sukseshme të ekspertëve, menaxherve sukseshëm të turizmit, të ftuar në auditor, krijon një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative për turizëm të qëndrueshëm dhe inkurajon studentët për të qenë të sukseshëm në punën e tyre menaxheriale në të ardhmen. Aspekti praktik realizohet edhe përmes praktikave që studentët kryejnë në institucione shtetërore, private, apo ato të shoqërisë civile, si pjesë e kurrikulës akademike. Marrëveshjet bashkëpunuese të sukseshme të USH me institucionet e huaja të arsimit lartë në projekte Erasmus+, Ceepus krijon mundësi në rritje për mobilitete të studentëve në këto institucione.</p> <p><i>(Evidencë: 1.6: Rregullore DT, Evidenca 1.9.2, 1.9.3: Raportet e analizës së punës akademike dhe shkencore të DT për vitet 2020-2021, 2021-2022, Evidenca 3.4: Realicion i zhvillimit të praktikës së studentëve Bachelor në Turizëm 2021-2022 , Evidenca: RVB, Takim me pedagogët dhe studentët)</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>Pedagogët e Departamentit të Turizmit njoftojnë dhe inkurajojnë studentët që të marrin pjesë në eventet akademike dhe shkencore ku ata janë folës, sidomos kur tematika e tyre është relevante me lëndën përkatëse. Studentët kanë marrë pjesë në ato evente që organizohen nga FE dhe Departamenti i Turizmit si leksionet, seminarët akademike të hapura, ëorkshope dhe konferencat kombëtare e ndërkombëtare të</p>




<p>brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>zhvilluara nga FE, dhe jo vetëm si pjesmarrës në audiencë, por edhe aktivisht me pyetje e diskutime në seancat përkatëse. Pjesmarrja lartë e studentëve në këto aktivitete tregon interesin akademik dhe shkencor të këtyre aktiviteteve. Pedagogët përdorin mekanizma stimulues për ti nxitur studentët të bëhen pjesë e aktiviteteve të tilla, si psh pikë në vlerësimin e vazhduar, ndërsa angazhimi i tyre me referime në ëorkshope i ekuivalentohet me pikë të detyrës së kursit të vlerësimin të vazhduar në lëndën që i përket fushës së referimit, etj.</p> <p><i>(Evidencë 1.6: Rregullore DT, Evidencë 1.9.2, 1.9.3: Raportet e analizës së punës akademike dhe shkencore të DT për vitet 2020-2021, 2021-2022, Evidenca 3.5.1: Raport mbi leksionet e hapura të zhvilluara në FE 2017-2020. Evidenca 3.5.2: Relacione mbi leksionet dhe seminarët e hapura të zhvilluara nga DT 2021-2023, 3.13.1: Informacion mbi Ëëbinarin Menaxhim Financiar në bizneset turistike dhe inovacionet për zgjidhje të qëndrueshme, Evidenca 3.22.1: Raportim mbi ëorkshopin studentor ‘Sfidat e zhvillimit rajonal’, mbi 8 edicionet e saj, Evidenca 3.22.2: Relacion mbi konferencën studentore ‘Sfidat e zhvillimit rajonal’ 2022, Evidenca 3.18: Tabela e Botimeve shkencore dhe referimet në konferenca shkencore 2016- 2021, Evidenca 3.13.6: Raportim mbi aktivitetet e zhvilluara pranë FE 2020-2023)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe shqyrtimi i dokumenteve e Evidencave të tjera gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se programi i studimit garanton thellimin e njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve, mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash dhe i kushtohet vëmendje të mësuarit gjatë gjithë jetës nëpërmjet realizimit të orëve të hapura, trajnimeve etj. Në përfundim të shqyrtimit dhe vizitës, GVJ sugjeron që në seksionin e syllabusit që lidhet me përmbledhje dhe rezultate e të nxëniet, të paraqiten ndër objektivat e lëndës jo vetëm njohuritë dhe aftësitë por edhe kompetencat që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Rregullorja e studimeve në USH dhe në mënyrë më të detajuar Rregullorja e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Turizem, përcakton procedurat që duhet të ndjekin studentët lidhur me detyrimet përmbyllëse dhe projektin e diplomimit. Në rregulloret e sipërmendura trajtohet: Mbrojtja e diplomës me provim përfundimtar si dhe Mbrojtja e diplomës me punim diplome.</p> <p>Diplomimi me punim diplome bëhet nga studentët që kanë notën mesatare jo më pak se 8 (tetë) për sistemin Bachelor. Njësia bazë, DT përcakton fushat e punimit të diplomës në fillim të semestrit të parë të vitit të fundit të studimeve. Studenti propozon temën dhe udhëheqësin shkencor, ndërsa departamenti e shqyrton dhe merr vendim për këtë. Dekanati i FE ka miratuar paketën e udhëzimeve për përgaditjen e temës së diplomës për ciklin e parë.</p> <p><i>(Evidencë II: Rregullore e studimeve në USH (e ndryshuar), 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm), Evidenca 3.10: Reflektim në rregulloren e DT dhe të programit të studimit të ndryshimit në rregulloren e studimeve në USH për praguin e notës për temë diplome, Evidenca 3.9: Paketa e udhëzimeve të FE për formatin dhe përgaditjen e temës së diplomës për ciklin I-rë dhe të II-të)</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Personeli akademik por edhe sekretaria mësimore i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Ky informacion përfshin si detyrimet akademike ashtu edhe ato financiare që studentët kanë për përmbylljen e programit. Njoftimet për këto detyrime vendoseshin për studentët edhe në bordin e njoftimeve për studentët Bachelor në Turizëm Dekanati i FE ka miratuar paketën e udhëzimeve për përgaditjen e temës së diplomës për ciklin e parë, të cilat i vendosen studentëve në Teams.</p> <p><i>(Evidenca II: Rregullore e studimeve në USH, Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm, Evidenca 3.9: Paketa e udhëzimeve të FE për formatin dhe përgaditjen e temës së diplomës për ciklin I-rë dhe të II-të)</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë</p>	<p>Rregullorja e studimit në USH, dhe në mënyrë më të detajuar në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Turizëm, janë të përcaktuara procedurat që duhet të ndjekin studentët lidhur me detyrimet përmbyllëse dhe projektin e diplomimit. Kur mbrojtja e diplomës bëhet me provim</p>




<p>gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>përfundimtar rregullorja e programit të studimit Bachelor në Turizëm përcakton si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësia bazë përcakton dhe miraton programin e mbrojtjes së diplomës me provim përfundimtar dhe ua bën të njohur studentëve; • Komisioni i mbrojtjes me provim përfundimtar përbëhet nga pedagogët titullarë të fushave përkatëse të përfshira në program. Komisioni propozohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe miratohet ng drejtuesi i njësisë kryesore; • Komisioni përgatit tezat e provimit (jo më pak se 5) të cilat duhet të përfshijnë të gjitha fushat që janë të përfshira në program; • Proçedurat e realizimit të provimit përfundimtar janë të njëjta me ato të provimeve me shkrim të kursit; <p>Programi me temat e lëndëve të përfshira për mbrojtjen e diplomës me provim vendoset në Bordin e studentëve Bachelor në Turizëm dhe në platformen Teams të studentëve të vitit të tretë.</p> <p><i>(Evidencë II: Rregullore e studimeve në USH, Evidenca 1.7: Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Turizëm, Evidenca 3.7: Vendim DT për lëndet dhe temat për t'u përfshirë në provimin e formimit per sistemin Bachelor në Turizëm)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ, ne takimin me personelin akademik të programit të studimit si dhe me studentët u evidentua se studenti nisur nga fusha e punimin e kërkimor që dëshiron të zhvillojë temen e diplomës propozon udhëheqësin shkencor që mendon se ka kompetencat akademike në fushen kërkimore të temës së diplomës së tij. Studenti së bashku me udhëheqësin shkencor të propozuar prej tij kristalizonë temen për punimin e diplomës për t'u propozuar në department. Më pas departamenti miraton propozimin për temen e diplomës që studenti kërkon të punojë dhe për udhëheqësin shkencor duke patur parasysh përputhshmërinë e fushës së kompetencave akademike të pedagogut me temën që kërkon të punojë studenti. Studenti punon për temën e diplomës duke u konsultuar dhe orientuar nga udhëheqësi shkencor në çdo hap kërkimor.</p> <p>Udhëheqësi shkencor asiston studentin në literaturën mbështetëse të kërkimit, në formulimin e qartë të problemit kërkimor, në përzgjedhjen e metodave dhe instrumentave kërkimor, në mënyrën e përpunimit të dhënave dhe hartimin e konkluzioneve, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Studenti paraqet drafte të punës dhe merr</p>




	<p>vazhdimisht feedback nga udhëheqësi.</p> <p>Ky i fundit vendos kur punimi është i gatshëm brenda afatit të miratuar në Rregulloren e USH për t'u dorëzuar për komisionin e vlerësimit duke garantuar cilësinë shkencore të temës së diplomës. Punimet më të mira të temave të diplomave rekomandohen për të marrë pjesë në konferencën studentore të FE 'Sfidat e zhvillimit rajonal' dhe publikohen në buletin e serisë së shkencave ekonomike të USH.</p> <p><i>(Evidencë II: Rregullore e studimit në USH, Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm, Evidenca 3.9: Paketa e udhëzimeve për formatin dhe përgatitjen e temës së diplomës për ciklin I-rë, Evidenca 3.11: Mbi miratimin e DT të udhëheqjeve të temave të diplomave dhe shpërndarjen recencave të punimeve të temave të diplomave nga përgjegjësia e DT 2021-2022)</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Udhëheqësit i asistojnë studentët në të gjitha hapat e përgatitjes dhe punimit të diplomës. Përveç vendosjes në dispozicion të studentit të të gjithë bazës së nevojshme materiale brenda IAL, udhëheqësi ofron, kur është e nevojshme ndihmë shtesë nëpërmjet përdorimit të softëarit të Qulatricks survey apo softëerit statistikor SPSS edhe në laboratorët e FE-UNISHK.</p> <p><i>(Takimi i GVJ me personelin akademik dhe studentët dhe vizitë në laboratorët e FE-UNISHK)</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Tema e diplomës dhe provimi përfundimtar i diplomës vlerësohen nga komisioni i ngritur për këtë qëllim Komisioni i mbrotjes së temës së diplomës, i përbërë me jo më pak se tre pedagog të fushave të përafërta, i propozuar nga departamenti, miratohet nga Dekani i FE. Ky komision jep feedback me shkrim në plotësimin me pikë të formularit me kritere të miratuara për vlerësimin e cilësisë shkencore të punimit dhe cilësisë së prezantimit të temës së diplomës. Si minimum i notës kaluese konsiderohet pragu i 45 pikëve.</p> <p><i>(Evidencë II: Rregullorja e studimeve në USH, EvidencaXXXIX: Paketa e provës finale në USH)Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm,</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Universiteti i Shkodres në rregulloren e institucionit ofron udhëzime të qarta për pajisjen e studentit me diplomë. Në përfundimin e suksesshëm të programit të gjithë studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës. Forma dhe përmbajtja e këtyre dokumentave janë të miratuara nga Senati Akademik. Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)</p>

<p>Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>ka miratuar rregjistrimin e formatit të Diplomës Bachelor në Turizëm me Urdhërin e saj nr.232, datë 28.05.2021. Ndërsa dorëzimi i diplomës bëhet në një ceremoni të veçantë. Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat 10, jepet medalje e artë dhe çertifikata përkatëse.</p> <p>Medalja e artë dhe emri i tij/saj regjistrohen në librin e universitetit. Për studentët që kane përfunduar studimet me notën mesatare të ponderuar mbi 9.00, jepet çertifikata "Student ekselent". Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> <p>(Evidencë II: Rregullore e studimeve në UNISHK, Evidencë 2.5: Miratim nga SA i formatit të diplomës dhe suplementit dhe urdhëri i QSHA për rregjistrimin e formatit të diplomës Bachelor në Turizëm)</p>
--	---

<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Sekretaria mësimore ka si detyrë mbajtjen e regjistrit themëltar me të dhënat e studentëve, si në formën fizike ashtu edhe në atë elektronike. Sekretaria ngarkohet edhe me mbajtjen e kartelës së studentit ku pasqyrohen kreditet e akumuluar. Dosjet personale të studentëve pas diplomimit ruhen në arkivin e universitetit duke respektuar normat në fuqi për privatësinë por edhe rregullillimet e USH për arkivin.</p> <p>(Evidenca II: Rregullore e studimeve në UNISHK, Vizita në Institucion).</p>
--	--

<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Personeli akademik por edhe sekretaria mësimore i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në Institucion GVJ arriti në përfundimin se nga Institucioni ndiqet një procedurë e qartë e detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe pajisjes me dokumentacionin përkatës.</i></p>
---------------------------	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X





BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Në programin Bachelor “Turizëm”, stafi akademik dhe ai ndihmës akademik i angazhuar për realizimin e tij, i përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Përsa i përket kualifikimeve shkencore të stafit akademik, në këtë program janë të angazhuar nga Departamenti i Turizmit: 1 staf akademik me titullin Profesor Doktor, 2 staf akademik me titullin Profesor i asocuar Doktor, 4 staf akademik me gradën shkencore Doktor dhe dy staf akademik me titullin Master shkencor (studenta doktorant në proçes). Stafi akademik i Departamentit të Turizmit ofruet dhe drejtues i këtij programi studimi është rekrutuar gjithashtu në bazë të kriterëve të qarta dhe kualifikimeve specifike që lidhen me fushën në të cilën janë përfshirë në mësimdhënie. Stafi akademik për këtë program është 19 PAE / 8 PAK</p> <p>Në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në Turizëm janë edhe stafi akademik i angazhuar nga dy njësitë e tjera bazë të FE dhe nga njësi bazë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Gjuhëve të huaja të UNISHK, të cilët përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik që kërkohet për t’u angazhuar në ciklin e parë të studimeve Bachelor. Ata kanë ekspertizën e duhur teorike dhe praktike për programin ku janë përfshirë. Stafi akademik merr pjesë vazhdimisht në kurse dhe aktivitete të tjera shkencore për të rritur nivelin e tyre të kualifikimit si dhe për të përmbushur kërkesat për marrjen e titujve shkencor e akademik në fushën ku ata japin leksione e seminare.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në programin Bachelor në “Turizëm”, është aktiv dhe merr pjesë në projekte kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare, konferenca shkencore si dhe botojnë rregullisht në publikime të Konferencave dhe Revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, disa me faktor impakti ose të rankuara në ëbsite të njohura.</p> <p>Stafi akademik, për botime të veçanta, ka përfituar mbështetje financiare nga Universiteti pas një proçedure të përcaktuar</p>



	<p>qartë. Përveç stafit akademik, edhe ai jo akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor “Turizëm” është punësuar në përputhje me kriteret dhe kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për të mbështetur ecurinë e mirë të programit.</p> <p><i>(Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca XI: Rregullore e punësimit në USH; RVB; Evidencë 4.1: Kontratat e punësimit të PAE të DT; Evidenca 3.3: CV stafi akademik programit Bachelor “Turizëm” 2020-2023, Tabela përmbledhëse 2.1, 2.2, 2.3: Të dhëna për stafin akademik PAE dhe PAK të DT të angazhuar në programin Bachelor në Turizëm 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023, Tabela përmbledhëse 12.1: Plani mësimor Bachelor në Turizëm 2020-2023 i lidhur me personalin akademik).</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Shpërndarja e ngarkesës mësimore kryhet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe i gjithë Personeli Akademik Efektiv (PAE) që jep mësim në programin Bachelor “Turizëm” ka ngarkesën vjetore të miratuar nga Përgjegjësi i departamentit nw fillim të vitit akademik. Referuar të dhënave të dërguara (Tabelat-aneke) GVJ konstaton se në shpërndarjen e ngarkesës janë pasur parasysh dhe janë respektuar si ngarkesat në auditor ashtu edhe ato jashtë auditorit, në bazë të gradës shkencore, titullit akademik apo pozicionit të secilit anëtar të PAE.</p> <p>Nw total personeli akademik efektiv mbulon mbi 76 % të ngarkesës mësimore të programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca 4.2: Përcjellje e ngarkesave mësimore të pedagogëve departamenti Turizëm, për vitin akademik 2022-2023).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga kontratat e punësimit si dhe nga diskutimi me Personelin Akademik Efektiv të angazhuar në programin e studimit Bachelor “Turizëm”, vihet re qëndrueshmëria e tyre në punë për periudhën e akreditimit si dhe më herët. Gjithashtu, stafi akademik i punësuar me kohë të plotë dhe të pjesshme janë të gjithë të pajisur me kontratat e punësimit dhe Institucion mbulon detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.</p> <p><i>(Evidencë 4.1: Kontratat e punësimit të PAE të Departamentit të Turizmit, Tabela përmbledhëse 2.1, 2.2, 2.3: Të dhëna për stafin akademik PAE dhe PAK të DT të angazhuar në programin Bachelor në Turizëm gjatë viteve 2020-2021, 2021-2022, 2022-2023)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi</p>	<p>Në Departamentin e Turizmit rekrutimi dhe vlerësimi i personelit zhvillohet duke ndjekur procedurat ligjore dhe</p>




dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.

transparente në përputhje me Statutin e Universitetit të Shkodrës dhe Rregulloret në fuqi, të Fakultetit dhe vetë Universitetit.


Proçesi i rekrutimit të stafit akademik ose jo akademik kryhet duke kaluar në dy nivele kontrolli të ligjshmërisë, së pari në Fakultet dhe më pas në Rektorat. Proçedura zhvillohet sipas këtij rendi: Fakulteti, i cili është në varësi administrative dhe financiare nga Universiteti i Shkodrës, përmbledh nga departamentet e tij nevojat sipas planifikimeve dhe më pas i dërgon në Rektorat. Në Rektorat, zyra e Personelit (Burimeve Njerëzore) harton dhe shpall lajmërimin të përbashkët për të gjitha kuotat e lira për staf të të gjithë fakulteteve të Universitetit.

Lajmërimet dërgohen dhe pasqyrohen në ëbsite të USH, si dhe në gazetën zyrtare 'Buletini i njoftimeve publike' e DAPP duke iu përmbajtur rregullave në fuqi. Në thirrjen e publikuar përcaktohet edhe proçedura e metodologjia e vlerësimit të aplikimeve nga komisioni ad-hoc.

Gjatë afatit të vendosur në aplikim, të interesuarit aplikojnë duke dorëzuar dosjet me dokumentet të fotokopjuara dhe noterizuara nga origjinali. Për të shqyrtuar dosjet ngriheshin komisionet përkatëse nga secili departament, me propozim nga Drejtuesi i Departamentit dhe miratim nga Dekani i Fakultetit përkatës.

Komisioni, i cili kryesohet nga Drejtuesi i Departamentit, ka në përbërje anëtar me kualifikimet më të larta dhe me përvojë të gjatë në mësimdhënie. Përveç pedagogëve përfaqësues të departamentit, në komision përfshihet edhe përfaqësuesi i Dekanit dhe përfaqësuesi i Rektorit. Komisioni shqyrton kriteret e caktuara në Rregulloren e Punësimit të Universitetit të Shkodrës, si dhe kriteret e veçanta në varësi të departamentit, përpilon tabelën e pikëzimit të aplikantëve dhe harton listën e renditjes së tyre për gjatë tre fazave të rekrutimit. Komisioni përpilon shkresën me renditjen përfundimtare të kandidatëve që janë përzgjedhur si të vlefshme për të vazhduar konkurimin dhe ia dërgonte fillimisht Dekanit dhe më pas në Rektorat për miratimin përfundimtar.

Dekani dhe Rektori kanë të drejtë të mos miratojnë dhe të kthejnë propozimet për tu rishikuar, nëse kanë probleme. Pas miratimit përfundimtar dhe firmosjes nga Rektori të kandidatës së përzgjedhur, miratohet përfundimisht si Personel Akademik Efektiv. Rezultatet e çdo faze bëhen publike në ambjentët e fakultetit dhe njoftohen kandidatët



	<p>aplikues. Ndërsa për Personelin Akademik të Jashtëm, në komisionin ad-hoc të vlersimit nuk ka në përbërjen e tij përfaqësues të Dekanit dhe Rektoratit.</p> <p>Përzgjedhja e kandidatëve për staf akademik të jashtëm (PAK) bëhet vetëm në bazë të vlersimit të dosjeve të dorëzuara për plotësim të kriterëve të pranimit dhe pikëzimit me tabelë të nivelit të performancës akademike dhe shkencore të kandidatit , të vertetuara me dokumenta. Komisioni harton vendimin me fituesit dhe ja përcjell për miratim paraprak Dekanit, i cili e përcjell për miratim përfundimtar Rektorit të USH.</p> <p>Lista e kandidatëve fitues si PAE & PAK shpallet me ID përkatëse në faqen zyrtare të USH. Kandidatët jo fitues u jepet e drejta për ankimim brenda 2 javëve nga shpallja e rezultatit dhe ndiqet procedura e shqyrtimit të saj dhe marrjes së vendimit përkatës sipas rregullores së punësimit në USH.</p> <p><i>(Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca XI: Rregullorja e punësimit në USH; Evidenca 4.3: Procedurë e punësimit të pedagogëve të brendshëm në DT të FE-së; Evidencë 4.4. Procedurë e rekrutimit të pedagogëve me kohë të pjesshme pranë DT për 2020-2021; Evidenca 4.5: Procedurë miratimi të Strukturës organizative të DT).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në laboratorët e Universitetit të përdorura nga studentët e programit Bachelor në Turizëm dhe nga dokumentacioni i dorëzuar vihet re se Personeli ndihmës akademik realizon detyrën për mirëfunksionimin e laboratorëve me kompjuter si dhe për të ndihmuar studentët që përdorin laboratorin për realizimin e detyrimeve të tyre.</p> <p>Nga dosjet dhe CV e personelit ndihmës akademik është përzgjedhur në bazë të kriterëve të përcaktuara për atë pozicion pune dhe kanë kualifikimet e duhura për të plotësuar detyrën e tyre për mirëmbajtjen e laboratorit, zgjidhjen e problemeve të thjeshta teknike me kompjuterët si dhe për të ndihmuar studentët. Mirëmbajtja e pajisjeve laboratorike ishte në nivel shumë të mirë.</p> <p><i>(Evidenca: RVB; Vizitat në institucion).</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me</p>	<p>Të dhënat e Personelit Akademik të angazhuar në Departamentin e Turizmit për t'u përfshirë në realizimin e programit të studimit mblidhen dhe arkivohen nga Përgjegjësi i Departamentit. Në vizitën e GVJ në Zyrën e Burimeve njerëzore si dhe nga vëzhgimi me zgjedhje rastësore të dosjes së një pedagogu të brendshëm dhe një të jashtëm, rezultoi se dosjet e tyre dokumentacion të plotë (CV, kontratë punësimi,</p>





<p>legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>diploma, certifikata kualifikimesh, certifikata trajnimesh, listë botimesh, listë të konferencave, etj). Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik rezulton se personeli ka formim akademik të fushave që mbulon.</p> <p><i>(Vizita në institucion-takimi me drejtues së Zyrës së Burimeve Njerëzore, dosje të pedagogëve).</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>USH dhe Departamenti i Turizmit kanë të angazhuar personel të kualifikuar dhe me njohuri multidisiplinore në përputhje me fushën e studimit, që është përgjegjës për zhvillimin e praktikës profesionale. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me disa Bashki dhe biznese në fushën e turizmit, për të siguruar zhvillim të suksesshëm të praktikave profesionale të studentëve.</p> <p>Gjithashtu marrëveshjet që ka USH me institucionet dhe entet publike, si dhe me bizneset turistike kontribuojnë edhe në mbështetjen me informacion, realizim anketimesh të nevojshme për punimin e diplomës, po kështu krijojnë mundësi bashkëpunimi për organizim aktivitetesh në shërbim të realizimit të programit të studimit Bachelor në Turizëm.</p> <p><i>(RVB, Evidenca LI: Paketa e praktikës Bachelor dhe Master; Evidenca XXXVI: Marrëveshjet e bashkëpunimit në rang universiteti, Evidenca 1.10.1: Marrëveshje bashkëpunimi të USH me subjektet pritëse të praktikës për zhvillimin e praktikës profesionale; Evidenca 1.10.3: Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet dhe entet publike, Evidenca 1.10.2: Marrëveshje bashkëpunimi USH me 21 biznese turistike, Evidenca 3.13.5: Informacion mbi aktivitetet DT ne Website te USH).</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në</p>	<p>Në Evidencën për Paketën e praktikave profesionale për programet Bachelor dhe Master përcaktohet mënyra e kryerjes së praktikës, rastet kur praktika kryhet jashtë Bashkisë Shkodër, koha kur kryhet praktika dhe kohëzgjatja, detyrat e pedagogut dhe studentit etj. Sipas saj, pedagogu ka për detyrë të vizitojë rregullisht dhe të ndihmojë studentin gjatë praktikës,</p>

<p>përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>të vlerësojë ecurinë e tij dhe gjithë praktikën në formularin dhe raportin e gatshëm.</p> <p>Në Paketë si dhe në marrëveshjet e nënshkruara për zhvillimin e praktikës përcaktohen qartë edhe detyrimet e Institucionit ose biznesit pritës të studentëve, për të siguruar përfitim sa më të mirë të aftësive profesionale. Përveç marrëveshjes institucionale, lidhet edhe marrëveshje midis studentit, titullarit të lëndës së praktikës dhe mbikëqyrësit të subjektit të praktikës për të krijuar mundësi dhe për të mbikëqyrë zhvillimin gjatë tërë kohës të praktikës së studentit në ambjentin pritës.</p> <p>Mbikëqyrësi i subjektit peitës gjithashtu dorëzojnë në zarf të mbyllur një formular vlerësimi të 40 treguesve të vlersimit të praktikës profesionale të studentit, të cilat zënë maksimumi 40%.të vlersimit përfundimtar të studentit për praktiken profesionale.</p> <p>Studenti gjithashtu ka të përcaktura qartë detyrimet e tij për praktikën profesionale dhe në fund të saj duhet të dorëzojë një detyrë kursit për të shfaqur përfitimet nga praktika profesionale, të cilen e mbrojnë në ditën e caktuar në sezonin e provimeve para komisionit të provimit me pedagog të angazhuar në realizimin e praktikës. Përveç praktikës profesionale USH financon edhe ekspeditat në terren të studentëve sipas itinerareve dhe planit të dorëzuar parapakisht.</p> <p><i>(Evidenca LI: Paketa e praktikës Bachelor dhe Master; Evidenca 3.4. Realizimi i praktikës profesionale dhe ekspeditës në terren 2021-2022).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ arrin në përfundimin se ajo mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies për programin Bachelor "Turizëm". GVJ shpreh vlerësimin: Përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga vizita në Fakultetin Ekonomik të USH dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi se USH zotëron hapësirat e mjaftueshme në përputhje me standardet shtetërore për zhvillimin e procesit mësimor në mënyrë të rregullt.</p> <p>Godina është e re, e ndërtuar në vitin 2019 dhe sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me mjetet e nevojshme për të zhvilluar mësimin si: kompjuter, videoprojektor, tabela të bardha dhe me kapacitete të mjaftueshme për zhvillimin e leksioneve në auditore të mëdhi dhe të seminareve për grupet mësimore, etj. Gjithashtu në mjediset e FE ka sallë amfiteatër konferencash, sallën e video konferencave që mbështesin realizimin e leksioneve dhe seminareve të hapura, trajnimet, ëorkshopet konferencat, etj.</p> <p>Godina është me sistem qendror ngrohje-ftohje, që lehtëson zhvillimin e mësimin në çdo stinë. Gjithashtu, sallat janë të ndriçuara mirë, kanë sistem ëireless për tu përdorur si nga pedagogët, ashtu edhe nga studentët etj. Pedagogët kanë zyrat e tyre të pajisura me kompjutera si dhe studentët kanë hapësira të dedikuara për ata për përdorim kompjuterash, sallë leximi dhe të fondit të librave në FE etj.</p> <p>Gjithashtu USH ka një bibliotekë të madhe moderne të mirëorganizuar, ngjitur me mjediset e FE ku ofrohet jo vetëm fondi I librave në mbështetje të programeve të studimit të USH, por edhe mundësi kërkimi të informacionit on-line në sallën e leximit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike pranë kompjuterave të sallës, si edhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit. Biblioteka vë në dispozicion të studentëve mediatekën me 30 vende multimedia, si dhe tri salla leximi me 300 vende leximi në total.</p> <p><i>(Vizita e GVJ ne USH, RVB, Evidenca 4.6. Mjediset e FE-së, Tabela përmbledhëse 16: Mjediset e Fakultetit/Njësisë bazë).</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik</p>	<p>Në Fakultetin Ekonomik të USH, mjediset mësimore ku zhvillonin procesin mësimor studentët e programit Bachelor “Turizëm” garantojnë realizimin e procesit mësimor. Mësimi zhvillohet në godinën e Fakultetit Ekonomik e cila disponon 3 salla leksioni me kapacitet 96 studentë secila, 9 salla seminaresh me kapacitet 40 studentë secila dhe 2 laboratorë të pajisur me kompjuter me kapacitet 30 studentë seJcili.</p> <p>Gjatë vizitës GVJ u njoh konkretisht me paisjen e sallave dhe laboratorëve me sistemin e projektimit digjital, përfshirë edhe të gjitha mjetet e tjera audio dhe video. Laboratorët janë të paisur</p>




<p>e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>me kompjutera, printer/fotokopje/skaner, projektor. Laboratorët e FE janë me një numër të konsiderueshëm kompjuterësh që të mundësojnë çdo student për të punuar personalisht. Në kompjuterët e laboratorëve janë të instaluar programet SPSS, GRETL dhe ALPHA, që studentët të kenë mundësi të aplikojnë njohuritë e tyre direkt.</p> <p><i>(Vizita e GVJ ne USH; Evidenca 4.6. Mjediset e FE-së).</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në Fakultetin Ekonomik, GVJ në vizitën e laboratorëve u prit nga laborantët, të cilët kujdesen për to. Laboratorët janë të pajisur me kompjuter të blerë nga fonde të projekteve kombëtare e ndërkombëtare si dhe me mjete të tjera bashkëkohore për realizimin me sukses të mësimdhënies.</p> <p>GVJ vizitoi edhe salla të tjera leksioni ose seminari dhe konstatoi se ato janë të pajisura me video projektorë, ëhiteboard etj., të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Një avantazh tjetër i Institucionit është edhe sigurimi i internetit ëireless në të gjithë godinën, si për pedagogët, ashtu edhe për studentët, gjë që ndikon në shtimiin e përdorimit të metodave bashkëkohore në mësim.</p> <p>Efikasiteti i përdorimit të laboratorëve dhe mjeteve bashkëkohore për mësimdhënie u konfirmua edhe në takimet me Personelin akademik efektiv dhe jo efektiv, si dhe me studentë të viteve të ndryshme të studimit.</p> <p><i>(Evidenca 4.7: Raportim mbi pajisjet e fituara nga projektet ku FE ka qenë partner 2016-2020, Vizita e GVJ në Institucion me personelin akademik efektiv dhe me kontratë; viziat me studentët e programit të studimit).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ vizitoi dy laboratorët e Fakultetit Ekonomik dhe konstatoi praninë e 30 kompjuterëve në secilin prej tyre dhe nga një laborant (personel ndihmës akademik) përgjegjës për mirëmbajtjen e tij dhe për të asistuar studentët në problematikat që hasin. Laboratorët janë të pajisur edhe me videoprojektorë, ëhiteboard dhe programet e nevojshme statistikore SPSS, GRETL dhe softëare-n e kontabilitetit Alpha.</p> <p>Çdo student ka mundësi të praktikojë njohuritë e marra edhe jashtë orareve mësimore.</p> <p><i>(Vizita e GVJ në Institucion; RVB, Tabela përmbledhëse 16: Mjediset e Fakultetit/Njësisë bazë)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se ai disponon mjedise mësimore dhe</i></p>

	<i>infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimor të programit të studimit dhe për formimin praktik, të veçantë për programin Bachelor "Turizëm". GVJ shpreh vlerësimin: Përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse që vihet në dispozicion të studentëve të programit Bachelor "Turizëm" është në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Ajo gjendet si në formë fizike ashtu edhe në formë digjitale në mjediset e Fakultetit Ekonomik dhe në Bibloteken e USH. Nga vizita në Bibliotekë, GVJ konstatoi gjendjen shumë të mirë të mjediseve të bibliotekës, ambjenteve për të lexuar dhe sistemimi i librave dhe materialeve të tjera në raftë.</p> <p>Gjatë vizitës GVJ u njoh me hapësirën dedikuar titujve të librave për shfrytëzim nga studentët e Bachelor "Turizëm" dhe konfirmoi që ato janë pasuruar dhe ishin në shërbim të natyrës së lëndëve që zhvillohen në këtë program.</p> <p>Një pjesë e kësaj literature ishte siguruar nga bashkëpunimet e departamentit me universitete të tjera perëndimore, sidomos ato amerikane. Përveç literaturës së botuar, studentët kanë në dispozicion ciklet e leksioneve të përgatitura nga pedagogët sipas lëndëve përkatëse, të cilat përditësohen vazhdimisht. Biblioteka, përveç fondit fizik të librave, siguron për studentët edhe abonime dhe shfrytëzim të literaturës digjitale në shqip dhe në gjuhë të huaj. Përmes projekteve Biblioteka Universitare Shkencore, siguron akses pa pagesë në burimet ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë nga: BioOne, Cambridge Journals Online, EBSCO Academic Search Complete, Emerald Engineering ejournal collection, OECD library etj. Biblioteka e USH ka në shfrytëzim platformën U-Library që mundëson rritjen e interaktivitetit të shërbimeve të bibliotekës me studentët në linkun https://ulibrary.rash.al/</p>




	<p>Studentët mund të shfrytëzojnë edhe informacionin nga katalogu online i bibliotekës ne linkun</p> <p>http://bush.unishk.edu.al/instrumente/kataloge-online/</p> <p><i>(RVB; Vizita në institucion; Evidenca XXVI: Libraria (U-library), Revistat elektronike; RVB, Evidenca 4.8. Fondi i librave ekonomik BUSH; Evidenca 4.9. Librat ekonomik të dhuruar nga Sandhill Community College, Evidenca 2.2. Paketa e syllabuseve për programin Bachelor në “Turizëm” 2020-2023)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Biblioteka e USH pasurohet vazhdimisht me literaturë të viteve të fundit falë projekteve ndërkombëtare dhe bashkëpunimeve me universitete perëndimore dhe amerikane. Ato gjenden si në formatin hard-copy, ashtu edhe në atë digjital.</p> <p>Gjithashtu DT kishte kërkuar USH për tu përfshurë në planin buxhetor 2023 blerjen e një fondi të konsiderueshë librash të viteve të fundit për të mbështet programet e studimit në fushen e turizmit që ky department ofron. Blerja e këtij fondi librash ishte përfshirë në buxhetin e USH 2023, sic u shpreh përgjegjësja e DT në takimin me GVJ. Sipas RVB, syllabuset përditësohen çdo vit duke u bazuar në literaturë shqip dhe të huaj të viteve të fundit, dhe kjo rezulton në shumicën e syllabuseve të dorëzuara.</p> <p><i>GVJ sugjeron që syllabuset të përditësohen vazhdimisht me literaturën e viteve të meqenëse turizmi është një fenomen global dhe ka zhvillime dinamike për të cilën bëhen publikime të vazhdueshme informacioni dhe studimesh të ndërmarra për zhvillimin e tij në mënyrë të qëndrueshme.</i></p> <p><i>(Evidenca 2.2. Paketa e syllabuseve për programin Bachelor në “Turizëm” 2020-2023; Evidenca 4.13: Përcjellje të kerkesave buxhetore të DT për planin buxhetor 2023 të USH; Takim i GVJ me Përgjegjësen e Departamentit; Vizita e GVJ në Institucion).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni disponon një Bibliotekë me një koleksion të pasur librash, periodikë, material të tjera me një fond prej 111.000 libra në shqip dhe gjuhë të huaj në formatin letër dhe elektronik dhe i organizuar në seksione. Ky fond i pasur, sidomos elektronik është lehtësisht i aksesueshëm për studentët nga digjitalizimi i vazhdueshëm i skedarëve dhe literaturës aktuale në Bibliotekë ose asaj që shtohet.</p> <p>Në bibliotekë ofrohet mundësia që studentët të kërkojnë materiale online në kompjuterat e sallave, të përdorin sallat e leximit, të cilat janë 3 në total me një kapacitet të përgjithshëm prej 300 vendesh, të përdorin mediatekën me 30 vende kapacitet.</p>




	<p>GVJ, gjatë vizitës dhe takimit me punonjësit e Bibliotekës konfirmoi ekzistencën edhe të sallës së konferencave “Hoeflechner” me kapacitet 120 persona që i shton Bibliotekës funksionet dhe aktivitetet shkencore dhe akademike, zhvillimin e konferencave, workshopeve, etj. <i>(RVB; Vizita e GVJ në bibliotekë).</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Në Bibliotekë ofrohet mundësia për çdo student që të kërkojnë online në kompjuterat e sallave librat dhe material mësimore që gjenden fizikisht në bibliotekë, të përdorin sallat e leximit, të cilat janë 3 në total me një kapacitet të përgjithshëm prej 300 vendesh, por ofrohet edhe shërbimi i huazimit të tyre për përdorim nga studentët etj. Në dispozicion të studentëve janë disa fondeve librash dhe materiale të tjera mësimore në formë digjitale dhe media të ndryshme. Fond i veçantë i Bibliotekës është ai i përfituar nga bashkëpunimi me Ambasadën Austriake në Tiranë, nga e cila janë përfituar rreth 14,000 libra dhe periodikë dhe material në cd/dvd. Gjithashtu, nga vizita në Bibliotekë, GVJ konstatoi ekzistencën e fondit të veçantë dedikuar studentëve në degën e Turizmit, i cili pasurohet me libra të rinj. Në këtë fond gjenden edhe librat e dhuruar nga bashkëpunimi me Sandhill Community College. Në plan buxhetin e 2023 të USH ishte përfshirë blerja e një fondi të konsiderueshëm librash të viteve të fundit në shërbim të programit të turizmit.</p> <p><i>(Takim i GVJ me Përgjegjësen e Departamentit, Takim i GVJ me studentët, Vizitë e GVJ në IAL; Evidenca 4.9. Librat ekonomik të dhuruar nga Sandhill Community College; Evidenca 4.13: Përcjellje të kërkesave buxhetore të DT për planin buxhetor 2023 të USH).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Studentët kanë akses të plotë në shfrytëzimin e kapaciteteve dhe të shërbimeve të bibliotekës, pa pagesë si dhe ju ofrohet edhe platforma online. Biblioteka u ofron shërbim studentëve përmes sportelit të huazimit, sportelit të informacionit, mediatekës me 30 vende (kompjuterat e kësaj salle janë dhuratë e Qeverisë Austriake dhe e Universitetit të Firences përmes projektit Tempus Phare) si dhe përmes tri sallave të leximit afërsisht me 300 vende leximi ku lexuesit e studiuesit mund të lexojnë e shfletojnë literaturë në qetësi të plotë. Biblioteka është e pajisur me kompjutera dhe programe ku studentët mund të aksesojnë online literaturë në funksion të programit mësimor. 21 kompjuterat e sallës së mediatekës të kësaj biblioteke janë në shërbim të studentëve me internet falas që iu vjen në ndihmë për përgatitjen e detyrave të kursit dhe diplomave. Interneti falas në këtë mjedis krijon kushte të favorshme për një studim online, mundëson konsultimin me materiale të ndryshme shkencore si</p>




	<p>dhe të mësuarin në distancë. Në mjedisin e Mediatekës ndodhet dhe fondi i materialeve jo libër (kaseta, cd dhe dvd), ku numërohen rreth 700 materiale multimediale. Biblioteka ka një fond shumë të pasur për tu shfrytëzuar online të përfituara nga projekti ERA 2021 (Electronic Resources for Albania), e cila siguron akses pa pagesë në burimet ndërkombëtare elektronike me tekst të plotë nga BioOne, Cambridge Journals Online, EBSCO Academic Search Complete, OECD library etj. Aksesi në këto librari mundësohet me adresë të regjistruar IP, që janë të gjithë kompjuterët e sallës së Mediatekës. Biblioteka e USH ka në shfrytëzim platformën U-Library që mundëson rritjen e interaktivitetit të shërbimeve të bibliotekës me studentët në linkun https://ulibrary.rash.al/. Studentët dhe pegagogët kanë edhe burime të tjera për shfrytëzim të literaturës online.</p> <p>(Vizita e GVJ në Bibliotekë; http://bush.unishk.edu.al/sherbimet/mediateka/)</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka është e konceptuar të ketë një sallë studimi me pajisje kompjuterike (kompjuterat, videoprojektorë) që krijojnë mundësinë për të punuar në mënyrë individuale apo edhe në grup. Në raste të caktuara studentët mund të shfrytëzojnë këto mjedise për të paraqitur prezantimet e detyrave dhe projekteve të kursit. Gjithashtu në katin e parë të Bibliotekës është një sallë e punës në grup që ndihmon studentët në realizimin e detyrave të kursit në grup. Interneti falas në mjedisin e Bibliotekës krijon kushte të favorshme për një aksesuar një studim online, mundëson konsultimin me materiale të ndryshme shkencore si dhe të mësuarin në distancë. Biblioteka është e aksesueshme për gjithë studentët gjatë gjithë kohës në orarin 08 – 19 ditët e javës, 08-13 të shtunën dhe të djelën është pushim. Studentët mund të përdorin gjithë fondin dhe mjediset e bibliotekës pa pagesë dhe në oraret e përshtatshme për ta. Studentët mund të aksesojnë fondin digjital në çdo moment dhe vend.</p> <p>(Vizitë e GVJ në IAL, website i USH_Biblioteka).</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të</p>	<p>Fondi i Bibliotekës pasurohet vazhdimisht me literaturë dhe personeli i punësuar në të përpiqet vazhdimisht për të rritur aksesimin e studentëve dhe profesorit në bibliotekat online si dhe për shfrytëzimin e mjediseve dhe literaturës fizike. Biblioteka është e aksesueshme për gjithë studentët gjatë gjithë kohës në orarin 08 – 19 në ditët e javës, 08-13 të shtunën. Ky orar është mjaft i përshtatshëm për studentët duke patur parasush orarin e zhvillimit të procesit mësimor. Drejtuesi i njësisë bazë bashkëpunon me punonjëset e bibliotekës për monitorimin e vazhdueshëm të shfrytëzimit të bibliotekës nga studentët e</p>




<p>studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion, në vizitën në bibliotekë u njohëm me kartela të studentëve dhe personelit akademik, të cilat dëshmonin shkallën e mjaftueshme të shfrytëzimit. Numri i personelit të punësuar në Bibliotekë (13 gjithsej) është i mjaftueshëm për të përballuar nevojat e studentëve.</p> <p><i>(Vizita në Institucion; Takimi me përgjegjësen e njësisë bazë dhe drejtuesen e bibliotekës së USH).</i></p>			
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Biblioteka regjistron në mënyrë periodike dhe raporton për cilësinë fizike të librave dhe materialeve në formatin hard copy dhe të fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të studentëve dhe pedagogëve, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe online si dhe të sallave të studimit.</p> <p>Gjithashtu Biblioteka njofton për përditësimet që janë bërë fondit fizik të Bibliotekës dhe mundësitë e reja aksesit në burime ndërkombëtare elektronike. Nga vizita në Bibliotekë dhe takimi me punonjësit e saj, GVJ konstatoi shfrytëzim të konsiderueshëm si të materialeve ashtu edhe të mjediseve të saj.</p> <p><i>(Vizita në Bibliotekë e GVJ; Takimi me punonjësit e Bibliotekës; Evidenca XXVIII: Lista e blerjeve të botimeve nga BUSH 2021-2022; Evidenca 4.8. Fondi i librave ekonomik në BUSH, http://bush.unishk.edu.al/)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme) për programin Bachelor në "Turizëm". GVJ sugjeron që syllabuset të përditësohen vazhdimisht me literaturën e viteve të meqenëse turizmi është një fenomen global dhe ka zhvillime dinamike për të cilën bëhen publikime të vazhdueshme informacioni dhe studimesh të ndërmarra për zhvillimin e tij në mënyrë të qëndrueshme.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

			X	
--	--	--	---	--

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>USH ka faqen e saj elektronike me adresë https://unishk.edu.al/, në të cilën vendosen informacione të ndryshme mbi ecurinë e Universitetit, Fakulteteve si dhe programet e studimit që ofrohen, planin mësimor të programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, njoftime mbi aktivitetet, mundësitë për bursa studimi në universitete të huaja, oraret dhe datat e provimeve, etj.</p> <p>Për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe stafit akademik përdoret Platforma elektronike Pitagora me adresë https://ushk.pitagora.rash.al/login. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për regjistrimin e studentëve dhe pajisjen e tyre me llogari në Pitagora duke i vendosur një username (emër përdoruesi) dhe passëord-in (fjalëkalimin, të cilin studentin mund ta modifikojë).</p> <p>Sekretaria mësimore i dispononte të tre regjistrat që lidhen me studentin dhe aktivitetin e tij nga regjistrimi deri në diplomim: regjistri themeltar i studentit, regjistrin e arritjeve akademike të studentit, regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave.</p> <p>Nga vizita e GVJ në sekretarinë mësimore dhe takimi me sekretaret u kontrolluan regjistrat themeltar të studentëve me të dhënat që vërtetojnë regjistrimin e studentit, numrin e matrikullimit dhe deri në marrjen e diplomës ose çertifikatës. Regjistrat ishin të shkruar qartë, të dhënat ishin hedhur saktë dhe në përputhje me tabelat e dorëzuara për akreditim.</p> <p><i>(Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca XXII: Platforma PITAGORA; https://ushk.pitagora.rash.al/login)</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik,</p>	<p>Zyra e Burimeve njerëzore, protokollit dhe arkivit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Përveç dokumentacionit, në institucion përdoret sistemi i brendshëm i menaxhimit të dhënave SMAK ku hidheshin të dhëna për planin mësimor të programit të studimit, personelin</p>

<p>personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>akademik që angazhohet nga njësia bazë, ngarkesat mësimore dhe realizimi i tyre për stafin akademik PAE, kontrata 1536 orëshe e punës së PAE gjatë vitit akademik, etj. Aktiviteti i stafit akademik për vlersimin përfundimtar të dijeve të marra të studentit në lëndë të ndryshme reflektohet në platformen „Pitagora“ dhe dokumentohet me procesverbalin e notave të studentëve për lëndën.</p> <p><i>(Evidenca XXIV. Sistemi SMAK; Evidenca XXIII. Platforma PITAGORA; Evidenca 3.3. CV stafi akademik i programit Bachelor në "Turizëm"; Vizitë e GVJ në Zyrën e burimeve njerëzore)</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>USH disponon sistem menaxhimi të brendshëm PITAGORA i mësimdhënies që siguron akses të dedikuar për personelin akademik dhe studentët. Krahas sistemit PITAGORA aksesi në informacion realizohet edhe nëpërmjet ëbsite të USH. Këtë GVJ e konfirmoi duke hyrë në adresën https://unishk.edu.al/.</p> <p>GVJ nuk ka akses në sistemin e brendshëm informatik dhe nuk mund të shprehet për informacionin që përmban dhe shpërndahet studentëve dhe pedagogëve.</p> <p><i>(Vizitë e GVJ në Sekretarinë mësimore; takim i GVJ me studentët dhe stafin akademik; Evidenca XXIII. Platforma PITAGORA; https://ushk.pitagora.rash.al/).</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sipas RVB dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se sistemi i menaxhimit të informacionit ka të integruar platformën online, sistemin Pitagora, ku çdo student dhe pedagog kanë llogarinë e tyre dhe marrin informacione sipas nevojave.</p> <p>Sipas dokumentacionit studentët marrin informacion në lidhje me provimet, vlerësimet nga pedagogët gjatë semestrit dhe notën përfundimtare etj. Pedagogët dhe studentët përdorin platformat online për komunikim interaktiv midis tyre, si ajo „Microsoft Teams“, si dhe përdorim të folderëve të përbashkët si: Dropbox, Gdrive etj.</p> <p><i>(Vizitë e GVJ në Sekretarinë mësimore; takim me stafin akademik; Evidenca XXII. Platforma ESSE 3; Evidenca XXIII. Platforma PITAGORA; https://ushk.pitagora.rash.al/).</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm PITAGORA mundëson monitorim në kohë reale të informacionit si për aktivitetin e kryer nga personeli akademik lidhur me procesin mësimor ashtu</p>

<p>mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>edhe për veprimatrinë e kryer nga personeli administrativ dhe ndihmës administrativ.</p> <p>Referuar dokumentacionit shoqërues GVJ konstaton se struktura dhe forma e funksionimit të sistemit mundëson hartimin e raportimeve si në nivel individual ashtu edhe në nivel programi lidhur me çështje si regjistrimi i studentëve, frekuentimi, arritjet dhe saktësisë së punës nga punonjësit administrativ.</p> <p>Gjithashtu, aplikacioni SMAK ka mundësuar evidentimin elektronik dhe monitorimin e të dhënave mbi planet mësimore, ngarkesat e pedagogëve, raportet e realizimit të orëve akademike vjetore etj. Të gjitha të dhënat personale dhe institucionale në këto platforma mbrohen nga politika e privatësisë e USH.</p> <p><i>Nga kontrolli i dokumenteve të dorëzuara në sistemin online të ASCAL-it në lidhje me këtë kriter vihet re mospërputhje në numrin e evidencës së 'Platformës Pitagora' (në sistem është XXIII, në RVB shfaqet me nr. XXII) si dhe në numrin e evidencës që i referohet 'Sistemit SMAK' (Evidenca XLIX në RVB emërtohet Platforma SMAK, në sistem Evidenca XLIX është Platforma SMUSHK. SMAK është një aplikacion, jo platformë siç emërtohet në RVB dhe referohet në sistem me evidencën XXIV. Sistemi SMAK)</i></p> <p><i>(Vizita e GVJ në Institucion; takimi me Përgjegjës të Njësive bazë, studentët dhe sekretarët; RVB dhe Evidencat XXIII. Platforma PITAGORA; Evidenca XXII. Platforma ESSE 3; Evidenca XXIV. Sistemi SMAK; Evidenca XXXV. Politika e Privatësisë).</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ hyri në faqen e institucionit referuar adresës në RVB dhe konstatoi publikimin e aktiviteteve të realizuara nga institucioni në kuadër të përmbushjes të programit Bachelor në Turizëm.</p> <p>https://unishk.edu.al/</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin</i></p>

	<i>Bachelor në Turizëm. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni USH harton një raport financiar të kostove dhe planin për mbështetjen financiare të tij nga njësisia bazë përgjegjëse për programin Bachelor në Turizëm. Në këtë plan janë të detajuara kostot për zërat në shërbim të realizimit të programit të hartuara konform legjislacionit në fuqi për financimin dhe menaxhimin e burimeve financiare për veprimtaritë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Paraqitja e raportit financiar kryhet në kuadër të hartimit të planit buxhetor institucional afatmesëm në të cilin paraqitet kostoja mesatare e programit të studimit në varësi të grantit të dhënë nga MAS dhe numrit të studentëve të regjistruar si dhe duke identifikuar burime të tjera të mundshme për sigurimin e të ardhurave. Në RVB ngrihet shqetësimi i centralizimit të planifikimit financiar dhe realizimit të tij, pasi në fakultete nuk ka administrator dhe si rrjedhojë nuk ka shumë pavarësi në administrimin e financave të tyre.</p> <p><i>GVJ, nga shqyrtimi i RVB-së dhe dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e ASCAL, vuri re mungesë të dokumentit në system të Evidencës XLIII. Rregullore Ekonomiko-Financiare, i cili është referuar në këtë kriter.</i></p> <p>(RVB; Evidenca XLVII. Miratim Projekt-Buxhetit 2023; Evidenca 4.10. Raportimi financiar i programeve të FE-së; Evidenca 4.11. Analiza financiare e kostos së programit Bachelor në Turizëm).</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e</p>	<p>Në faqen online të USH në kategorinë Buxheti janë dokumentet me raportet financiare. <i>Për vitin 2023 ka vetëm një raport për periudhën janar-shkurt, ndërsa për vitet paraardhëse raportet janë me frekuencë më të lartë.</i></p>

<p>burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Institucioni përgatit raportin e analizës financiare për tre vitet e fundit për të evidentuar realizimin e të ardhurave dhe nivelin e shpenzimeve. Në analizën financiare 2022 pasqyrohet projekt buxheti afatmesëm dhe afatgjatë, ku përcaktohen objektivat dhe investimet e nevojshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në të gjitha programet e studimit.</p> <p><i>(Evidenca XXXIV. PROGRAMI I TRANSPARENCËS; Evidenca XVIII. ANALIZA FINANCIARE 2022; Evidenca 4.10. Raportimi financiar i programeve të FE-së; https://unishk.edu.al/universiteti/buxheti).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>USH dëshmon se kryen auditim të brendshëm periodik. Burimet financiare që auditohen janë ato të siguruar nga buxheti i shtetit, tarifat e studentëve dhe burime të tjera. Duke u bazuar në programin e transparencës, USH shpall pasqyrën e të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe burimet e tjera.</p> <p>GVJ nuk konstatoi ndonjë dokument në formën e raportimit nga procesi i ndonjë auditimi të realizuar më parë, përsa i përket aspektit financiar. Dokumenti i dorëzuar si Raport auditimi-model sekretaria mësimore, ka objekt tjetër auditimi, jo atë financiar.</p> <p><i>(RVB; Evidenca XXXIV. PROGRAMI I TRANSPARENCËS; Evidenca 4.12. Raport auditimi-model sekretaria mësimore. Vizita e GVJ në IAL)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Dokumentacioni shoqëruar i RVB përmban analizë financiare të kostos së programit Bachelor në Turizëm, si dhe analizën financiare për vitet e mëparshme. Në analizat financiare përshkruhen në vlerë numerike masa e shpenzimeve të kryera për paga, orë mësimore, për sigurime shoqërore e shëndetësore, mbi ngarkesë mësimore, pagat e personelit akademik të ftuar, shtesa funksionesh akademik, bursa dhe parashikohen shpenzimet për vitin e ardhshëm akademik.</p> <p><i>(Evidenca 4.10 Raportim financiar për programet FE; Evidenca 4.11. Analizë financiare e Kostos programit</i></p>




	Bachelor në Turizëm; Evidenca 4.13. Përcjellje të kërkesave buxhetore të DT për planin buxhetor 2023 USH).			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	<p>Relacioni për buxhetin afatmesëm dhe afatgjatë përgatitet nga zyra e financës dhe në të analizohen të gjithë programet e studimit sipas nevojave të parashtruara nga njësia bazë përkatëse. Çdo njësi bazë përgatit dhe dorëzon kërkesat buxhetore në fillim të vitit akademik.</p> <p>(Evidenca 4.10 Raportim financiar për programet FE; Evidenca 4.13. Përcjellje të kërkesave buxhetore të DT për planin buxhetor 2023 USH).</p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin Bachelor në "Turizëm". Gjithashtu konstaton se, për vitin 2023 mungojnë në faqen online raportimet financiare nga muaj mars e në vazhdim. Mbështetur në sa më sipër GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet kryesisht</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

V STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Programi Bachelor në “Turizëm” zhvillohet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, statutin e USH-së, me rregulloren e Studimeve Universtrare në USH, rregulloren e FE në USH dhe rregulloren e Departamentit të Turizmit.</p> <p>Rregullorja e USH për studimet universitare është dokumenti në të cilin rregullohet zhvillimi i studimeve në këtë Universitet. Në të përcaktohen qartë të gjitha njësitë, rolet dhe përgjegjësitë përkatëse për mbarëvajtjen e plotë të mësimdhënies në çdo njësi kryesore dhe bazë.</p> <p>Kjo rregullore i bashkangjitet dokumenteve të tjera të USH-së dhe i shërben edhe studentëve të këtij program studimi për t’u bërë me dije për të drejtat dhe detyrimet e tyre përgjatë gjithë kohës së studimit pranë këtij institucioni. Rregulloret shkojnë deri në nivel programi dhe kjo ndikon në përmirësimin e cilësisë së mësimin dhe adresimin e problematikave specifike për çdo program. USH ka hartuar politika zhvillimi, strategji të ndryshme që mbulojnë ciklin e parë të studimeve. Në mbështetje të tyre, edhe njësi bazë DT ka hartuar strategjinë e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në Turizëm 2023-2026.</p> <p><i>(Evidenca I. STATUTI I USH-së; Evidenca II. RREGULLORE E STUDIMIT NË USH; Evidenca IV. STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES; Evidenca 1.5. Rregullore e FE-së; Evidenca 1.6. Rregullore e DT; Evidenca 1.7. Rregullorja e programit Bachelor në “Turizëm”; Evidenca 1.4: Strategjia e zhvillimit të programit Bachelor në Turizëm).</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar rregullores së institucionit, të programit të studimit dhe evidencave të tjera shoqëruese strategjik dëshmohet se një ndër parimet e funksionimit të USH-së lidhet me faktin se kriteret dhe procedurat në hyrje e deri në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student në programin Bachelor në Turizëm.</p>

	<p>Referuar rregullores së programit Bachelor në “Turizëm”, neni 5, pika 3 përcaktohet se studimet në këtë program mund të ndiqen edhe nga shtetas të huaj, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe dhe ligjeve në fuqi. Rregullorja e FE-së përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga pranimi, regjistrimi dhe deri në përfundim të studimeve, gjë që garanton një proces transparent dhe trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe studentët.</p> <p><i>(Evidenca I. STATUTI I USH-së; Evidenca II. RREGULLORE E STUDIMIT NË USH; Evidenca IV. STRATEGJIA E MËSIMDHËNIES; Evidenca 1.4: Strategjia e zhvillimit të programit Bachelor në Turizëm; Evidenca 1.5. Rregullore e FE-së; Evidenca 1.6. Rregullore e DT; Evidenca 1.7. Rregullorja e programit Bachelor në “Turizëm”; Evidenca 1.14. Raportim Panairi i punës së FE-së ndër vite)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret përcaktohen nga njësia bazë përgjegjëse për programin dhe i bëhet me dije QSHA nga USH.</p> <p>Në nenin 20 të Rregullores së studimeve në USH në këtë program studimi mund të transferohen të gjithë ata që plotësojnë kriteret e vendosura nga Rektorati, pavarësisht nëse janë nga IAL të tjera ose nga vetë USH. Gjithashtu, GVJ konfirmoi që rregullimet për vlerësimin, transferimin, gjenden në faqen online të Universitetit dhe mund të përdoret nga kushdo në çdo kohë.</p> <p>Me vendim të Senatit Akademik parashikohen edhe kriteret e regjistrimit për studentët e huaj. E gjithë struktura organizative e USH-së është në shërbim të studentëve në çdo fazë të studimeve dhe karrierës pa dallime. GVJ e konfirmoi këtë edhe në takimin që zhvilloi me studentët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>(RVB; takim i GVJ me studentët; Evidenca II. RREGULLORE E STUDIMIT NË USH; Evidenca 5.1. Udhëzim nr.10, datë 15.05.2019, Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë; Evidenca 5.2. Përcillet për miratim në SA propozimi i DT për kriteret e pranimit 2022-2023 për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve; Evidenca 5.3. Vendim i SA për miratim të kriterëve të pranimit të studentëve 2020-2021).</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së</p>	<p>Krahas të dhënave që jepen në RVB-në e programit të studimit dhe dokumentacionit shoqërues GVJ konfirmoi ekzistencën e kriterëve e procedurave edhe gjatë vizitës në institucion ku</p>




<p>studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>studentët dakortësojnë ekzistencën dhe aksesueshmërinë e të gjithë informacionit që lidhet me procedurën që nga pranimi dhe përzgjedhja e studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, informacione këto që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> <p>Të interesuarit për të aplikuar në programin e studimit Bachelor në Turizëm mund të marrin informacion të detajuar edhe në faqen zyrtare online dhe rrjetet sociale të USH dhe Fakultetit.</p> <p><i>(Evidenca I. STATUTI I USH-së; Evidenca II. RREGULLORE E STUDIMIT NË USH; Evidenca XIII. GUIDA E STUDENTIT; Evidenca 1.5. Rregullore e FE-së; Evidenca 1.6. Rregullore e DT; Evidenca 1.7. Rregullorja e programit Bachelor në "Turizëm"; https://unishk.edu.al/pranimet-e-studenteve-te-rinj-2022-2023).</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Pranimi për programet e studimit në USH të çdo kandidati që ka përfunduar ciklin e mesëm arsimor duhet të plotësojë këto kriteret: Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë edhe provimet e Maturës Shtetërore (Llogaritur sipas VKM Nr.346, datë 19.04.2017).</p> <p>Në rastin e pikëve të barabarta merret në konsideratë, mesatarja e provimeve shtetërore e në rast të njëjtë tjetër do të shihet mesatarja e tre viteve të shkollës së mesme.</p> <p>Për programin e studimit Bachelor në Turizëm nuk ka kriteret të tjera shtesë dhe formulë përlllogaritjeje përveç mesatares së thjeshtë të përmendur më lart. Institucioni dëshmon se nuk aplikon kriteret shtesë por zbaton aktet ligjore dhe nënligjore të MAS-it lidhur me përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p><i>(Vizita në Institucion dhe takimi me drejtuesin e njësisë bazë; faqja zyrtare e USH-së; Evidenca 5.1. Udhëzim Nr.10, datë 15.05.2019, Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në IAL-të. Evidenca 5.2. Përcillet për miratim në SA propozimi i Departamentit të Turizmit për kriteret e pranimi 2022-2023 për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve).</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni bashkëshoqërues konsaton se USH zbaton të gjitha aktet ligjore dhe VKM-të që lidhen me kategoritë e individëve që përjashtohen nga tarifat e shkollimit</p>




<p>kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>dhe kushtet e përfitimit të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë.</p> <p><i>(Takimi GVJ me studentët;</i> https://unishk.edu.al/universiteti/bursa; https://unishk.edu.al/pranimet-e-studenteve-te-rinj-2022-2023). <i>)</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar, verifikimi në faqen zyrtare online dhe nga vizita në Institucion, GVJ konstaton se USH ka në vëmendje parashikimin e kuotave të pranimit për kategoritë e veçanta si dhe për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare etj. Kriteret dhe kuotat për këtë kategori studentësh hartohen dhe publikohen në Departamentet përkatëse, përcillen në dekanat dhe më pas SA merr vendimin përkatës. Në RVB përmendet që në përfundim të procedurave në IAL, kriteret dhe kuotat i përcillen MAS në afatet e përcaktuara.</p> <p><i>(Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca 2.3. Evidenca 5.2. Përcillet për miratim në SA propozimi i Departamentit të Turizmit për kriteret e pranimit 2022-2023 për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve).</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe verifikimit të faqes online të Universitetit, GVJ konstaton se ai mbështetet në legjislacionin në fuqi dhe në aktet e tjera Institucionale për të hartuar politikat e ndihmës/bursave sipas kategorive përfutuese. Kriteret dhe mënyrat e përfitimit të tyre publikohen në faqen zyrtare të USH-së, afishohen në mjediset e dedikuara në ndërtesat e IAL-së etj.</p> <p><i>(Vizita e GVJ në Institucion; Takimi me studentët dhe stafin akademik; Evidencë: VKM nr. 386, dt. 01.06.2022, Për miratimin e fushave dhe programeve të studimit që përbëjnë prioritet qeveritar dhe mbështetja financiare e tyre dhe Udhëzuesi i MAS; Evidenca 5.8. Formulari i aplikimit për bursë dhe vendimi i administratorit për komisionin ad-hoc të bursave të studentëve;</i> https://unishk.edu.al/universiteti/bursa). <i>)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se institucioni harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin për programin Bachelor në "Turizëm". Përmbushet plotësisht.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, dhe nga takimi me përgjegjësen e DT, pedagogët dhe studentët, vizita në Fakultet, GVJ konsatoi se që në hyrje të studimeve e deri në diplomim, studentët informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si; planin mësimor të programit të studimit, kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet me bursë, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, procedurat e zhvillimit të praktikës profesionale, për lëndët dhe temat për provimin e mbrotjes së diplomës, udhëzimet e për punimin e diplomës, njoftime për strukturën mësimore të vitit akademik, për organizimin e orarit të mësimit, të provimeve dhe mbrotjes së diplomës, njoftime mbi veprimtari akademike, shkencore, kulturore, sportive, humanitare, sikurse dhe kriteret e procedurat e regjistrimit në programet Master të DT, dhe në programet e tjera që ofron FE.</p> <p><i>(Evidenca II. RREGULLORE E USH-së; Evidenca 1.5. Rregullore e FE; Evidenca 1.6. Rregullore e DT 2020; 1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm; Evidenca LI: Paketa e praktikës profesionale në USH; Evidenca XXIII. PLATFORMA PITAGORA; Evidenca XXII. PLATFORMA ESSE 3; Vizita në Institucion).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në USH studentët informohen në lidhje edhe me njohjen e kualifikimeve të tyre të mëparshme ose të kryera herët në kohë, ose të njohjes së studimeve të pjesshme të kryera nga mobilitetet me Erasmus+, Ceempus në universitete të tjera jashtë vendit sikurse pranohen edhe transferime të studentëve nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. E gjithë kjo procedurë është e rregulluar me dokumentacionin përkatës dhe parashikohet në nenet përkatëse për transferimet në rregulloren e studimeve në USH dhe rregulloreve të FE; DT dhe të programit Bachelor në “Turizëm”. Procedura, kuotat,</p>

	<p>kriteret etj, gjenden lehtësisht edhe në faqen zyrtare online të USH.</p> <p>(RVB, Evidenca II. RREGULLORE E USH-së; Evidenca 1.5. Rregullore e FE; Evidenca 1.6. Rregullore e DT 2020; 1.7. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm; Evidenca XXXIV. PROGRAMI I TRANSPARENCËS, USH).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti i Shkodrës në të gjitha nivelet e tij kujdeset për mirëinformimin e studentëve lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve, të cilin e realizojnë nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloreve të programit të studimit; Rregullorja ‘Paketa e praktikës profesionale’ • Guidës së maturantit dhe studentëve të regjistruar në vitin e parë të programit Bachelor në “Turizëm” • Syllabuseve lëndore që jepen nga personeli akademik në orën e parë të fillimit të çdo lënde. • Personelit akademik, ndihmës akademik dhe jo akademik në fillim të çdo semestri etj. <p>Në lidhje me diplomimin eksiston një informacion i shprehur përmes rregullores së studimeve. Gjithashtu në lidhje me zhvillimin e vlersimin e praktikës profesionale egziston rregullorja e paketës së praktikës profesionale. Rregullorja e programit të studimit, Paketa e praktikës profesionale, Udhëzimet për punimin e temës së diplomës dhe syllabuset aksesohen online nga studentët. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimet me studentët dhe stafin akademik në IAL si dhe eksplorimi në faqen zyrtare online të USH-së, GVJ konstaton se informimi i studentëve lidhur me procedurat e vlerësimit është i larmishëm dhe i shtrirë në disa plane. Kjo u konfirmua edhe gjatë takimit me studentë në ditët e vizistës në institucion.</p> <p>(Evidenca II. RREGULLORE E USH-së; Evidenca LI: Paketa e praktikës profesionale në USH; Evidenca 1.5. Rregullore e FE; Evidenca 1.6. Rregullore e DT 2020; Evidenca 2.2. Paketa e syllabuseve 2020-2023 dhe vendimet e DT për miratimin e tyre).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe</p>	<p>Në takimin me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se Departamenti ndjek të gjitha mënyrat për të informuar saktë dhe në kohë studentët në lidhje me procedurat e punimit të diplomës dhe provimit të diplomimit në programin e studimit Bachelor në “Turizëm”. Studentët e gjejnë këtë informacion edhe në Rregulloren e studimeve në USH si dhe rregulloret e</p>




<p>diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>tjera deri në nivel programi dhe udhëzimet e miratuara në nivel Fakulteti. Vendimi i departamentit, i miratuar nga Dekania, për lëndët dhe temat e përfshira në provimin e mbrotjes së diplomës i dërgohen studentëve në aplikacionin 'Teams' dhe i afishohen në Bordin e informacionin të programit Bachelor në Turizëm. Gjithashtu informohen edhe në lidhje me prapun e notës mesatare për të mbrojtur diplomën me temë diplome.</p> <p><i>(Vizita dhe takimet e GVJ në Institucion; RVB; Evidenca II. RREGULLORE E USH-së, Kreu V, neni 37; Evidenca 1.6 Rregullore e programit të studimit Bachelor në 'Turizëm'; Evidenca 3.9. Miratimi i Dekanatit të paketës së përgatitjes së diplomës; Evidenca 3.7 Vendim DT për lëndët dhe temat për t'u përfshirë në mbrotje diplome me provim për sistemin Bachelor).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Mbështetur në strategjinë e marketingut dhe të rekrutimit USH planifikon dhe zbaton kalendarin vjetor të aktiviteteve të cilat kanë si qëllim rekrutimin e studentëve të rinj në programet e studimit që ofrohen. Disa prej natyrës së aktiviteteve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Publikimi i udhëzuesve të veçantë për aplikimet e maturantëve, • Publikimi i materialeve promovuese të programit të studimit për maturantëve në median sociale të USH; FE • Pjesëmarrja në takimet e hapura të organizuara për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm të shkollave të mesme nëpër qytetet e rajonit verior • Vizitat e stafit në institucionet arimore të arsimit parauniversitar; • Organizimi në ambjentet e Fakultetit Ekonomik të aktivitetit 'Mirësevjen Maturant' • Informimi dhe promovimi në median lokale dhe kombëtare <p><i>(RVB; Vizita në institucion: Takimi me Përgjegjësen e njësisë bazë DT dhe personelin akademik të tij; Evidenca 5.4. Relacion i aktivitetit "Mirësevjen maturant"; Evidenca XIII. GUIDA PËR STUDENTËT).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në IAL, GVJ konkludon se ai vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në "Turizëm" informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit. Përbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>USH me Fakultetet e Departamentet përkatëse përdor format të ndryshme për të informuar student përsa i përket strukturës dhe kohëzgjatjes së programeve të studimit. Sipas RVB dhe takimit me studentët e stafin akademik, Departamenti i Turizmit organizon një takim informues për programin Bachelor në “Turizëm” ku prezantohen elementët e programit të studimit, planin mësimor, kohëzgjatjen e programit, strukturën e Institucionit etj. Studentët informohen edhe me anë të faqes zyrtare online të USH si dhe broshurave informuese, afishimeve në këndin e njoftimeve etj.</p> <p><i>(RVB; Vizita në Institucion; Evidenca II. GUIDA PËR STUDENTËT; Evidenca 3.12. Miratim i planit kalendarik 2022-2023 të USH dhe struktura e vitit të tretë FE; ëëë.unishk.edu.al).</i></p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Institucioni përdor disa mënyra për të informuar në çdo kohë studentët në lidhje me rregulloret e programit të studimit, planet mësimore, lëndët/ modulet, mënyrat e vlerësimit etj. Nga vizita në institucion u evidentua se plani mësimor i programit të studimit me kreditet, ngarkesën mësimore, forma e vlersimit për çdo lëndë afishohej në këndin e informimit për studentët e Bachelorit në ‘Turizëm’. USH ka rregullore të veçantë për ‘Praktiken profesionale’. Informacionet e mësipërme, përveçse të printuara janë lehtësisht të aksesueshme në faqen e internetit të USH. Syllabusi dhe udhëzimet për detyrat e kursit të lëndës, përveçse të printuara, shpërndahen nëpërmjet platformave të mësimin, si TEAMS, rrjeteve sociale me studentët etj.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Institucioni kontrollon marrjen apo jo të informacionit nga studentët për modulet, lëndët, metodën e vlerësimit dhe detyrat detyrat që do të zhvillohen gjatë kursit, nëpërmjet pyetësorëve që i realizon në fund të çdo semestri.</p>





	<p>Kjo vlerësohet si një punë shumë e mirë që bëhet nga ana e institucionit për vrojtimin në mënyrë sistematike të masës me të cilën përmbushet marrja e informacionit nga studentët.</p> <p><i>(RVB; Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca III. Strategjia e komunikimit dhe informimit publik; evidenca xiii. Guida për studentët; Evidenca 2.2. Paketa e syllabuseve të programit Bachelor në “Turizëm” 2020-2023; ëëë.unishk.edu.al; Evidenca 6.7 Zyra e sigurimit cilesise - Realizimi dhe analiza e pyetësoreve të studenteve për programin Bachelor në Turizëm 2021-2022).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka disa struktura që adresojnë vënien në kontakt të studentëve me mundësitë e punësimit. Institucioni organizon çdo vit panairin e tregut të punës si dhe ka strukturën e bordit të tregut të punës që mundëson lidhjen e studentëve të punësuar me universitetit. Gjithashtu FE me marrëveshje me organizata dhe biznese ka ngritur ‘Forumit e përbashkët FE-Palët e interesit’, i cili ka si qëllim edhe nxitjen dhe lehtësimin e aksesit të studentëve në tregun e punës, rritjen e mundësisë së punësimit të studentëve dhe të diplomuarve. Në RVB është shënuar si dokument mbështetës për këtë pikë Evidenca XLI. RREGULLORE E ZYRËS SË KARRIERËS DHE ALUMNIT, të cilin GVJ nuk e gjen në dokumentet e ngarkuara në platformën online të ASCAL.</p> <p><i>(Evidenca VIII. Strategjia e zhvillimit 2022-2026; evidenca vii. Strategjia e tregut të punës; Evidenca 1.14. Raport i Panairit të Punës së FE ndër vite; RVB; Evidenca 1.10.4 Marrëveshje bashkëpunimi FE dhe palëve të interesit; Takimi me përfaqësues të Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimet e realizuara u informua mbi sistemin dhe strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Institucioni, përmes koordinorit të programit të studimit mban komunikim dhe informonte studentët për njoftimet që lidheshin me procesin mësimor. Gjithashtu njoftimet vendoseshin dhe në këndin e njoftimeve. Njoftimi realizohej dhe në rrugë elektronike përmes postes elektronike të studentit apo ZSS.</p> <p><i>(Vizita në Institucion, takimi me studentë, RVB; ëëë.unishk.edu.al; Evidenca XIII. GUIDA PËR STUDENTËT).</i></p>




<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Për të siguruar shpërndarjen e informacioneve në çdo kohë dhe vend, USH përdor sistemin e menaxhimit të informacionit të brendshëm, Pitagora, më parë ESSE 3. Sistemi përdoret nga stafi akademik, jo akademik dhe studentët për menaxhimin e informacioneve të ndryshme.</p> <p>GVJ, nuk mund të kontrollojë funksionimin e sistemit Pitagora, por në takimet me studentët dhe pedagogët ata konfirmuan përdorimin gjerësisht të tij për aspekte të ndryshme të menaxhimit të ciklit akademik.</p> <p>(RVB; takimi me stafin akademik dhe studentët; Evidenca XXII. Platforma ESSE 3; Evidenca XXIII. Platforma PITAGORA).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Institucioni kontrollon marrjen apo jo të informacionit nga studentët për modulet, lëndët, metodën e vlerësimit dhe detyrat detyrat që do të zhvillohen gjatë kursit, nëpërmjet pyetësorëve që i realizon në fund të çdo semestri. Institucioni, përmes koordinatorit të programit të studimit mban komunikim dhe informonte studentët për njoftimet që lidheshin me procesin mësimor. Gjithashtu njoftimet vendoseshin dhe në këndin e njoftimeve. Njoftimi realizohej dhe në rrugë elektronike përmes postes elektronike të studentit apo ZSS.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ pa fizikisht dokumentacionin që lidhej me statistikat vjetore për numrin e studentëve që kanë aplikuar, vazhdojnë studimet dhe janë diplomuar në programin Bachelor në “Turizëm”. Institucioni disponon statistika për studentët e diplomuar në vitin akademik 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022, në Zyrën e Informacionit dhe Statistikës.</p> <p>Numri i studentëve rezultoi :</p> <p>Viti akademik 2020-2021 68 studentë;</p> <p>Viti akademik 2021-2022 52 studentë;</p>

	<p>Viti akademik 2022-2023 69 studentë;</p> <p><i>(Vizita në institucion-Takimi në sekretarinë mësimore; RVB; Evidenca: Tabelat përmbledhëse FE nr.23)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Në vizitën në Institucion dhe zyrën e Sekretarisë Mësimore të Fakultetit Ekonomik, GVJ u njoh me regjistrat dhe statistikat në lidhje me studentët. Sekretaria mësimore ruan të dhënat në lidhje me regjistrimet e studentëve, tërheqjet, largimet para diplomimit etj. Të dhënat përcillen me shkresa të protokolluara në instancat e tjera. Nga kontrolli i rastësishëm i dosjeve të studentëve të dorëzuara në regjistrim në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi saktësi të tyre dhe të plota përsa i përket informacionit që kërkohet. Të dhënat për studentët përfshihen edhe në analizat vjetore të departamentit.</p> <p><i>(RVB; Vizita e GVJ në Sekretarinë Mësimore të FE-së; Evidenca 1.9.2 dhe 1.9.3. Analiza vjetore e veprimtarisë Akademike-shkencore të DT 2020-2021 dhe 2021-2022; Evidenca TABELA PËRMBLEDHËSE FE nr.21).</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ iu vu në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program, ata që ishin çregjistruar dhe ata që ishin me status aktiv. Institucioni disponon të dhëna vjetore për programin e studimit Bachelor në “Turizëm”. Gjithashtu përmes sistemit PITAGORA Institucioni e ka më të lehtë të gjenerojë statistika në çdo kohë.</p> <p><i>(Vizita e GVJ në sekretarinë mësimore; RVB; Evidenca XXIII. PLATFORMA PITAGORA)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar dhe vizitën e GVJ në Institucion vërtetohet që USH kontrollon në mënyrë periodike në nivel Fakulteti dhe Universiteti, të gjitha njësitë përgjegjëse për menaxhimin e informacionit në lidhje me studentët dhe veprimtaritë e tyre. Drejtoria e Auditit të Brendshëm në FE ngre grup pune në nivel njësie kryesore për të ushtruar kontrollin.</p> <p><i>(Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca 4.12. Raport auditimi-model sekretaria mësimore; Evidenca I. STATUTI I USH-së).</i></p>




<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Njësia bazë e programit Bachelor në “Turizëm” realizon çdo vit analizën vjetore, ku shqyrtohet arritja e objektivave për programet e studimit, si dhe puna me studentët dhe të dhënat për regjistrimin e tyre, numrin e të diplomuarve, të të punësuarve pas diplomimit etj. GVJ e konfirmoi hartimin e raporteve si nëpërmjet dokumenteve ashtu edhe në takimin me përgjegjësin e njësisë bazë të programit të studimit dhe takimin me personelin akademik.</p> <p><i>(RVB; Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca 1.9.2 dhe 1.9.3. Analiza vjetore e veprimtarisë Akademike-shkencore të DT 2020-2021 dhe 2021-2022).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton përmbushjen e të gjitha kërkesave dhe kriterëve lidhur me vënien në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit, nga ana e USH, FE dhe DT për programin e studimit Bachelor në “Turizëm”. Përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në Statutin e USH, studentët përfshihen në disa struktura drejtuese me karakter mësimor-kërkimor dhe shërbime. Përfaqësuesit e studentëve përfshihen në struktura si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bordi i Administrimit; • Senati Akademik; • Këshilli i Studentëve; • Këshillat e studentëve në nivel Njësie Kryesore; • Organet këshilluese studentore në nivel njesie bazë në FE; • Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor, në GVB; <p>Evidencat shoqëruese dhe nga takimet në Institucion, GVJ konstaton se USH është në zbatueshmëri të Ligjit 80/2015 “Për</p>




	<p>arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet e drejta e studentëve për tu përfaqësuar në strukturat e sipërpërmendura.</p> <p><i>(RVB; Takimet e Gvj Në Institucion; Evidenca XXXI. Urdhër Për Fillimin Eprocesit Të Zgjedhjeve Të Këshillave Studentore; Evidenca XXXII. Rregullore E Zgjedhjeve Të Këshillave Studentore; Evidenca XXXIII. Rregullore E Këshillave Studentore; Evidenca L. Vendim Për Anëtarësimin Në Bord Të Përfaqësuesit Të Studentëve, Evidenca 5.6 Vertetim për zgjedhjen e kryetarit të këshillit studentor në FE dhe organeve këshillues studentor në nivel mjësie bazë).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Krahas detyrimeve të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e USH, institucioni përdor disa forma të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e procesit akademik përmes pyetësorësh në përfundim të çdo semestri, përpara sezonit të provimeve.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentit për analizimin e pyetësorëve të studentëve GVJ konstaton se studentëve u kërkohet të vlerësojnë pedagogët për zhvillimin e lëndës përsa i përket përgatitjes; metodave të përdorura në mësim; vlerësimit sipas rubrikave; efikasitetin e leksioneve dhe seminareve; literatura e përdorur dhe ajo e rekomanduar; komunikimi gjatë gjithë semestrit etj.</p> <p>Pyetësori studentor hartohet në bashkëpunim midis sektorit të kurikulave dhe sigurimit të cilësisë. Pyetësori siguron anonimatën e studentit. GVJ konstaton se institucioni jo vetëm që përfshin student në procesin e vlerësimit por vjel mendimin e tyre në çdo aspekt të procesit mësimor dhe infrastrukturës mësimore.</p> <p>GVJ, nga shqyrtimi i dokumentave dhe takimi me studentët, konsiston që edhe NJSBC e FE i përfshin studentët para diplomimit në vlerësimin e cilësisë së programit, opinionet e tyre për dobine e programit, performancën e mësimdhënies, organizimin e provimeve, përputhshmërinë e programit me tregun e punës, vlefshmërinë e panairit të punës për tju lehtësuar aksesin drejt tregut të punës. Gjithshtu ajo zhvillonte anketime në fund të semestrit për performance e stafit akademik të angazhuar në zhvillimin e lëndëve.</p> <p>Informacioni i grumbulluar është i bollshëm dhe me to hartohen raportet që analizojnë rezultatet e këtyre instrumentave në nivel të strukturave drejtuese. Keto raporte analizohen në mbledhje departamenti për marrje masash përkatëse për përmirsim.</p>




	<p>USH garanton marrjen parasysh të problematikave të shprehur nga studentët në këshillat studentor përsa i përket programeve të studimit, planeve mësimore dhe procesit mësimor. Këshillat studentor veprojnë si organe të pavarur në këtë IAL.</p> <p><i>(Takim i GVJ me përgjegjësen e departamentit dhe studentët; Evidenca 5.6. Vërtetim për zgjedhjen e këshillit studentor-organet këshilluese për çdo njësi bazë në Fakultetin Ekonomik; Evidenca 6.7. Zyra e sigurimit cilësisë - Realizimi dhe analiza e pyetësorëve të studentëve për programin Bachelor në Turizëm 2021-2022; Evidenca 6.8 Përshkrim i zhvillimit të pyetësorit nga studentët për stafin akademik në FE datë 10.3.2021; Evidenca 6.2 Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE dhe Raport analize e vlerësimit të programit studimit nga studentet datë 16.5.2023; Evidenca 6.4 Relacion DT i mbledhjes 20.4.2022 për performancën e stafit akademik dhe pedagogëve të jashtëm të DT për semestrin e parë 2021-2022).</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit në bazë të rregullt vihet re në, realizimin e pyetësorit që iu bëhet studentëve dy herë në vit, përpara provimeve të semestrit përkatës. Në këtë pyetësor, ka një rubrikë e cila titullohet “Lëndët e zhvilluara”.</p> <p>Në këtë rubrikë studentët nëpërmjet pyetjeve të shtruara në pyetësor japin mendimet e tyre lidhur me: materialet mësimore, qartësinë e shpjegimit të tyre në leksion dhe diskutimit në orët e seminarit/ushtimeve; vlerësimi i zhvillimit të rregullt të mësimit; gadishmërinë e pedagogut për të shpjeguar për pyetjet në lidhje me procesin mësimor; marrëdhënien e pedagogut me studentët në përputhje me kodin e etikës etj.</p> <p>GVJ në takimin me drejtuesen e njësisë bazë përgjegjëse për programin dhe me studentët u theksua rëndësia dhe vlera e përfshirjes së studentëve për vlerësimin e procesit akademik, ruajtja e anonimitetit të tyre për të pasur rezultate sa më afër realitetit si dhe realizimi i mbledhjeve të departamentit në formatin e hapur ku ftohen dhe studentët.</p> <p><i>(RVB; Takim i GVJ me përgjegjësen e departamentit dhe studentët; Evidenca 5.6. Vërtetim për zgjedhjen e këshillit studentor-organet këshilluese për çdo njësi bazë në Fakultetin Ekonomik; Evidenca 6.7. Zyra e sigurimit cilësisë - Realizimi dhe analiza e pyetësorëve të studentëve për programin Bachelor në Turizëm 2021-2022; Evidenca 6.8 Përshkrim i zhvillimit të pyetësorit nga studentët për stafin akademik në FE datë 10.3.2021; Evidenca 6.2 Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE</i></p>




	<i>dhe Raport analize e vlerësimit të programit studimit nga studentet datë 16.5.2023; Evidenca 6.4 Relacion DT i mbledhjes 20.4.2022 për performancën e stafit akademik dhe pedagogëve të jashtëm të DT për semestrin e parë 2021-2022).</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se studentëve u mundësohet transparenca dhe barazia në marrjen e proesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentëve u garantohej e drejta për të marrë informacion në lidhje me procedurën dhe kriteret e vlerësimit të dijeve në lëndë të ndryshme të programit Bachelor në “Turizëm”. Ata informohen për format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve, të drejtën për të zhvilluar provimin, sezonin, data dhe komisionet e provimit, të drejtën për ankimim ose përmirësim të notës etj. Zbatimi i këtyre elementëve përfshihet edhe në pyetësorin e dërguar studentëve. <i>(Evidenca I. STATUTI I USH-së; Evidenca II. RREGULLORE E USH-së; Takimi me studentët; RVB)</i>			
Konkluzione	<i>Në takimin me drejtuesen e njësisë bazë përgjegjëse për programin dhe me studentët, GVJ evidentoi përfshirjen e studentëve për vlerësimin e procesit akademik, ruajtja e anonimitetit të tyre për të pasur rezultate sa më afër realitetit si dhe realizimi i mbledhjeve të departamentit në formatin e hapur ku ftohen dhe studentët. Gjithashtu u mundësohet transparenca dhe barazia në marrjen e proesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentëve u garantohej e drejta për të marrë informacion në lidhje me procedurën dhe kriteret e vlerësimit të dijeve në lëndë të ndryshme të programit Bachelor në “Turizëm”</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------




<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Njësia e posaçme që kryen informimin është zyra e informimit pranë FE-së dhe sekretaria mësimore, të cilat ofrojnë shërbim ditor të nevojave për shërbime nga ana e studentëve. Krahas sekretarisë janë edhe Zyra e Këshillimit dhe Karrierës; Zyra Alumni; Përgjegjësi i Departamentit; koordinatori i programit; stafi akademik dhe jo akademik, të cilët ofrojnë informacion të vazhdueshëm për studentët.</p> <p>Sistemi i online PITAGORA dhe faqet online të USH-së gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm për informimin e studentëve në çdo kohë dhe vend. Edhe gjatë vizitës në sekretarinë mësimore dhe zyrën e informimit të FE u vu re nga GVJ që informimi i studentëve kryhej në përputhje me aktet rregullatore të USH-së.</p> <p><i>GVJ sugjeron që vendndodhja e sekretarisë të ndryshonte, pasi ishte në katin e fundit të godinës, ndërkohë që do ishte mirë të ishte në katin e parë ose të dytë, për të lehtësuar komunikimin e studentëve me to dhe për të evituar lëvizjet e panevojshme në godinë.</i></p> <p><i>(Evidenca XIII. GUIDA PËR STUDENTËT; Evidenca XLII. RAPORT NGA ZYRA E KËSHILLIMIT TË KARRIERËS DHE ALUMNIT; Evidenca 5.5. Raportim mbi faqen e Facebook të FE-së; Evidenca 1.12. Vendim i DT për caktimin e koordinatorit të programit Bachelor në Turizëm).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në FE një rol të rëndësishëm për informimin e studentëve luan edhe Zyra e Këshillimit të Karrierës, e cila e zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloren e përgjithshme të USH-së. Format e shërbimit që ofron për studentë janë Informin dhe Orientim profesional siç është informimi për praktika profesionale.</p> <p>Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit Bachelor në Turizëm mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale në institucione e biznese. Përveç saj, për komunikimin dhe informimin online të studentëve, USH ka në funksionim disa platforma dhe aplikacione.</p> <p><i>(RVB; Takimet me studentët; Takimet me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit dhe Karrierës; Evidenca XL. RREGULLORE E ADMINISTRATËS USH; ëëë.unishk.edu.al).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës u ofron studentëve informacion dhe orientim të posaçëm për procesin mësimor, praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e</p>




<p>të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>punës. Gjithashtu, Departamenti ka një listë të bizneseve me të cilët bashkëpunon Fakulteti Ekonomik, për praktikat dhe punësimin në të ardhmen të studentëve të tyre.</p> <p><i>(RVB; Evidenca XLII. RAPORT NGA ZYRA E KARRIERËS DHE ALUMNIT; Evidenca 1.10.3. Marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe ente publike; Evidenca 1.9.4. Marrëveshje bashkëpunimi midis FE dhe palëve të interesit; Evidenca 1.14. Raport i Panairit të punës së FE-së ndër vite).</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Raportet e gjurmimit të studentëve tregojnë për një procedurë të rregullt dhe sistematike të mbajtjes së kontakteve me studentët Alumni. Raportet gjithashtu tregojnë se proesi i gjurmimit të studentëve kryhet si nëpërmjet email-ve personale, telefonatave dhe faqes së zyrës së Këshillimit dhe Karrierës dhe Zyrës së Alumnit në bashkëpunim me Departamentin e Turizmit. Gjithashtu zhvillohen Panairë pune dhe trajnime për studentët se si të përgatisin CV për punësim, si të përgjigjen në intervista etj.</p> <p>(RVB; Evidenca 1.14. Raportim mbi aktivitetin Panairi i punës datë 24.02.2021; Evidenca 2.10. Vendimi i DT për miratimin e pyetësorëve të studimit të nevojave të tregut të punës për të diplomuarit në fushën e turizmit; Evidenca: Tabela Përmbledhëse nr.23)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit Bachelor në Turizëm mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale në institucione e biznese. Përveç saj, për komunikimin dhe informimin online të studentëve, USH ka në funksionim disa platforma dhe aplikacione. Nga ana tjetër, pvr lehtësi aksesit, GVJ sugjeron që vendndodhja e sekretarisë të ndryshohet, pasi ishte në katin e fundit të godinës, ndërkohë që do ishte mirë të ishte në katin e parë ose të dytë, për të lehtësuar komunikimin e studentëve me to dhe për të evituar lëvizjet e panevojshme në godinë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

VI SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Manuali i Cilësisë i hartuar nga Universiteti i Shkodrës ndihmon për kontrollin e punës së stafit akademik dhe jo akademik. Institucioni organizon pyetësor në mënyrë periodike, nëpërmjet Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Pyetësorët zhvillohen në lidhje me procesin mësimor të zhvillimit të lëndëve dhe për çdo element që lidhet me të. Ata u dërgohen studentëve në fund të çdo semestri, por para dhënies së provimeve, për të shmangur gjykimet e padrejta në varësi të notës së marrë.</p> <p>Në takimet me studentët dhe stafin drejtues dhe të Zyrës së Sigurimit të Cilësisë u theksua fakti që ruhet anonimat i studentëve që përgjigjen dhe që përdoren forma të ndryshme të shpërndarjes së pyetësorit, për të rritur numrin e pjesëmarrësve. Rezultatet e anketimeve kontribuojnë në nxitjen e stafit akademik për përmërsime inovative të mësimdhënies së lëndëve/moduleve. Për të siguruar Cilësinë në mësimdhënie USH ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Cilësisë, me vendim SA nr.181, dt.3105.2021.</p> <p><i>(RVB; Vizita e GVJ në Institucion dhe takimet me studentët dhe stafin; Evidenca X. Manuali i Cilësisë; Evidenca Xiv. Vendim I Sa Për Krijimin E Ksgc; Evidenca Xvi. Paketa E Instrumenteve Matës Të Cilësisë Në USH; Evidenca 6.1. Vendime për përfaqësuesit e departamenteve në NJSBC e FE dhe rregullrja e NJSBC; Evidenca 6.2. Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE dhe Raport analizë e vlerësimit të programit të studimit nga studentët datë 16.5.2023;</i></p>




	<p>https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2020-2021/senati/1771_senat_21.pdf);</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>NJSBC e ngritur në USH është pjesë e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurisë të Cilësisë, harton politika dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Nga takimet e GVJ në Institucion me studentët, stafin dhe përfaqësues të Njesisë, konfirmohet fakti se kjo njësi vlerëson periodikisht veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore, realizon gjurmimin e studentëve pas diplomimit; harton dhe i propozon Senatit Akademik standardet e cilësisë, prezanton raportin vjetor të vlerësimit të cilësisë etj. Gjithashtu në nivel njësie kryesore FE ishte e ngritur NJSBC me përfaqësues nga çdo department i FE, me detyra të përcaktuara qartë rregulloren e NJSBC së FEUNISHK në vlersimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo strukturë ishte krijuar në FE që nga viti 2009.</p> <p><i>Shënim: Në RVB përmendet Evidenca 6.5.3, e cila nuk ekziston në sistemin online të ASCAL, sipas titullit të Evidencës, në sistem ajo është në fakt Evidenca 6.6.</i></p> <p><i>(RVB; Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca XVI. PAKETA E INSTRUMENTEVE MATËS TË CILËSISË NË USH; Evidenca 6.1. Vendime për përfaqësuesit e departamenteve në NJSBC e FE dhe rregullorja e NJSBC; Evidenca 6.2. Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE dhe Raport analizë e vlerësimit të programit të studimit nga studentët datë 16.5.2023; Evidenca 6.3. Vendim nr.3 Bord akreditimi, ASCAL për akreditiminin institucional të USH datë 24.01.2020; Evidenca 6.5.1. Departamenti Raport vlerësimi për asistent lektorin A. Gjura viti 2019-2020 (2); Evidenca 6.6. Dekanati. Dërgim në Rektorat i Raportit të vlerësimit për asistent lektorët për vitin 2019-2020; Evidencë 6.8. Përshkrim i zhvillimit të pyetësorit nga studentët për stafin akademik në FE datë 10.3.2021).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe vizita në Institucion, GVJ konfirmon se Zyra e Cilësisë bën vlerësim periodik të formave dhe metodave të përdorura në mësimdhënie me anë të pyetësorit që i dërgon studentëve në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve. Miratimi i instrumentave për matjen e cilësisë të miratuar në vitin 2022 nga USH ndikon në zhvillimin me efikasitet të këtij kontrolli. NJSBC e FE nëpërmjet pyetësorve të drejtuar studentëve bën vlersim periodik të zhvillimit të procesit mësimor dhe të performancës së pedagogut të lëndës në fund të semestrit.</p>

	<p>Raportet mbi rezultatet e këtyre anketimeve shqyrtoheshin në department. Për programin e studimit Bachelor në 'Turizëm', sipas rregullores së njësisë bazë dhe takimin me pedagogët dhe studentët, përveç kordinatorit të programit të studimit, kishte kujdestar të studentëve për sejcilin vit të programit të studimit Bachelor, të cilët kishin detyra të përcaktuara qartë në rregulloren e njësisë bazë DT, ku një nga detyrat ishte raportimi i problematikave të studentëve. Këto ankimime raportoheshin edhe në mbledhje të departmentit ku raportohej për masat e marra, ose kërkoheshin zgjidhje si department të problematikës së studentëve. Gjithashtu studentët ishin pjesë e GVB të vlersimit të brendshëm të cilësisë të programit të studimit Bachelor në 'Turizëm'.</p> <p><i>(Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca 6.4. Relacion i DT i mbledhjes dt.20.04.2022 lidhur me raport performancën e stafit akademik dhe të pedagogëve të jashtëm të DT për semestrin I të vitit akademik 2021-2022; Evidenca 6.2. Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE dhe Raport analizë e vlerësimit të programit të studimit nga studentët datë 16.5.2023; Evidenca XVI. PAKETA E INSTRUMENTEVE MATËS TË CILËSISË NË USH; Evidenca 6.6. Dekanati. Dërgim në Rektorat i Raportit të vlerësimit për asistent lektorët për vitin 2019-2020, Evidenca 1.5: Rregullore e DT; Evidenca 1.13: Vendim DT për caktimin e kujdestarëve të studenteve të programit Bachelor në Turizëm; Evidenca 6.10 Vendim i DT. Mbi miratimin e RVB të programit Bachelor në Turizëm, bashkengjit RVB, datë 17.4.2021).</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>USH kujdeset që Fakultetet dhe njësitë bazë të raportojnë në mënyrë periodike mbi vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të tyre. Miratimi i paketës së instrumenteve matës së cilësisë e lehtëson dhe e standardizon këtë process për çdo hallkë në Universitet. Vlerësimi i pedagogëve bëhet çdo fund viti duke u mbështetur në manualin e performancës, nga rishikimi i CV të përditësuara dhe dosjeve përkatëse të dorëzuara në degën e Burimeve Njerëzore në USH.</p> <p><i>(RVB; Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca 6.5.1. Departamenti Raport vlerësimi për asistent lektorin A. Gjura viti 2019-2020; Evidenca 6.2. Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE dhe Raport analizë e vlerësimit të programit të studimit nga studentët datë 16.5.2023; Evidenca 6.6. Dekanati. Dërgim në Rektorat i Raportit të vlerësimit për asistent lektorët për vitin 2019-2020; Evidencë 6.8. Përshkrim i zhvillimit të pyetësorit nga studentët për stafin akademik në FE datë 10.3.2021; Evidenca 6.10 Vendim i DT. Mbi miratimin e RVB</i></p>

	<i>të programit Bachelor në Turizëm, bashkëngjit RVB, datë 17.4.2021).</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Për të realizuar rishikimin e programeve mësimore dhe përmirësimin e tyre, Dekani i Fakultetit Ekonomik aktivizon komisionin ad-hoc, i cili grumbullon të dhënat e nevojshme përgjatë vitit akademik. Departamenti praktikon vjeljen e opinioneve të studentëve, nëpërmjet pyetësorëve, organit këshillues të studentëve për njësinë bazë DT, në lidhje me programin e studimit, nivelin e përgatitjes së pedagogëve, metodat e mësimdhënies etj. Departamenti identifikon praktikat e mira dhe i promovon ato duke nxitur personelin akademik që të përmirësohet vazhdimisht. <i>(RVB; Evidenca 6.2. Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE dhe Raport analizë e vlerësimit të programit të studimit nga studentët datë 16.5.2023; Evidenca 6.5.1. Departamenti Raport vlerësimi për asistent lektorin A. Gjura viti 2019-2020; Evidenca 6.5.2 Departamenti. Raport vlerësimi për asistent lektorin S. Baraku viti 2019-2020; Evidenca 6.6. Dekanati. Dërgim në Rektorat i Raportit të vlerësimit për asistent lektorët për vitin 2019-2020, 5.6 Vertetim për zgjedhjen e kryetarit të keshillit studentor dhe organeve këshilluese të studentëve pranë njësisë bazë të FE).</i>			
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe vizita e GVJ në Institucion dhe takimet me studentët e stafin, GVJ konstaton se USH kujdeset që Fakultetet dhe njësitë bazë të raportojnë në mënyrë periodike mbi vlerësimin e brendshëm të cilësisë së programeve të tyre. Gjithashtu vlerësimi i pedagogëve bëhet çdo fund viti duke u mbështetur në manualin e performancës, nga rishikimi i CV të përditësuara dhe dosjeve përkatëse të dorëzuara në degën e Burimeve Njerëzore në USH</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka	USH ka hartuar politika dhe ka ngritur strukturat e duhura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me

<p>politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sektori i Mësimit, Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional ndjek problemet që lidhen me mësimin dhe vlerësimin institucional. Gjithashtu, për menaxhimin e procesit të rishikimit të kurrikulave, programeve të studimit dhe reflektimit të tyre në Plaformat e Universitetit, janë Zyra e Mësimit dhe Kurrikulave. Po kështu Zyra e Sigurimit të Cilësisë monitoron sigurimin e brendshëm të cilësisë në USH dhe funksionon sipas Rregullores së hartuar për këtë qëllim. Gjithashtu në USH me vendim SA nr.181 dt.31.5.2021 është ngritur Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Cilësisë, I cili funksionon në bazë të rregullorës përkatëse për këtë organ.</p> <p><i>(RVB; Takimet E GVJ Në Institucion; Evidenca X. MANUALI I CILËSISË; Evidenca XIV. VENDIM I SENTATIT PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT PËR GARANTIMIN E STANDARDEVE TË CILËSISË NË USH; Evidenca XV. RREGULLORJA E KOMISIONIT PËR GARANTIMIN E STANDARDEVE TË CILËSISË NË USH DHE PROGRAMEVE TË Studimitevidenca XVI. PAKETA E INSTRUMENTEVE MATËS TË CILËSISË NË USH; Evidenca XL: RREGULLORE E ZYRËS SË SIGURIMIT TË CILËSISË; Evidenca 6.6. Dekanati. Dërgim në Rektorat i Raportit të vlerësimit për asistent lektorët për vitin 2019-2020; Evidenca 6.9. Pedagogu përfaqësues i FE-së në grupin e punës për hartimin e RVB-së për akreditim institucional datë 2.7.2019).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në strategjitë e zhvillimit të USH, FE dhe DT dhe programit të studimit Bachelor në Turizëm, rritja e cilësisë së programit të studimit është komponent integruar në strategjitë e zhvillimit të planifikuara. USH kujdeset për mbarëvajtjen e programeve të studimit edhe me instrumenta të tjerë matës, siç është edhe menaxhimi i rezultateve të analizës mësimore, një proces i përvitshëm që zhvillohet nën drejtimin e Zv. Rektorit përgjegjës për procesin mësimor. Kjo analizë vjetore nis që në nivele njësie bazë dhe njësie kryesore.</p> <p>Dokumentet shoqëruese dhe vizita e GVJ-së në Institucion vërtetojnë se Institucioni harton raporte përmbledhëse dhe përpunon rezultatet e analizave dhe pyetësorëve nga të gjitha departamentet dhe fakultetet dhe çdo ndryshim e pasqyron dhe e bën të njohur për të gjithë studentët dhe stafin akademik. USH ka në funksion të mirë Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe punon për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë,</p>




	<p>ku përfshin edhe studentë e bashkëpunotërë e ekspertë të jashtëm.</p> <p><i>(Evidenca XIX. RAPORT I RVB INSTITUCIONAL; Evidenca 6.6. Dekanati. Dërgim në Rektorat i Raportit të vlerësimit për asistent lektorët për vitin 2019-2020; Evidenca 6.2. Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE dhe Raport analizë e vlerësimit të programit të studimit nga studentët datë 16.5.2023; Evidenca 6.1. Vendime për përfaqësuesit e departamenteve dhe përbërjen e NJSBC së FE, dhe rregullorja e NJSBC; Evidenca 6.9. Pedagogu përfaqësues i FE-së në grupin e punës për hartimin e RVB-së për akreditim institucional datë 2.7.2019).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit institucional ka rolin kryesor në përbushjen e këtij kriteri për USH. Monitorimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi periodik i rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe asaj kërkimore-shkencore kryhen nga NJSBC, nëpërmjet hartimit dhe shpërndarjes së pyetësorëve, anketave dhe instrumenteve të tjerë matës. Procesi kryehet 2 herë në vit, para çdo sezoni provimesh. Kjo gjë u pohua edhe nga studentët dhe stafi i NJSBC në takimet me GVJ.</p> <p>Në përmirësimin e cilësisë ndikon realizimi dhe përcjellja e analizës së rezultateve të pyetësorëve dhe raporteve nga fakultetet. Zyra kujdeset për nxjerrjen e detyrave dhe afateve kohore të përbushjes së tyre në lidhje me pikat e dobta të evidentuara nga pyetësorët dhe anketat. Me rëndësi për sigurimin e cilësisë për USH dhe strukturat përkatëse si dhe për programin Bachelor në “Turizëm,, është edhe realizimi i matjes së performancës së pedagogëve çdo vit, e realizuar në tre drejtimet kryesore: procesi i edukimit; procesi i kërkimit shkencor dhe procesi i shpërndarjes (përcjelljes publike dhe komunikimit të dijeve dhe aftësive në shërbim të shoqërisë).</p> <p><i>(RVB; Takimet e GVJ në Institucion; Evidenca 6.3. Vendim nr. 3, datë 24.01.2020 i Bordit të Akreditimit ASCAL për akreditimin institucional të USH; Evidenca 6.10: Vendime për përfaqësuesit e departamenteve dhe përbërjen e NJSBC së FE dhe rregullorja e NJSBC; Evidenca 6.1: Vendim i DT mbi miratimin e RVB të programit Bachelor në Turizëm).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe</p>	<p>Departamenti i Turizmit kryen procesin e rishikimit të kurrikulave dhe analizat mësimore dhe i dërgon propozimet në instancat më të larta në Senat dhe Rektorat, të cilat marrin vendime në lidhje me kërkesat për ndryshim dhe informacionin argumentues. Vendimet u komunikohen departamenteve dhe strukturave përkatëse për zbatimin e tyre. Gjithashtu, FE</p>




<p>dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>organizon rregullisht pyetësorët me studentët për çdo lëndë që ata zhvillojnë dhe rezultatet e nxjerra prej tyre u komunikohen pedagogëve.</p> <p><i>(Evidenca 6.5.1. Departamenti Raport vlerësimi për asistent lektorin A. Gjura viti 2019-2020; Evidenca 6.5.2 Departamenti. Raport vlerësimi për asistent lektorin S. Baraku viti 2019-2020; Evidenca 6.6. Dekanati. Dërgim në Rektorat i Raportit të vlerësimit për asistent lektorët për vitin 2019-2020; Evidenca 6.2. Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE dhe Raport analizë e vlerësimit të programit të studimit nga studentët datë 16.5.2023; Evidenca 6.4 Relacion DT i mbledhjes 20.4.2022 lidhur me raport performancën e stafit akademik dhe pedagogëve të jashtëm të DT për semestrin e parë 2021-2022; Evidenca 2.7 Vendim DT miratim plani mësimor 2021-2022 Bachelor Turizëm me ndryshime dhe miratim në SA).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Turizmit kryen procesin e rishikimit të kurrikulave dhe analizat mësimore dhe i dërgon propozimet në instancat më të larta në Senat dhe Rektorat, të cilat marrin vendime në lidhje me kërkesat për ndryshim dhe informacionin argumentues. Nga takimet në Institucion dhe dokumentacioni i dorëzuar GVJ arrin në përfundimin se Institucioni përdor tregues të ndryshëm dhe të matshëm për përmirësimin e kurrikulës dhe për të promovuar arritjet më të mira të programit. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi VI.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin</p>	<p>Nëpërmjet NJSBC-së, Institucioni siguron mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. NJSBC-ja e Fakultetit Ekonomik është në funksionim dhe përbush detyrat e saj. Në vendimin që miraton krijimin e NJSBC-së përcaktohet edhe përbërja e saj me gjithsej 5 anëtar, nga të cilët 3 anëtar janë nga stafi akademik, 1 student dhe 1 ekspert i jashtëm. Kjo përbërje</p>




<p>dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>siguron përfshirje më të gjerë në këtë Njësi dhe sigurim më të efikas të kontrollit dhe sigurimit të mbikëqyrjes periodike në ndihmë të përmirësimit të vazhdueshëm të programeve.</p> <p><i>(RVB; Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca 6.7: Zyra e sigurimit cilësisë - Realizimi dhe analiza e pyetësorëve të studenteve për programin Bachelor në Turizëm 2021-2022; Evidenca 6.1. Vendime për përfaqësuesit e departamenteve dhe përbërjen e NJSBC së FE dhe Rregullorja e NJSBC-së së FE-së; Evidenca 6.2. Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE dhe Raport analizë e vlerësimit të programit të studimit nga studentët datë 16.5.2023).</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>USH zbaton një politikë të caktuar për sigurimin e cilësisë deri në nivel departamenti, nëpërmjet kontrollit dhe vlerësimit të secilit pedagog (të rinj dhe me përvojë), në bazë vjetore, analizës së rezultateve dhe hartimin e raporteve përkatëse. FE ka realizuar pyetësor me studentë dhe për përpunimin e tyre ka mbështetje nga projekte si Clean Score (AADF) etj, të cilat sigurojnë përpunim të shpejtë dhe të saktë të informacionit të mbledhur nga anketimet.</p> <p><i>(RVB; Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca 6.2. Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE-së dhe Raport analizë e vlerësimit të programit të studimit nga studentët datë 16.05.2023; Evidenca 6.4 Relacion DT i mbledhjes 20.4.2022 lidhur me raport performancën e stafit akademik dhe pedagogëve të jashtëm të DT për semestrin e parë 2021-2022; Evidenca 3.2. Trajnime dhe ëorkshope mbi Metoda dhe praktika të mësimdhënies bashkëkohore).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo</p>	<p>NJSBC e USH dhe NJSBC e Fakultetit Ekonomik të USH realizon kontrollin dhe vlerësimin e programeve të studimit. Në Fakultetin ekonomik praktikohen edhe matja e rezultateve dhe vlerësimit të nxënësve me forma të ndryshme duke përdorur metoda direkte dhe të tërthorta. Rezultatet e pritshme diskutohen në mbledhjet e departamentit duke theksuar dhe inkurajuar praktikatat pozitive e inovative si dhe të metat për të marrë masa për përmirësimin e tyre në të ardhmen.</p> <p><i>(Vizita e GVJ në Institucion; Takimi me studentët dhe stafin akademik; Evidenca Evidenca 6.7: Zyra e sigurimit cilësisë -</i></p>




<p>detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>Realizimi dhe analiza e pyetësorëve të studentëve për programin Bachelor në Turizëm 2021-2022; Evidenca 6.2. Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE-së dhe Raport analize e vlerësimit të programit të studimit nga studentët datë 16.05.2023).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar dhe nga vizita e takimet në Institucion, GVJ konstaton se USH dhe njësitë përbërëse të tij realizojnë vlerësimin e realizimit të programit me anë të metodave dhe instrumenteve të tërthorta të vlerësimit.</p> <p>Më së shumti përdoren anketimet e studentëve, që realizohen për çdo lëndë të zhvilluar dhe për çdo pedagog. Kjo evidentohet si praktikë e mirë dhe e suksesshme edhe në RVB.</p> <p>Përveç pyetësorëve, përdoren edhe metoda të tjera për sigurimin e brendshëm të cilësisë. USH dhe FE, departamentet përkatëse ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm të kurrikulave, syllabuseve, cilësisë së zhvillimit të praktikës, organizimi i diskutimeve me studentët për leksionet e hapura të zhvilluara edhe nga lektorë të huaj të ftuar, për aktivitetet e organizuara me studentët në shërbim të arritjes së objektivave të lëndës etj.</p> <p>Gjithashtu titullarët e lëndës realizonin kontrollin e metodave dhe materialeve që pedagogët e seminareve përdorin për të kontribuar në asimilin e leksioneve dhe arritjen e objektivave të lëndës, ose në fund të orës së mësimi të semestrit i kërkohej studentëve çfarë konkretisht mund të përmisohet në kurrikulen e lëndës dhe në materialet dhe metodat e zhvillimit të lëndës. Edhe nga partnerët mbështetës të programit të studimit është krijuar Forumi i përbashkët FE-Palë interesi, ku një nga takimet e përhershme ishte ai që zhvillohej me përfaqësuesit e organizatave dhe bizneseve pjesëmarrëse pas panairit të punës që FE organizontë çdo vit ku merresin edhe opinione të nevojës së përmirsimeve të dijeve dhe kompetencave të studentëve që tregu i punës kërkon për studentët e diplomuar në programet e studimit që ofron FE ose nevojën për programe të reja apo lëndë e tema të reja që tregu i punës i kërkon të diplomuarve në fushën ekonomike.</p> <p><i>(Takimet e GVJ në Institucion; RVB; Evidenca 6.2. Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE-së dhe Raport analize</i></p>

	<i>e vlerësimit të programit të studimit nga studentët datë 16.05.2023; Evidenca 6.7. Zyra e sigurimit të cilësisë-Realizimi dhe analiza e pyetësorëve të studentëve për programin Bachelor në Turizëm 2021-2022; Evidenca 6.6. Miratim i DT të raportit të vlerësimit të cilësisë së praktikës profesionale të programeve të turizmit; Evidenca 1.10.4 Marrëveshje bashkëpunimi FE dhe palëve të interesit).</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se Institucioni përdor metoda të ndryshme si: pyetësor, intervista, formular vetëvlerësimi etj, për të realizuar vlerësimin e programit të studimit dhe dijeve dhe kompetencave që ai u siguron studentëve. Gjithashtu titullarët e lëndës realizonin kontrollin e metodave dhe materialeve që pedagogët e seminareve përdornin për të kontribuar në asimilin e leksioneve dhe arritjen e objektivave të lëndës, ose në fund të orës së mësimit të semestrit i kërkohej studentëve çfarë konkretisht mund të përmisohet në kurrikulen e lëndës dhe në materialet dhe metodat e zhvillimit të lëndës</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	USH në rregulloret e tij përcakton procedurat që garantojnë sigurimin e cilësisë. Gjithashtu, në rregulloren e Fakultetit, Departamentit dhe të programit të studimit përcaktohen dhe hartohen politikat për realizimin e kësaj detyre. Proçesi i sigurimit të cilësisë së programit të studimit garantohej edhe me anë të përfshirjes të studentëve në strukturat përkatëse. GVJ konstaton se USH dhe njësitë përbërëse të tij realizojnë vlerësimin e realizimit të programit me anë të metodave dhe instrumenteve të tërthorta të vlerësimit. Pwrveç anketimeve tw studentëve, që realizohen për çdo lëndë të zhvilluar dhe për çdo pedagog angazhohen dhe bashkwpuntorw tw jashtwm tw institucionit. Kjo evidentohet si praktikë e mirë dhe e suksesshme edhe në RVB. Përveç pyetësorëve, përdoren edhe metoda të tjera për sigurimin e brendshëm të cilësisë. USH dhe FE, departamentet përkatëse ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm të kurrikulave, syllabuseve, cilësisë së zhvillimit të praktikës,




	<p>organizimi i diskutimeve me studentët për leksionet e hapura të zhvilluara edhe nga lektorë të huaj të ftuar, për aktivitetet e organizuara me studentët në shërbim të arritjes së objektivave të lëndës etj.</p> <p><i>Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm; Evidenca 3.9 Miratimi i Dekanatit të paketës së përgatitjes së temës së diplomës cikli I dhe II; Evidenca 6.1. Vendime për përfaqësuesit e departamenteve dhe përbërjen e NJSBC-së të FE-së dhe Rregullorja e NJSBC-së, FE; Evidenca 6.1: Vendim i DT mbi miratimin e RVB të programit Bachelor në Turizëm; Takimet e GVJ-së në Institucion).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe vizita e GVJ në Institucion, konstatohet që USH është i dedikuar për të përmbushur si duhet këtë kriter nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të një politike për sigurimin e cilësisë deri në nivel departamenti. Në rregulloret e strukturave të ngritura për sigurimin e cilësisë, si dhe në rregulloret e tjera të USH, FE dhe dei në nivel departamenti dhe programit të studimit janë të përcaktuara qartë detyrat për njësitë, individët në detyrë, stafin dhe studentët, për të bërë të mundur mbarëvatjen e zhvillimit të programeve të studimit. Klima në FE e kryejës me përgjegjësi të këtyre detyrave dhe të ushtrimit të të drejtave ishte mjaft pozitive, siç doli edhe nga takimet në FE me stafin dhe studentët. NJSBC-ja krijon kushtet dhe mundësitë për të realizuar sigurimin e brendshëm të cilësisë në Fakultetin Ekonomik të USH.</p> <p><i>Evidenca LI: Paketa e praktikës në programet e studimit Bachelor dhe Master në USH; Evidenca 1.5. Rregullore e FE-së; Evidenca 6.1. Vendime për përfaqësuesit e departamenteve dhe përbërjen e NJSBC së FE-së dhe Rregullorja e NJSBC-së, FE; Evidenca 1.6. Rregullore e Departamentit të Turizmit; Evidenca 1.7: Rregullore e programit të studimit Bachelor në Turizëm. Takimet e GVJ-së në Institucion)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>NJSBC e Fakultetit Ekonomik kryen të gjitha veprimtaritë e parashikuara në Statutin e Universitetit dhe rregulloret e miratuara. Vlerësimi i sigurisë së cilësisë realizohet edhe nga njësitë bazë e kryesore dhe ka gjithëpërfshirje me përfaqësues nga të gjithë aktorët: stafi akademik, ndihmës akademik, studentët, ekspert të jashtëm etj. NJSBC ofron ekspertizën dhe koordinon punën për realizimin e me sukses të vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm të FE-së. Ajo ka realizuar edhe RVB në nivel Fakulteti, të cilin ia ka përcjellë Zyrës së Cilësisë për përgatitjen e RVB-së institucionale. Ky raport në shkallë njësie bazë bazohet në raportet vjetore të njësisë bazë për punën</p>




<p>administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>akademike dhe shkencore të bërë për realizimin e programeve të studimit që ato ofrojnë dhe për vlersimin e kërkimit shkencor të bërë nga njësia bazë. Ne diskutimin në department rreth sa më sipër inkurajohen të marrin pjesë edhe studentët anëtar të organit këshillues të departamentit të turizmit. Gjithashtu edhe në përgaditjen e RVB së programit të studimit marrin pjesë anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><i>(RVB; Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca I. STATUTI I USH-së. Evidenca 1.2. Strategjia e FE-së 2018-2022; Evidenca 6.1. Vendime për përfaqësuesit e departamenteve dhe përbërjen e NJSBC së FE-së dhe Rregullorja e NJSBC-së, FE; Evidenca 6.10 Vendim i DT mbi miratimin e RVB të programit Bachelor në Turizëm, bashkëngjitur RVB, datë 17.4.2021).</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>NJSBC-ja e Fakultetit ekonomik ka në përbërje të saj përfaqësues nga departamentet (sipas propozimit të tyre), nga studentët si dhe nga një ekspert të jashtëm, për të garantuar përfaqësimin e të gjithë aktorëve të përfshirë në mësimdhënie.</p> <p><i>(RVB; Evidenca 1.2. Strategjia e Fakultetit Ekonomik 2018-2022; Evidenca 6.1. Vendime për përfaqësuesit e departamenteve dhe përbërjen e NJSBC së FE dhe rregullorja e NJSBC-FE)</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Institucioni konsultohet dhe kërkon ndihmën edhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm në lidhje me kontrollin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë. Një nga anëtarët e NJSBC-së së FE-së është ekspert i jashtëm. Edhe në përgaditjen e RVB së programit të studimit Bachelor në Turizëm është i përfshirë ekspert i jashtëm i fushës së Turizmit. Gjithashtu, ekspertë të jashtëm ose të huaj ftohen vazhdimisht për organizimin e leksioneve të hapura, të cilat rrisin bashkëpunimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Turizëm. Siç u shpreh në takimin me stafin akademik të DT, megjithëse kukurrikula e këtij programi ishte hartuar nga ekspertiza e Universiteti Ebersäldit, Gjermani, ai është pasuruar edhe me lëndë të rekomanduara nga ekspert amerikan të turizmit të SCC të SHBA.</p> <p><i>(RVB; Evidenca 1.2. Strategjia e Fakultetit Ekonomik 2018-2022; Evidenca 6.1. Vendime për përfaqësuesit e departamenteve në NJSBC e FE dhe rregullorja e NJSBC;</i></p>




	Evidenca 6.10 Vendim i DT mbi miratimin e RVB të programit Bachelor në Turizem, bashkëngjitur RVB, datë 17.4.2021).			
Konkluzione	Nga takimet në Institucion dhe dokumentacioni i dorëzuar GVJ konkludon se institucioni ka një praktikë funksionale të përfshirjes së bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm për të dhënë ekspertizën e tyre në lidhje me përmirësimin e programit dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së tij. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Universiteti i Shkodrës dhe njësitë e tij hartojnë strategji dhe politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Pyetësorët që zhvillohen rregullisht me studentët dhe rezultatet e tyre diskutohen në mbledhjet e departamenteve dhe janë publike për stafin. NJSBC-ja e FE-së bashkëpunon edhe me projektin Clean Score (të AADF-së), për të pasur një përpunim më të saktë dhe të shpejtë të rezultateve të pyetësorëve. Në dokumentacionin e dorëzuar prezantohet analiza e rezultateve të programeve të studimit në FE të USH-së, ku është edhe e programit Bachelor në Turizëm. Në ëbsite të USH janë të publikuara relacionet mbi aktivitete të organizuara nga DT si leksionet e hapura, aktivitetet e organizuara së bashku me studentët dhe partnerët vendas dhe të huaj me tematika të përcaktuara në funksion të objektivave të programit të studimit dhe në të njejtën kohë për të kontribuar në zhvillimin e turizmit në mënyrë të qëndrueshme, në nxitjen e shpirtit të sipërmarrjes së studentëve dhe të përgjegjësisë sociale të tyre etj.</p> <p><i>(Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca 5.4. Relacion i aktivitetit Mirësevjen Maturant; Evidenca 5.5. Raportim mbi faqen e Facebook të FE, datë 01.02.2021; Evidenca 1.9.2 dhe 1.9.3. Analiza vjetore e veprimtarisë Akademike-shkencore të DT 2020-2021 dhe 2021-2022; 3.13.5 Informacion mbi aktivitetet e DT në Ëëbsite të USH)</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>USH dhe njësitë përkatëse organizojnë rregullisht kontrollin e programeve të studimit, kryesisht me anë të pyetësorëve që u dërgohen studentëve dy herë në vit dhe publikon rezultatet e tyre duke respektuar lirinë dhe etikën akademike. NJSBC është përgjegjëse për përpunimin e pyetësorëve dhe anketimeve si dhe për publikimin e rezultateve të tyre, duke iu përmbajtur parimit të sipër përmendur.</p> <p><i>(Evidenca XXXIV. Programi i Transparencës; Evidenca Xxxv. Politika E Privatësisë; Evidenca 6.1. Vendime për përfaqësuesit e departamenteve dhe përbërjen e NJSBC së FE dhe rregullrja e NJSBC; Takimet e GVJ në Institucion).</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë në USH organizon mbledhje të Asamblesë ku diskutohet për programet e studimit, arritjet, problematikat, masat për përmirësim etj. Gjithashtu, USH harton planin e masave që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e programeve të studimit, duke u bazuar në rezultatet e pyetësorëve dhe analizat e tjera në Departamente e Fakultete.</p> <p><i>(RVB; Vizita e GVJ në Institucion; Evidenca 1.9.2 dhe 1.9.3. Analiza vjetore e veprimtarisë Akademike-shkencore të DT 2020-2021 dhe 2021-2022)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar, RVB-ja dhe vizita e GVJ në Institucion, konfirmohet se NJSBC-ja e FE-së përgatit propozime për përmirësimin e cilësisë në vitin pasardhës, duke u mbështetur edhe në masat e marra një vit më parë.</p> <p>NJSBC-ja kujdeset për realizimin e pyetësorëve dhe anketimeve me studentët dhe për përpunimin e tyre dhe nxjerrjen e shpejtë të rezultateve bashkëpunon me projektin Clean Score të AADF-së. Për secilin program studimi, ajo përgatit raportin e rezultateve të pyetësorëve dhe jep udhëzimet përkatëse për përmirësimin e situatës, në bazë të problematikave të shfaqura.</p> <p><i>(RVB; Vizita e GVJ-së në Institucion; Evidenca 6.10. Vendim i DT mbi miratimin e RVB të programit Bachelor në Turizëm; Evidenca 6.1. Vendime për përfaqësuesit e departamenteve në NJSBC e FE dhe rregullrja e NJSBC; Evidenca 6.2 Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE dhe Raport analizë e vlersimit të programit studimit nga studentët datë 16.5.2023).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre</p>	<p>Strukturat dhe programi i studimit vlerësohen periodikisht nëpërmjet NJSBC-së. Kjo njësi dhe përfaqësuesit e saj japin informacione dhe organizojnë takime informuese në lidhje me aktivitetet e sigurimit të cilësisë në të gjitha njësitë e Universitetit si dhe organizojnë takime informuese në lidhje me ndryshimet dhe përmirësimet e zbatuara dhe të parashikuara.</p>




për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	(Evidenca 6.10. Vendim i DT mbi miratimin e RVB të programit Bachelor në Turizëm; Evidenca 6.2. Përshkrimi i punës së NJSBC-së së FE dhe Raport analizë e vlerësimit të programit të studimit nga studentët datë 16.5.2023; Evidenca 6.4. Relacion i DT i mbledhjes dt. 20.04.2022 lidhur me raport performancën e stafit akademik dhe të pedagogëve të jashtëm të DT për semestrin I të vitit akademik 2021-2022).			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat ne IAL, GVJ konkludon se institucioni organizon veprimtari periodike me stafin dhe studentet për përmirësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. GVJ shpreh vlerësimin: Përbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Turizëm” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Vendodhja e UNISHK, si i vetmi në rajonin verior të Shqipërisë dhe me mundësi të madhe aksesit edhe nga trojet shqiptare
2. Përvoja 30 vjeçare e Fakultetit Ekonomik të UNISHK dhe emri i mirë i krijuar në komunitet nga ky fakultet, e cila është vlerë e shtuar në drejtim të konsolidimit dhe besueshmërisë të tij.
3. Oferta akademike në fushën e turizmit e shtrirë në të tre ciklet e studimit e ofruar nga Departamenti i Turizmit në Fakultetin Ekonomik të UNISHK.
4. Programi i studimit Bachelor në ‘Turizëm’ me kurrikul të hartuar mbi bazën e ekspertizës akademike në fushën e turizmit të Universitetit të Eberswaldit të Shkencave të Aplikuara, Gjermani, si dhe është pasuruar nga ekspertiza akademike dhe literature bashkohore e sjellë prej Sandhills Community College të North Caroline, SHBA. Këto e bëjnë këtë program lehtësisht të pranueshëm në tregun e punës apo për vazhdim të studimeve brenda dhe jashtë vendit.
5. Mbulimi i mësimdhënies mbi 70% me pedagoge të brendshëm gjë që rrit angazhimin e stafit të specializuar me përvoja aplikative në fusha të caktuara.
6. Aplikimi i modeleve të reja ndërvepruese të mësimdhënies duke u mbështetur në eksperiencat më të mira dhe trajnimet e marra nga Universitetet e sipërperemdur.
7. Aplikimi i metodave të kombinuara të mësimdhënies brenda orëve të planifikuara të lëndës për marrjen e njohurive teorike dhe aftësive praktike nga eksperiencia të sukseshme menaxhimi dhe nga organizimi i aktiviteteve të praktikimit të aftësive teorike të studentëve.
8. Transparenca në kontrollin e dijeve nga përdorimi i sistemeve të informatizuara (Pitagora) për publikimin e vlerësimeve dhe për kontrollin e tyre të automatizuar (Cleanscore).
9. Organizimi i përvitshëm i konferencës shkencore ndërkombëtare dhe konferencës studentore në nivel Fakulteti.
10. Partneritet dhe marrëveshje bashkëpunimi të formalizuara dhe efektive me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me organizata publike dhe private në mbështetje të objektivave të procesit mësimor, seminareve në terren dhe praktikave profesionale.
11. Qëndrueshmëri ndër vite në numrat e studentëve.
12. Përfshirje e studentëve në vlersimin e metodave të mësimdhënies dhe të programit të studimit.
13. Inkurajimi dhe përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor: konferenca, workshope, projekte, botim në buletin shkencor të USH, seria e shkencave ekonomike

Pika të dobta:

1. Mos strukturimi i syllabuseve të lëndëve në seksionin e objektivave të lëndës dhe temave të lëndës në përputhje me VKM 41/2018.

2. Pragu i ulët në rregulloren e studimeve në UNISHK të kufirit të lejuar të peshës së vlersimit gjatë vitit të studentit.
3. Mungesë të autonomisë financiare në nivel njësie kryesore/bazë dhe e shpërndarjes së të ardhurave sipas njërive kontributore, që ndikon në mos intensifikimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me partnerët për të mbështet procesin mësimor dhe për të bashkëpunuar në projekte zhvillimore dhe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. Mungesa e një programi antiplagjiaturë të formalizuar dhe të siguruar nga UNISHK.
5. Mos publikim në faqen on-line të UNISHK të raportimeve financiare nga muaji mars e në vazhdim.

Rekomandime:

1. Formulimi i plotë i syllabuseve të lëndëve të programit Bachelor në 'Turizëm' në përputhje me VKM 41/2018 dhe hartimi i këtyre syllabuseve në gjuhën angleze.
2. Parashtrim në Rregullore të USH apo të programit të studimit të një peshë më të lartë të pikëve të vlersimit të studentit gjatë vitit.
3. Sigurim i autonomisë financiare në nivel njësie kryesore dhe parashtrim në rregullore të USH të shpërndarjes së të ardhurave sipas njërive kontributore do të intensifikojë më tej bashkëpunimin e njësisë kryesore/bazë me partnerët për të mbështet procesin mësimor dhe për të bashkëpunuar në projekte zhvillimore dhe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. Investim i UNISHK në formalizimin e përdorimit të programit antiplagjiaturë duke bërë të mundur sigurimin e një programi të vetëm antiplagjiature në UNISHK.
5. Ndryshim i vendndodhjes së sekretarisë mësimore duke e vendosur në katin e parë ose të dytë, për të lehtësuar komunikimin e studentëve me to dhe për të evituar lëvizjet e panevojshme në godinë.
6. Vazhdim i bërjes transparente në faqen on-line të UNISHK të raportimit financiar të UNISHK.



Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor in "Tourism" offered by the Institution of Higher Education "University of Shkodra "Luigj Gurakuqi"

Strengths and Affirmations:

1. Location of UNISHK, as the only University in the northern region of Albania and with great access from other territories in the northern countries with Albanian population.
2. Thirty years' experience of the Faculty of Economics of UNISHK and its good reputation in the community, which is an added value in terms of its consolidation and reliability.
3. The academic offer in the field of Tourism in the three study cycles offered by the Department of Tourism at the Faculty of Economics of UNISHK.
4. The Bachelor's study program in "Tourism" with a curriculum designed on the basis of the academic expertise in the field of Tourism from the Ebersewalde University of Applied Sciences, Germany, as well from the academic expertise and contemporary literature brought by Sandhills Community College of North Carolina, USA. These make this program easily acceptable in the labor market or to continue studies in Albania or in other countries.
5. Over 70% of teaching coverage from full time Lecturers, which increases the engagement of qualified staff with experience in the necessary fields of study for this program.
6. Application of new interactive teaching methods based on the best experiences and training received from the above-mentioned Universities.
7. Application of combined teaching methods within the scheduled course hours for obtaining theoretical knowledge and practical skills from successful management experiences and from organizing activities to practice students' theoretical skills.
8. Transparency in the students' final tests by using computerized systems (Pitagora) for the publication of their results and for automated assessments (Clearscore).
9. The organizing of the International Scientific Conference annually as well of the students' Conference at the Faculty level.
10. Partnerships and cooperation agreements formalized and effective with counterpart Institutions inside and outside the country, as well with public and private organizations in support of the objectives of the learning process, study visits and professional internships.
11. Stability over the years in student numbers.
12. Involvement of students in the evaluation of teaching methods and the study program.
13. Encouraging and involving students in scientific research: conferences, workshops, projects, publications in University of Shkodra's Scientific Bulletin, series of economic sciences etc.



Weakeness:

1. The course syllabuses, in the section of course objectives and course topics, do not follow the formatting and desing according to the VKM 41/2018.
2. In the document of Rules and Regulations of UNISHK, the allowed limit of the evaluation weight of the student during the year is low.
3. Lack of financial autonomy at the Main and Base Unit Level and the distribution of income according to contributing Units, which affects the lack of further intensification of cooperation with partners to support the learning process and to collaborate in National and International Development and Research Projects.
4. Lack of a standardized anti-plagiarism program provided by UNISHK.
5. Lack of publication on the UNISHK online page of the financial reports from the month of March and onwards.

Recommendations:

1. Standardization of all syllabuses the Bachelor program in "Tourism" in accordance with VKM 41/2018 and the drafting of these syllabuses in English.
2. Establishing, in the Regulations of the University of Shkodra or of the study program, of a higher weight of the student's evaluation during the year.
3. Ensuring financial autonomy at the Main Unit (Faculty) Level and establishing in the USH Regulations of income distribution according to contributory Units. This will further intensify the collaboration between Main and Base Units (Faculties and Departments) with partners to support the learning process and cooperation in joint National and International research Projects.
4. UNISHK need to invest in an anti-plagiarism program, to provide and ensure the use of a standardized anti-plagiarism program for all UNISHK.
5. Changing the location of the teaching secretariat by placing it on the first or second floor, to facilitate the communication of students with them and to avoid unnecessary movements in the building.
6. Continuation of making UNISHK's financial reporting transparent on UNISHK's online page.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

